


BIBLIOTEKA

870.09

K 14

Ismail Kadare



Figurën e Eskilit nuk mund ta errësojë askush, dhe t'i referohesh asaj do të thotë të nderosh gjë-nun universal në pikën e tij më të lartë... Ky ndërim është shumë prekës; ai i jep mundësi shkrimitarit të mos merret me krijues të rëndomtë.

Ajo që i intereson Kadaresë, në radhë të parë është madhështia njerëzore e Eskilit, dhe kjo madhështi është e pandashme nga thelbi i tragjedisë.

...Sa më shumë të thellohesh në leximin e kësaj eseje, aq më tepër e ndien se kuptimi i historisë për Ismail Kadarenë është një virtut tonik, i pashmangshëm, shkatërrues dhe i nivojshëm.

ALAIN BOSQUET
("Magazine Littéraire", prill 1988)

Përmes shkrimeve të Eskilit, themeluesit të tragjedisë antiqe, Ismail Kadareja rizbulon historinë e popuve të Ballkanit, e popullit të tij, të mbushur me lirinë e humbur dhe të rifituar.

DOMINIQUE FILY
("La cité nouvelle", prill 1988)

Me «Eskilin, ky humbës i madh», Kadareja shkon më larg. Në këtë ese madhështore për artin e të shkruarit, që është një meditim i thellë në marrëdhëni e letërsisë me pushtetin, ai hedh një urë midis tragjedisë greke dhe romanit modern, midis fatit të një poeti, që princët e shikonin me dyshim, dhe atij të një romancieri të cilit burokratët i tremben.

...Atëherë, çdo art paska një fund? Çdo artist de-tiyimiht është një humbës? Jo, përgjigjet romancierit shqiptar. Dhe Eskilli e dëshmon këtë sepse, me gjithë mërgimin që i imponojnë sundimtarët e Athinës, megjithë vdekjen e tij të vetmuar në Sicili, Greqia dhe vepra e Eskilit janë të pandashme përnjerëzimin.

JACQUES ATTALI
("Le monde", 20 maj 1988)

87509
K14-

ISMAIL KADARE

ESKILI

KY HUMBËS I MADH



SHTËPIA BOTUESE NËNTORI

REDAKTÖR:
PIRO MISHA

PIKTÖR:
ARBIAN KARAKASHI

RECENSÜS:
TEFIK ÇAUSHİ
SHABAN MURATI

Kur në një ditë tectori, në një nga ato ditë të tectorit që duket se janë krijuar enkas për të rilexuar diçka të rrallë, nga rafti i bibliotekës tërheq një libër të Eskilit, ti e kuption menjëherë nëse e ke gjetur ose jo ditën e përshtatshme për këtë gjë. Sepse Eskili është nga ata krijues që nuk i shkon secilës ditë. Ai kërkon një disponim të veçantë. Dhe kjo për arsyen e thjeshtë se ti e njeh atë qysh nga rinia e hershme, e ke bërë në shkoilë, ke dëgjuar për të në emisionet e kulturës në TV etj., shkurt, nuk ke asnje kureshtje për të, kështu që leximi i tij ose, më saktë, rileximi i tij përbën vetveti një «akt të zgjedhur».

Në të vërtetë, fjalët «lexim» ose «rilexim» në këtë rast ngjajnë të pasakta. Shfletimi i librit të tij më tepër se lexim është një meditim, madje gjatë kohës së leximit do të ishte e natyrshtme që më shumë se i hapur libri të qëndronte i myllur.

Por dihet se për një gjë të tillë duhet një gjendje e veçantë shpirtërore, e cila nuk krijohet kolaj dhe në çdo kohë. Dhe në qoftë se ti e kuption se dita nuk është e përshtatshme, atëherë është mirë ta vësh përsëri në raft librin dhe të presësh një ditë tjeter.

Eskili, ky humbës i madh

Këto janë disa shënime për Eskilin të hedhura në kohë të ndryshme. Prej interesit që zgjojnë, mund të gjykohet se sa të përshtatshme ose jo kanë qenë ditët kur ato janë shkruar.

1

Eshtë e natyrshme dëshira për të ditur se si punon një shkrimtar, ç'zakone, ç'orare, ç'studio ka. Për shkrimtarët antikë, kur jo vetëm këto, por krejt jetën e tyre e ka mbuluar harresa, kjo dëshiret kthehet në një ëndërr torturuese. Gjithçka ngjan e largët, e paqenë.

Megjithatë, ishte një dorë që i shkroi tragjeditë e pavdekshme. Një dorë që mbajti një mjet gjur-mëlénës, i cili shkronjë pas shkronje e radhë pas radhe i endi ato. Ishte një shtëpi, një dhomë ku ato lindën së pari.

Si ishte dhoma e punës e Eskilit? Ne s'dimë asgjë, por ne dimë kryesoren: që ajo ishte pa libra.

Ai ishte «ati i tragjedisë», siç është quajtur dikur, dhe një nga etërit e letërsisë së botës. Dhe si i tillë ishte pothuajse i vetëm. Ishte një triشتë i madh apo një mrekulli, ky fat i veçantë? Këtë s'mund ta dijë askush. Shumë gjëra për të s'mund t'i dijë askush. Vetëm merret me mend që duhet

Eskili, ky humbës i madh

të ketë pasur një dhomë pune. Një lloj tryeze, ndoshta, ku rreshtonte pllakat e zeza, mbi të cilat shkruante me një lloj kunji. Në një kënd të dhomës mund të kishte ca pllaka të tjera me ndonjë monolog nga tragjedia e porsaluajtur e Frinikut, ose ca vargje të përkthyera nga «Gilgameshi». Homerin e dinte ndoshta përmendsh. Dhe kjo ishte e gjitha. Të tjerat duhej t'i krijonte ai.

Dritaret duhej t'i mbyllte në stinën e ftohtë. Nëpërmjet letrës së lyer me vaj hynte një ndriçim pakëz i mjegullt, si prej èndrre, që e bashkonte e njëkohësisht e ndante prej botës.

A ka luajtur ndonjë rol ai ndriçim në ngjyrimin e tragjedive të tij? Si do të ishin ato në qoftë se në vend të letrës së vajit dritaret do të ishin me qelq? Dy mijë vjet më vonë, anglezi Shekspir, që i shkroi tragjeditë e tij nën ndriçimin e qelqit, nuk i bëri ato më të kthjellëta, përkundrazi. Ishte shkas për këtë veriu i zymtë, apo retë ishin brenda tij?

Shumë pyetje dhe hamendje lindin kur shfletton Eskilin. Prandaj leximi i tij është më i pasur dhe më i vërtetë kur librin e mbyll shpesh.

Si çdo krijuesi, pas ditës së punës, do t'i pëlqente edhe atij të dilte përjashta. Të shkonte ndoshta gjer në teatër, për të biseduar për dramën e ardhshme, ose ndoshta gjer në aeropag, për të zgjiddhur ndonjë telash lidhur me shfaqjen e fundit. Apo thjesht për të shëtitur në treg.

Pamja që ai kishte përpëra ishte krejt e ndryshme nga c'e përfytyrojmë ne. Hapësira dukej më e madhe për arsyen e thjeshtë se njerëz kishte më pak. Dhe akoma më pak ishin njerëzit e lirë. Tem-

Eskili, ky humbës i madh

pujt gjithashtu ishin të paktë, në krahasim me ndërtesat e vogla, të mërzitshme. Por në këtë hapësirë, që do të ngjante e zbrazët për syrin tonë, endeshin ciklonë të mendimit e të fantazisë, që nuk ishin parë kurrë gjér atëherë.

Asnjë dokumentacion, fotografi a identikit nuk i fiksonte ngjarjet që kishin ndodhur një muaj më parë, madje një javë apo një ditë më parë, për të mos përmendur ato më të hershmet. Pre e fantazisë dhe e interpretimit të secilit, disa prej tyre përshtëndrrroheshin aq shumë, saqë nuk ishin larg kufirit të pamjeve që na jep gjumi.

Njeriu me dukje të zakonshme, me flokët e rënë, sic e janin skulpturat, ishte një nga gjeneratorët që prodhonin valë mendimi e deliri krijues, që do ta përshkonin tej e mbanë për mijëra vjet këtë plahet me emrin Tokë. Por, në atë kohë, sado i ndërgjegjshëm të ishte për shtatin e vet. as ai e askush tjetër nuk mund të parashikonte saktë përmasat e vërteta të tij.

Tragjedia apo kishte lindur. Ajo ishte ende në kantiér dhe ai edhe arkitekt, edhe murator, edhe i aksidentuar i mundshëm i saj. Ç'të reja letrare mund të dëgjonte në treg ose në vendin ku mbli-dheshin aktorët e teatrit? Ndonjë copë të dramës së ardhshme të Frinikut, që më në fund aeropagu e kishte lejuar të shfaqej, ndonjë mendim të Thespisit, pararendësit të tij, por edhe ai i dyshimtë, përderisa kishte arritur nënërmjet prostitutës X. miskeshë e dikurshme e të ndjerit. Përveç poemave të Homerit, kjo ishte e gjithë tradita — botime, kritika, publicitet. Ah, po, ishte edhe letërsia e huaj.

Eskili, ky humbës i madh

Kohë më parë, nga një udhëtar i huaj mund të kishte dëgjuar rastësishtridhjetë vargje të një poemë tepër të lashtë sumero-akadiane për një farë Gilgameshi. Një poemë për tmerrin e vdekjes. Mirëpo vazhdimi i saj ishte vështirë të gjendej. Dhe kjo ishte krejt tradita botërore.

I vetëm duhej të kthehej në dhomën e punës, me fantazmat që bartte me vete. Tragjedia ishte atje, në këmbët e tij, me themele ende të hapura, me projektin e papërfunduar e me skelat dhe pluhurin e ndërtimit.

Ishte trishtim apo gëzim të ishe at i saj? At mijëvjeçar që lëshon në botë një pjellë që nuk ia di fatin ose, më saktë, që je përgjegjës si çdo at përfatin e saj.

Eskilit i ra në pjesë një nga fatet e rralla që mund t'i bjere njeriut: të fillojë tragjedinë, në atë kuqtim të madh që i japim ne sot. Natyrish, përpëra tij kishte pasur të tjerë, që koha i mbuloi me pluhur. Dhe përveç tyre ishte tradita e poezisë gjore greke dhe e popujve të tjerë të Ballkanit. Dhe përveç saj ishin festat dionisiake dhe ceremonitë e dasmave, dhe ceremonitë e përmortshme dhe dhjetëra dukuri të tjera të natyrës e të shoqërisë, prej të cilave drama nuk është veçse një hap larg. Sepse, në fund të fundit, siç thotë C. Miloszi, një dru, me rrënjet e futura nën tokë, si në pus, me trungun e ndërmjetëm dhe kurorën shpërthyese, një dru, pra, me synimin e vet nga nëntoka drejt qiellit, e ka shkruar më parë se Danteja «Komedinë Hyjnore».

*Auskl
+
Jepurash
C.*

2

Bashkëkohësit kishin pa dyshim pjesën e tyre në veprën e tij. Etja e tyre për shfaqje, entuziazmi, duartrokitjet, heshtja, polemikat e gjata në prag të konkurrimit, grindjet përpara biletarisë së teatrit, shijet, skandalet, të gjitha këto ishin të pranishme në punën e tij. Me kalimin e viteve, për arsyet e lodhjes e të moshës makina e trurit të tij vihej në lëvizje përherë e më me vështirësi. Ai kishte nevojë për shtytje dhe shtysë më e drejtpërdrejtë se ajo zallahi e largët spektatorësh që vinte nga teatri, vështirë se mund të gjendej. Mund të ishte mërzitur prej tyre shpesh, t'i kishte sharë me vete, t'u kishte thënë: naivë, mendjelehtë, kam faj unë që merrem me ju etj., etj., por prapë, e dinte se s'bënte dot pa atë zhurmëri. Ashtu siç nuk bënte dot pa fjalët e tyre, pa gjestet, mendimet, zjarriminë, trishtimin, shkurt, pa trutë e tyre, me të cilët truri i tij i fuqishëm, donte apo s'donte ai, ishte në lidhje e rikumbim të vazhdueshëm.

Eskili, ky humbës i madh

Pas letrës së vajisur të dritares së tij kalimtarët ngjanin si hije. Ja, këta janë grekët, duhet të ketë thënë herë pas here me vete, në ato çastet e pushimit, kur mendja e lodhur vetvetishëm gjente një mënyrë të shkarkohej nga rëndimi me ndonjë përsiatje të thjeshtë e limpide. Grekët, që ai i tërhiqte prej realitetit për t'i bërë personazhe të tragjedive të tij. Ky kalim nuk ishte më pak i mundimshëm se kalimi i përfytyruar prej ferrit në jetën e gjallë, ose anasjelltas. Ndaj në dramat e tij ata ishin aq të shfytyruar, saqë nuk njiheshin. (Dhe ndoshta pikërisht në këtë çast konvertimi kishte lindur së pari kërkesa për maskën e teatrit).

Po ç'ishin në të vërtetë grekët? C'kishin të veçantë prej të tjerëve?

Pa dyshim që kishin shumë gjëra. Ata kishin një vend të bukur, klimë të mirë, ullinj, det, gjuhë të mrekullueshme, muzikë, mermer për të ngallur të vdekurit. Ata ishin të zgjuar, dinakë, aventurierë të guximshëm. Ata kishin shijen e së bukurës, filozofine, ndjenjen e masës, kodin moral, konceptin e demokracisë. Ata kishin mitologjinë, tempujt, përmasën e ferrit, fatalitetin. Ata kishin plot gjëra të tjera, për të cilat me të drejtë ishin krenarë.

Por, ndonëse i kishin të gjitha keto dhe për një çast mund të dukej se s'kishin nevojë për asgjë, erdhi një ditë që ata u pasuruan me një thesar të ri.

Ashtu si njeriut që befas, pas një kohe shumë të gjatë dhe tamam atëherë kur s'e pret, i vjen kujtimi turbullues i një krimi që ka bërë në rini, ashtu edhe popullit grek në moshën e pjekurisë iu

Eskili, ky humbës i madh

zgjua befas vrasja e ndërgjegjes për një dhunë të kryer në rininë e tij. Tetëqind vjet më parë kishte mbetur në gjumë një popull tjetër, trojanët.

Pendimi kolektiv, brejtja e ndërgjegjes në përmasat e një populli mund të tingëllojë si diçka e kërkuar, jo fort e besueshme, por fakti që ky pendim u bë ushqimi kryesor i letërsisë antike greke është i mjaftueshëm për të besuar se ai ka qenë real. Provo t'i heqësh Trojën, provo, pra, t'i heqësh të vdekurin që vazhdon të rrijë i shtrirë mu në mes të saj si në një ceremoni funebre, dhe letërsisë greke nuk i mbetet as gjysma.

Shkrimtarët grekë i vunë vetes për mision që ta nxirrin nga ndërgjegjja e popullit të tyre këtë krim. Dhe ai u zbulua në të gjitha pamjet e tij prej vetë grekëve, pa kurrfarë shtyse anketë revanshiste të apo presioni ndërkombëtar. E ngjallën yetë, pra, atë Trojë që e kishin rrënuar me kulm e themel, që ishin betuar ta varrosnin aq thellë, saqë asnje dëshmi, asnje zë, as vetë kujtimet të mos mbeteshin prej saj, e nxorën, pra vetë nga varri, i shkundën baltën dhe dëshmuani për të më paanësi, njëlloj si për veten e tyre, në mos më dhimbursisht.

Ishte ky një ekzorcizëm i paparë, një akt tronditës, që lirues e emancipues, i panjohur gjér atëherë. Sepse për herë të parë në Historinë e nierëzimit ndërgjegjja e një populli vihej në një trazim të tillë.

Kjo tregon se ky popull ishte tashmë i aftë për vepra të mëdha.

M
+
L

3

Tri kanë qenë mundësítë e letërsisë botërore lidhur me Eskilin: letërsia botërore pa Eskilin, letërsia botërore me Eskilin, ashtu siç e kemi sot, letërsia botërore me Eskilin e plotë, domethënë jo me shtatë, por me nëntëdhjetë tragjeditë e tij. Siç dihet, nga të tri zgjedhjat njerëzimit i mbeti e dyta, pra, e mesmja, një zgjidhje kompromisi, siç do të quhej në politikë.

Ne nuk e dimë si do të ishte letërsia e botës sonë pa Eskilin. Dimë vetëm se mosqenia e tij do të prishët në mënyrë të ndjeshme drejtpeshimin e saj. Si do të ishin magjistrat e Shekspirit, si do të ishin Makbethi dhe Hamleti i tij, me se do të zëvendësoheshin fantazma e Bankos dhe e mbretit Hamlet? Mënyra të tjera do të kërkonin ndoshta dramaturgët për të dhënë brengën e ndërgjegjes njerëzore, diçka do të gjenin pa dyshim, por ajo që zbuloi dymijë e pessëqind vjet më parë dramaturgu i shogët në dhomën e tij pa libra është e pakapër-
cyeshme.

Eskili, ky humbës i madh

Kur shikojmë ndonjë interpretim të sotëm të Shekspirit, kur shikojmë, p.sh., se si fantazma e mbretit Hamlet jepet si një agjent zbulimi i shtetit fqinj, i maskuar si fantazmë, i dërguar që t'i zbulojë princit trashëgimtar se, sipas të dhënave që disponon shteti i tij, mbreti nuk ka vdekur, por është vrarë nga i vëllai, si rezultat i një komploti etj., etj., në fillim mund të na duket kjo interesante dhe e logjikshme dhe kureshtjeshuarëse. Mirëpo shumë shpejt e kuptojmë se e gjithë kjo është e mangët dhe mediokre dhe se fantazma është më e vërtetë se çdo qenie reale. Ajo është më e plotë, ngaqë në mënyrën më të plotë mishëron gjithë procesin e dyshimit, ku janë edhe pandehmat e para të princit për një vrasje të mundshme, edhe mërmërima popullore, të cilës asgjë s'i shpëton, edhe intuita, parandjenja e keqe, frika e gjer te intoksiki mi (po t'iu ketë mbetur merak) i kundërzbulimit të shtetit fqinj...

Pra, në qoftë se e kemi vështirë ta hamendësojmë letërsinë botërore pa Eskilin, ndoshta po aq vështirë, në mos më tepër, do ta kemi ta gjejmë si do të ishte ajo me Eskilin e plotë. Në c'masë do të rritej shtati i vetë dràmaturgut, prej të cilit na ka mbetur vetëm tetë për qind e veprës? Që ai shtat s'do të rritej në përpjesëtim të drejtë me numrin e dramave, kjo merret me mend. Të tjerat s'dihen.

Që ai është humbësi më i madh, jo vetëm midis shkrimtarëve, por midis tërë gjinisë njerëzore, kjo gjithashtu dihet. Humbja e tij është e llajit të titanëve, ashtu si edhe thesari i tij. Ai është kështu dydimensional: në dritë dhe në hije të për-

Eskili, ky humbës i madh

jetshme. Ai përsërit kështu botën, ashtu siç e përfytyronin grékët: me jetën dhe me terrin infernal bashkë. Humbja është pjesë e tij dhe çdo studim për Eskilin nuk mund të jetë i plotë pa atë bosh. Ai të rrethon nga të gjitha anët. Për çdo hulumtues të tij vjen një çast që bie papritur nata dhe më kot mund të kërkosh rrugën dhe të pyesësh ç'ka këtu, ç'ka aty... Askush nuk të përgjigjet. Nuk mund të ketë, pra, studim pa atë zbrazëti, rrjedhimisht, nuk mund të ketë kurrë një studim të plotë për Eskilin.

*fushë
zgjedhje*

4

Thuhet se vetë ai ka deklaruar se vepra e tij
dhe ajo e kolegëve të tij «s'janë veçse thërrime nga
gostia e Homerit», por kjo thënie, në qoftë se është
e vërtetë, s'është veçse një figurë e bukur, sepse në
të vërtetë si Eskili, ashtu dhe fragjiket e tjerë të
mëdhenj kanë qenë në të njëjtën gasti. Është e
vërtetë se gjithë letërsia antike greke është ushqye nga
motivet homerike, por këtu s'duhet harruar, po të
vazhdojme figuren e gostisë, se edhe Homeri i
madh u ul në një tryezë të shtruar plot të një para-
gostie të madhe: atë të mitologjisë greke, pjellë e
përbashkët e një populli që është gdhirë në më-
ngjesin e qytetërimit botëror. I dehur nga drita, ky
popull krijoi një univers të tërë qeniesh hyjnore
e tokësore, të pavdekshme e të vdekshme, me his-
tori, drama, pasione e raporte nga më të ndërlí-
kuarat. Kjo popullata personazhesh e mbushte bo-
tën që nga Olimpi me dëborë gjer në thellësi të
detit, nga oborret mbretërore gjer në shpellat e

egra, — nga nëntoka e errët gjer në yjet e Udhës së Qumështit.

Homeri ishte i pari që mori ç'deshi nga «gostia mitologjike», nga ato epose të pafundme që duhej të kishin gjällirë përbri njëri-tjetrit dhe që kohë i ka zhdukur, duke lënë tek-tuk tituj të tyre: «Nestoriada», «Tebaida», «Edipodia», «Danaida», «Agamemnoida» etj. I shpérndarë tejembanë Gadishullit Ballkanik si një materie kozmike, prej së cilës do të krijoheshin më pas sisteme kryeveprash, universi mitologjik ishte i pashtershëm.

Sic dihet, mendimi që ka sunduar prej shekujsh se tragjedia e ka zanafilën te festat dionisiake, éshtë vënë në dyshim vitet e fundit prej dijetarësh bashkëkohorë. Ata ngulin këmbë se karakteri zbavitës dhe i shthurur i këtyre festave s'ka asgjë të përbashkët me tragjedinë antike, se maskat si element bashkues janë fare të pangjashme, ngaqë ndryshe nga festat, ku mbaheshin maska kafshësh, maskat tragjike ishin njerëzore dhe, së fundi, se një pjesë e keqkuptimit për origjinën e tragjedisë ka ardhur prej vetë emrit «tragjedi». Ç'është e vërteta, prejardhja e saj prej *tragos* (ciap) dhe *aide* (këngë), me fjalë të tjera, emërtimi i tragjedisë si *cjak*-*këngë* dhe sidomos i tragedianëve (*tragoidos*) si *cjak*-*këndues*, do t'i zhgënjente jo pak ithtarët e teatrit tragjik.

Mirëpo, na pëlqen apo s'na pëlqen ne, ciapi ishte mu në mes të kësaj pune. Ai ishte çmimi që fitohëj prej dramaturgut, ose kafsha që fliohej përfestën. Në këtë mënvëre bakesh tinëzare, do të thoshin disa. në mënyrë plotësisht të merituar (me çmimin

e gjakut të vet), do të kundërshtonin të tjerët, në këtë mënyrë të tërthortë, pra, gjë fort e zakonshme kjo në historinë e gjuhëve, cjapi e stampoi emrin e vet në emërtimin e gjinisë më sublime të artit. Duke vënë në dyshim me të drejtë prejardhjen e tragedisë prej festave dionisiake, mbrojtësit e tezës se tragedia është një shpikje krijuesish nuk kanë të drejtë, megjithatë, kur për shkak të buri mit që rezulton sipas tyre i gabuar, i mohojnë asaj çdo burim. Teza e tyre se tragedia antike greke, si dukuri, veç të tjerash, sociale, ka një datëlindje e lulëzim (fillim të saj ata quajnë datën kur qeveritari i Athinës, Soloni, u largua i zemëruar nga një shfaqje, me gjithë mbrojtjen që deshi t'i bënte asaj Thespisi), pra, teza se lulëzimi i tragedisë si institucion qytetar lidhet me një kohë të përcaktuar qartë (datat e shfaqjeve të konkurseve, të censurës etj.), nuk përjashton aspak që ajo të ketë po ato rrënëjë të largëta që kanë të gjitha artet dhe që ta ketë zanafillën në po atë fillim pa fillim që është anonimi.

Tragjedia antike greke pati paraprojektet e saj, që ishin mbështetur gjithashtu në paraprojekte të tjera, e këto në të tjera, e kështu me radhë, për të ardhur gjer te mendimi i Miloszit për «Komedinë hyjnore».

Festat dionisiake tepër të bujshme e të zhurmshme e kishin lehtë të shpalleshin si nënë e tragedisë, ato që fare normalisht mund të kishin për bijë të tyre varietenë. Tepër komode për mendësinë akademiko-shkollareske, për shkak të ngjashmërisë së sipërfaqshme me teatrin, ato mënjanuan me të



Eskili, ky humbës i madh

drejtë dy ceremonitë kryesore të jetës njerëzore, ritualin e dasmës dhe atë mortor, të cilave tragjedia u detyrohet tepër.

Këto dy ceremoni, që janë kaq të ndryshme e njëkohësisht aq të ngjashme me njëra-tjetrën (siç është thënë më parë, një ritual mortor te shqiptarët nuk është veçse një dasmë e kthyer me kokë poshtë), kanë qenë përmijëvjeçarë të tërë institucion kryesor kulturor i këtyre popujve ballkanas. Ngjashmëria e tyre nuk është një rastësi: ajo rrjedh nga përfthimi i jetës dhe i vdekjes si një dukuri unike, me dy përmasa që janë të pranishme te njëra-tjetra.

Duke qenë ceremonitë më tronditëse dhe njëkohësisht më të përhapura te njerëzit, ritualet e dasmës e të mortit ishin njëkohësisht shkolla e parë e edukimit estetik. Në kurrfarë ceremonish të tjera nuk mund të kishte një trazim të brendshëm shpirtëror të të gjithë pjesëmarrësve si në një dasmë ose në një mort. Gëzimi, pendimi, brenga, rrëmbimi i nuses, përndezja, hakmarrja e të vdekurit, tërbimi, ishin të gjitha aty, të mbledhura në një sipërfaqe të ngushtë, gati-gati në një skenë.

Në asnjë ceremoni tjetër nuk mund të ndodhte që në qendër të vëmendjes të gjendej vetëm një personazh, i vdekuri, në ceremonialin mortor, ose një çift personazhesh, nusja me dhëndrin, në dasmë. Ç'rëndësi kishte se ata ende nuk flisnin? Ata rrezatonin gjithfarë pasionesh dhe mendimesh rrëth e rrrotull. Pjesëmarrësit e ceremonisë vihesin në raport me ta, e mendonin veten në vendin e tyre, të martuarit kujtonin martesën e tyre të lumtur ose

të palumtur, të pamartuarit atë ç'ka do të ndodhët, të tjerë përfytyronin si do të vajtoheshin ose do t'u merrej haku pas vdekjes etj., etj. Shkurt, ajri ishte i mbushur me dramë. Dramë që kishte ndodhur, që mund të ndodhë apo që ishte thjesht në kokat e një-rëzve, më e ndërlikuara e të gjithave.

Ky trazim, kjo dehje, kjo dëshirë për identifikim duhej të ishte dhe formulimi i parë i turbullt i kërkesës për artin dramatik. Herë pas here një-rëzit ndienin nevojën për atë ekstazë të provuar pranë fustanit të bardhë të nuses ose ndanë gropës së varrit, mirëpo, a mund të pritej dasma e ardhshme, ose a duhej të paguhej me një vdekje prania në një spektakël të tillë?

«Katharsisi» i famshëm i Aristotelit, ai çlirim që pësonte spektatori gjatë shfaqjes së tragedisë, çlirim nga tensioni, nga «e liga», nga streset, nuk do të ishte i mjaftueshëm për të shpjeguar dëshirën e njerëzve për të shkuar në teatër. Dëshira e një-riut për identifikim me njerëz e fate të tjera, dëshira për shkrirje, shkumëzim, vazhdim, prani në jetë e pasioneve të panjohura, shkurt, dëshira për një komunikim më të madh me gjithë bashkësinë njerëzore, dëshirë që shpjegon në njëfarë mënyre nevojën e tij për artin në përgjithësi, do të plotësonte ndoshta edhe shpjegimin përsë njeriu shkon në teatër.

Po le të kthehem i ceremoniali i dasmës dhe i vdekjes. Në asnjë rajon të botës këto rituale nuk janë aq të ngjashme me shfaqjet teatrale sa te popujt e Gadishullit Ballkanik. Ngjashmëria ka qenë veçanërisht e fuqishme te grekët e te shqiptarët.

Eskili, ky humbës i madh

Sic ka thënë linguisti gjerman M. Lamberg, ende sot rituali i dasmës te shqiptarët nuk është gjë tjetër veçse mbeturinë e skenarit të dikurshëm të rrëmbimit të gruas. Mënyra e ardhjes së krushqve, mënyra e pritjes, epitetet që karakterizojnë nusen e dhëndrin (ajo thëllëzë-viktimi, ai skifter-rrëmbyes), të shtimet me armë, ndërrimi i rrugës së kthimit, rregullat e lëvizjes së karvanit të dasmorëve gjatë ecjes, që të kujton tërheqjen pas kryerjes së aksionit, etj., nuk janë veçse fazat e një rrëmbimi, me të vetmin ndryshim se tani ai nuk ndodh, por «lulet».

Kaq i fortë është kujtimi i këtij plani të dytë në dasmën shqiptare, saqë ende sot, në kushtet e jetës moderne, ai ka mbetur, veç të tjerash, gjér në ndryshimin e itinerarit të taksisë, me të cilën njerëzit e burrit çojnë nusen në shtëpinë e vet. Asnjë shofer shqiptar taksie nuk habitet kur përcjellësit e nuses i kérkojnë që ai të ndryshojë itinerarin. pavarësisht se itinerari i kérkuar prej tyre mund të jetë në kundërshtim me çdo logjikë.

Jo më pak të ngjashme, në mos më tepër, janë ritet e vdekjes, duke nisur nga kodi i shpalljes së saj, që në kushtet e mungesës së postës bëhej me anë të britmave nga mali në mal, te mbrojtja e «gjamëtarëve», te shenjat që duhej të kishin në ftyrë nga gërricja dhe që në njëfarë mënyre ishin maska e parë tragjike, e gjer te vajtojcat, gra që kishin për profesion qarjen «me ligje», domethënë qarje të shoqëruara me tekst. Vetë fakti që, duke qenë profesioniste, ato thirreshin në të gjitha vdekjet, për të formuluar në një mënyrë më të rregullt

Eskili, ky humbës i madh

dhembjen e çorganizuar e spontane të të afërmve të të vdekurit, për «ta luajtur», pra, më tepër se për ta ndier realisht atë dhembje, tregon se vetëm një hap i ndante këto gra nga aktoret profesioniste.

E gjithë kjo lidhej përgjithësisht me ritin e vdekjes, por le të përpinqemi të përfytyrojmë se ç'ndodhët në një ceremoni mortore, ku i vdekuri nuk është thjesht një i vdekur, por një i vrarë për arsyen gjakmarrjeje, gjë aq e shpeshtë kjo në bje-shkët shqiptare. Sipas rregullave kanunore, vrasësi ishte i detyruar të merrte pjesë në varrimin e viktimës, madje edhe të ulej në tryezë në shtëpinë e të vrarit për të ngrënë drekën e mortit. Është pak të thuhet se jemi afér dramës. Drama është e gjitha aty, duke i lidhur të gjitha me fijet e saj, si në teatrin total.

Në themel të tragedisë antike qëndron të shumtën e herës një gabim fatal, një faj që kërkon shlyerje, një krim, një vrasje. Vrasja kanunore, ash-tu siç ka mbërritur ajo gjer pak kohë përpara te shqiptarët, e ka pasur në vvetvete estetikën tragjike dhe njeriun me ndërgjegje tragjike, dy elemente të nevojshme të teatrit dramatik. Siç do të shihet më poshtë, kur të flitet për «Orestian», Eskili duhet ta ketë njobur mirë atë cka ndodhë jo vetëm brenda Greqisë, por në krejt Gadishullin e madh Ballkanik.

Që të kthehem i te ceremoniali i vdekjes, le të kujtojmë, së fundi, një personazh të rëndësishëm të tragedisë antike: hijen ose fantazmën. Fantazmat bashkë me èndrrat e natës, parandjenjat, ank-thet etj., ishin sipas mendësisë greke zona ndërmjet

Eskili, ky humbës i madh

tëse midis botës njerëzore dhe asaj hyjnore. Si të tilla, ato luanin një rol të rëndësishëm për çuarjen e mesazheve nga njëra botë në tjetrën. Është e kuptueshme që në skenën tragjike, atje ku shpesh bëhet fjalë për vrasje e krime të mbuluara, roli i fantazmës si dëshmitare, zbuluese, nxitëse e hak-marrjes ose e brerjes së ndërgjegjes, rritet në mënyrë të ndjeshme. Por, siç e ka shpjeguar në mënyrë të shkëlqyer J.P. Vernant, në origjinën e fantazmës ose të hijes është guri i varrit. Kësisoj, prapë kemi të bëjmë me një element të ceremonialit mortor ose, më saktë, postmortor.

Guri i varrit, ashtu i gjatë dhe i ngritur vertikalish, tregonte se poshtë tij, nën tokë, ishte i vdekuri, ai që kishte ikur nga kjo botë, duke lënë në të shëmbëlltyrën e tij. Pra, guri i varrit ishte përfaqësimi, dyzimi, hija e të vdekurit. (Për të zhdukurit në rrethana misterioze, për shpirrat që mendoheshin si bredhës e të paqetë, sajoheshin madje varre bosh, me qëllim që guri i varrit të ndillte më në fund të ndjerin.)

Në mendësinë e popujve ballkanas guri, përgjithësisht, me peshën, heshtjen dhe ftohtësinë e tij lidhej me vdekjen. Në Greqi dhe në Shqipëri ende sot njerëzit betohen «për këtë gur». Së fundi, për të çuar më tej mendimin e J.P. Vernantit, shprehja «i heshtur si gur varri» është kuptimplotë. Epiteti «i heshtur» bashkë me konstatimin ka brenda kërkësen e tërthortë për të folur, kërkësë që s'merret parasysh nga tjetri. Por kërkesa për të mos qenë i heshtur nuk i bëhet çdo objekti, por atij që e ka këtë mundësi. Guri i varrit mund të fliste, sepse ai

Eskili, ky humbës i madh

është dyzimi, hija e dikujt. Nën dritën e hënës, në muzgun me mjegull gurët e varreve ruanin hesh-tjen e tyre. Por ajo s'do të vazhdonte gjatë, do të vinin poetët, do të vinin dramaturgët e mëdhenj që do t'ua hapnin më në fund gojën. Ata do të thërrisin në skenë hijet, në mënyrë që spektatorët, me flokë të ngritura nga tmerri, të dëgjonin dëshmitë e tyre.

5

Përveç motiveve e ideve që Eskili mori prej sofrës homeriike dhe parahomerike, ai është autor i ideve të reja origjinale, njëra prej të cilave, ajo e «së drejtës», e përshkon si lajtmotiv gjithë veprën e tij. Dhe kjo haset qartë jo vetëm te drama e tij me subjekt bashkëkohor «Persët», ku është e kuptueshme se shkrimtari dhe ushtari që mbrojti me armë në dorë Greqinë prej pushtuesve persianë, është me «të drejtën» e Greqisë. Eskili e shtrin dhe e universalizon problemin e «së drejtës» në çdo gjë, sepse çdo akt njerëzor, sipas tij, e shtron këtë çështje.

Se ç'është e drejtë dhe ç'është e padrejtë, thottë tragjiku i madh gjatë gjithë veprës së vet, nuk është pérherë e lehtë të gjendet. Dhe jo vetëm kaq. Pas gjetjes së saj është po aq e vështirë, në mos më tepër, të bindësh publikun pér të.

«E drejta» ose «të drejtat», sipas Eskilit, bëhen disa herë të mjegullta, sepse ato janë në kon-

Eskili, ky humbës i madh

flikt të vazhdueshëm. Ka njerëz që pranojnë se «e drejta» mund të jetë njëkohësisht te të dy palët kundërshtare, — vazhdon Eskili, — por këta janë indiferentët, të lodhurit dhe shpirtdobëtit. E drejta s'mund të jetë kurrë e të dy palëve, — ngulmon ai, — ajo i përket vetëm një ane.

LN

Duke pohuar një ide, trazimet e së cilës në mijëra forma kanë mbërritur gjer në kohën tonë, Eskili është edhe më tepër origjinal kur thotë se «e drejta» nuk është e palëvizshme, përkundrazi, ajo mund të shtegtojë, mund të zhvendoset nga njëra palë te pala kundërshtare. Me fjalë të tjera, teprimi i mbrojtjes së të drejtës tënde mund të të cojë në padrejtësi ose në ikjen e së drejtës tek armiku yt. Këtë zhvendosje të së drejtës nga njëra palë te tjetra më mirë se kushdo e kanë kuptuar popujt autoktonë ballkanas, midis të cilëve me mijëra vjet ka bërë kërdinë gjakmarrja. Tragjiku i madh, i cili jo vetëm e ka njojur gjakmarrjen, por është marrë thellë me të, në kryeveprën e tij «Orestia» na ka dhënë çelësin për të kuptuar se gjakmarrja ballkanase, e kryesisht gjakmarrja te shqiptarët, ku ajo jetoi më gjatë se kudo, s'ka qenë veçse një rrëth vicioz i tmerrshëm, ku «e drejta», duke u zhvendosur pa pushim nga njëri fis te tjetri (nga ai që kishte për të marrë një gjak, te tjetri, që kishte për ta dhënë), ushqente me mish të freskët vdekjen.

duli

KN

Eskili e ka thënë fare qartë në veprën e tij se teprimi i pasionit, qoffte edhe në mbrojtjen legjitime, bëhet shkas për emigrimin e «së drejtës» te kundërshtari yt, i cili, duke u përgjigjur me të

njëjtën mënyrë, bëhet shkas për brezni të tëra kri-mesh që shoqërojnë breznitë njerëzore.

E gjithë vepra eskiliane është, veç të tjerash, një kambane alarmi për t'i paralajmëruar njerëzit se çdo shkelje e «së drejtës» do të kërkojë përherë shpagimin e saj. Vetë ky motiv dëshmon karakterin e theksuar qytetar e politik të këtyre tragjedive, frymën e lirisë dhe dufin antitiranik që i përshkon ato. Prej skenave të këtyre dramave si një rropamë e pambarim vijnë përlleshjet e popujve, të vendeve e të qytetërimeve të ndryshme, përplasja e ligjeve, luftërat e përgjakshme për pushtet, klithmat e fitimtarëve dhe të mundurve, pasionet brendapërbrenda qenies njerëzore, ambicia, hakmarrja, pesha e krimit, ngritja tragjike e njeriut kundër fatit, përfytyrja dhe rrëzimi prej tij, shkurt, gjithë ajo shtjellë pasionesh e ndeshjesh, në vorbullën e së cilës janë vërtitur papushim miliarda qenie njerëzore.

Që Eskili është marrë aq shumë dhe aq më dhërisht me të drejtën, tregonte se ai hynte ndër ata njerëz që kishin prirje ose, më saktë, psikologji ligjvënësi.

Te shumë popuj të vjetër është e njojur figura e poetit, e magut dhe e mjekut, që shpesh qëllonte të ishte e njësuar te i njëjti person. Shpresë, tmerri dhe përndezja e herëpashershme, që i cili ronte njerëzit përkohësisht prej ankthit të vdekjes, ishin baza mbi të cilën mbështetej autoriteti i magut-poet-mjek. Krahas tij te ballkanasit e vjetër (ndoshta dhe te popujt e tjerë) duhet të ketë qenë edhe një figurë tjetër arketipale po aq e rën-dësishme: ajo e juristikë. Ishte i njëjtësuar ai ose

jo më poetin, magun-mjek, kjo s'kishte fort rëndësi. Thelbi i punës së tij lidhej gjithashtu me shpresën dhe tmerrin.

Figura e juristit popullor, pushteti i të cilët nuk e kishte zanafillën në kurrfarë emërimi apo zgjedhjeje, ka ekzistuar gjer vonë te shqiptarët. Në gjyqësitë kanunore, sidomos në vrasjet dhe në përcaktimin e borxhit të gjakut, ndërhyrja e tij ishte vendimtare. Gjyqësitë e famshme, zgjidhjet, formulimet ose kompromiset e shkëlqyera kalonin gjë më gojë te shqiptarët njëloj si bëmat heroike. Nga kjo pikëpamje figura e gjyqtarit kanunor lidhej me atë të poetit. Por po aq ngushtë lidhej ajo me mjekun, përderisa në gjykimin e vrasjeve për gjakmarrje, në përcaktimin e «së drejtës» për të marrë gjak, ose të «detyrimit» për të dhënë gjak, luante një rol të madh mendimi i mjekut (pozicioni i trupit të viktimit, goditja nga shpina ose nga gjoksi etj.), që përfundonte shpesh gjer në autopsi.

Te vdekja e Agamemnonit përmendet shpesh mënyra «jokorrekte» e vrasjes: pëlhura, që ia paralizoi lëvizjet viktimit, masakrimi pastaj i gjymtyrëve të saj. Kjo e fundit lë të kuptohet se një autopsi e vonë mund të bëhet pas rrëzimit dhe demaskimit të komplotistëve.

Sic u tha më lart, gjyqtari kanunor te shqiptarët nuk emërohej dhe as zgjidhej, qoftë edhe nga ndonjë tubim popullor. Autoriteti dhe fama e tij krijohej ngadalshëm, njëloj si ajo e poetit ose e magut, të shumtën e herëve në shtegtim. Sepse, si shumica e magëve dhe e poetëve, gjyqtarët ishin

shtegtues dhe që nga larg u vinin ftesat për gjyqësi. I vetmi ndryshim i tyre prej poetëve dhe mjejkëve ishte se, ndërsa të parët pavdekësonin mynixrat që shkaktonte vdekja, ndërsa të dytët përpinqeshin të mbyllnin njëfarësoj plagët tashmë të hapura, gjyqtarët e gjakut me një fjalë të tyre qëllonte që ndalonin rrëke të tëra gjaku, që do të shkretonin për dhjetëra e dhjetëra vite fise të tëra.

Duke e lexuar me kujdes veprën e Eskilit, sidomos «Orestian» e tij, mund të thuhet pa frikë se ai ishte po aq poet sa edhe gjyqtar i gjakut. Që të merresh aq shumë dhe aq rëndshëm me të drejtën, do të thotë të ndiesh një përgjegjësi të madhe në veten tënde, të mos hiqesh mënjanë, duke larë duart si Pilat, por të angazhohesh (fjalë aq acaruese kjo për veshin e shumë estetëve) në përfytjen e madhe njerëzore, shkurt, të mbash në dorë një skeptër ligjvënësi, sovrani.

Prej një ndërgjegjeje, prej një psikologjie të tillë rrjedh toni madhor i veprës, përmasat e gjeira, fuqia tërmetore e saj. Ajo e ka peshën e rëndë dhe ajo peshë, bashkë me madhështinë, i kalon veprës së shkrimtarit gjithë zymtinë, barrën dhe dramën e saj. Shkrimtarë të tjerë, për të cilët është i huaj ky angazhim, në vrullin e tyre përtë përligjur, madje për të himnizuar heqjen e tyre mënjanë, rreken të vërtetojnë se është më e vlefshme, më e bukur, madje më e moralshme, të dëshmojnë për shpërbërjen e një fluture sesa të një perandorie. Në mekanizmin e kësaj të fundit mund të jenë mbërthyer vdekshëm fatet e dhjetëra miliona njerëzve, megjithatë, ata janë gati të mbyllin

Orestia

Eskili, ky humbës i madh

sytë përpara kësaj dhe të ngulin këmbë për dramën e fluturës.

Të mëdhenjtë i binden një tjetër ndërgjegjeje. Dante Aligieri nuk mund të jepte atë verdikt kolossal, duke dënuar në nëntë rrathët e ferrit të tij një pjesë të njerëzimit, pa ndier në vetvete gjykatësin suprem. Përpara se të shfaqej Makbethi, thika mbretvrasëse i qe shfaqur me siguri shumë herë Shekspirit, në trurin e shqetësuar të të cilit shumicën e kohës s'bëhej gjë tjetër veç rrënoheshin frone e kurora mbretërish, shembeshin ose riven-dosheshin drejtësira. Kush mund t'i mohojë psikologjinë prej sovrani botëror Don Kishotit të Mançës? Dhe, a mund të shkruhej «Fausti» pa të dhe a mund të krijohej pa të shtjella e zezë e shpirtrave të vdekur që rendin pas karrocës së Çiçikovit?

6

Ka shumë pengesa për të mbërritur tek Eskili. Ato i ngjajnë disa herë një makthi. Gjysmë shekulli pas vdekjes Aristofani e portretizoi si njeri krenar dhe të pasionuar. Nga mbishkrimi mbi varrin e tij dëshmohet se mori pjesë me ushtë në dorë në luftërat kundër «persëve flokëgjatë». Mbishkrimi, që nuk harron të japë modën e mbajtjes së flokëve të kundërshtarëve, nuk e përmend fare veprën e tij. Është një rastësi apo është ndoshta paralajmërimi i parë, formulimi i parë, i dëshirës, i prirjes së dikujt, të vetë epokës ndoshta, që vepra e tij duhej të humbte?

Ajo ç'ka dihet tjetër për jetën e tij është ose e paktë, ose e parëndësishme: është akuzuar se ka nxjerrë të fshehtat e mistereve (të fshehtat teatrore?), se ka fituar dy ose tri herë në konkurset (fitoren e fundit e pati në moshën 67-vjeçare me «Orestian»). Se fill pas kësaj është larguar nga Athina për në Sicili për motive të panjohura (fyer-

Eskili, ky humbës i madh

je nga publiku, nga juritë, për arsyen politike?), ku edhe vdiq në prag të të shtatëdhjetave. Gojëdhëna e vrasjes së tij prej një shqiponje, e cila, duke e pandehur kokën e tij pa flokë për shkëmb, lëshoi sipër saj breshkën e kapur, hyn ndër legjendat, që dikujt mund t'i duken me ngarkesë simbolike, por që më shumë ka gjasë të jetë fare e pakuptimtë, siç janë disa herë legjendat për njerëzit e mëdhenj.

Sikur të mos mjaftonte kjo mjegull rreth e rrotull tij, një gropë e errët e humneron atë tej-përtej: humbja e shumicës së dramave. Ngado që të vërtitemi, na del përpara kjo gropë. Çdo rrugë kryqëzohet me të. Nga kjo pikëpamje, për Eskilin dimë më pak edhe se për Homerin, përderisa që prapa mjegullës ku është fshehur, i verbti ka arritur të na e japë veprën e tij, gjë që Eskili s'mundi ta bëjë dot.

Asnjë mbushje, asnjë riparim s'mund të ketë gropa eskiliane. Por ajo, duke qenë kryesorja, nuk është e vetmja pengesë për të arritur tek Eskili i mirëfilltë. Edhe për veprën që ka shpëtuar nuk mund të thuhet se s'ka mangësira, pasaktësira dhe humbje. Dhe kjo është e kuptueshme, përderisa tekstet që kanë arritur gjer në kohën tonë nuk janë veçse kopje të kopjeve, të shkruara brez pas brezi nga shkrues të ndryshëm të epokave të ndryshme. Vështirë të besohet se filli i origjinës së ndonjë kopjeje arrin, në mos jo gjer në dorëshkrimin fillestare, që ngjan krejtësisht e pabesueshme, por, së paku, gjer në ndonjë nga tekstet e shumëfishuara, nga ato që u ndaheshin aktorëve gjatë përgatitjes së shfaqjes.

Eskili, ky humbës i madh

Por edhe tekstet e stërvjetra, prej të cilave janë kopjuar tekstet e vjetra dhe që i ndajnë gati një mijë vjet nga dorëshkrimi fillestar, janë plot pasaktësira. Fjalët janë të pandara nga njëra-tjetra, shenja pikësimi pothuajse s'ka, vargjet janë të shkruara si në prozë, përkatësia e tekstit e secilit personazh është shkruar vetëm me një vizë dhe pa saktësi.

Të gjitha këto e bëjnë tejet të vështirë rikonstruksionin e tekstit eskilian. Ritmi i vargjeve dhe gramatika diçka ndihmojnë në qortimin e mangësive, por ato s'janë vendimtare. Duke u shtuar të gjitha këtyre edhe faktin që pas vdekjes së tragjedianit dramat vazhduan të shfaqeshin dhe se tani që autori mungonte ishte më e lehtë të vihej dorë mbi pjesët e tij (dëshira e pashmangshme e çdo vënësi në skenë), është lehtë të merret me mend dëmtimi i origjinalitetit prej ndryshimeve të pjesshme, që nisin nga zëvendësimi i ndonjë fjale te heqja apo zëvendësimi i ndonjë vargu, e gjer te ndryshimi i një pasazhi të tërë.

Fakti që ekziston një vendim i Likurgut për përpilimin e një teksti zyrtar të të tre tragjikëve të mëdhenj: Eskilit, Sofokliut dhe Euripidit, rrëfen më së miri se duhej një ndërhyrje ligjore për të ndaluar ndryshimet e tekstit, sëmundje që mund të shkaktonte shfytyrimin katastrofik të tragjedive gjeniale.

Historia e kopjimeve dhe e botimeve të mëvonshme të dramave të Eskilit, si dhe të bashkë-kohësve të tjerë të mëdhenj, as nuk u zgjidh, as nuk mbaroi me dekretin e Likurgut. Ajo është një

kronikë e gjatë, qysh nga interesimi i veçantë i peripatetikëve për të, te botimet aleksandrine, e gjer tek ato romake, kronikë shekulllore, e çuditshme dhe shpesh misterioze, gjatë së cilës jo vetëm vazhdoi gërryerja e ngadaltë e tekstit nga duart e panumërtë, anonime të shkruesve (skribëve), që e transmetonin atë nga shekulli në shekull, por ndodhi edhe tragjedia më e dhimbshme e këtyre kryeveprave: humbja e shumicës së tyre.

Që shkruesit, shumica murgjër, në vetminë e trishtueshme në të cilën punonin, të zëvendësonin fjalë të vjetra me fjalë të reja, të ndryshonin ndonjë varg ose ndonjë pasazh prej topitjes, monotonisë, lodhjes, harresës, apo thjesht prej manisë për të vënë dorë mbi një tekst, kjo është gjer në një farë shkalle e kuptueshme. Por, që pikërisht në kohën kur pasardhësit u bënë të ndërgjegjshëm se s'kishin të bënin me drama të zakonshme, nga ato që ishin shkruar e luajtur me qindra herë në të gjithë amfiteatrot e Greqisë, të Ilirisë e të Romës, pra, kur të gjithë qenë të ndërgjegjshëm se kishin të bënë me autorë gjenialë e tragjedi gjeniale, shi në këtë kohë të niste edhe humbja e tyre, kjo mbetet disi enigmatike.

7

U kthyem përsëri te humbja. Dhe kjo është e kuptueshme: për humbjen ke përherë dëshirë të flasësh.

Si është e mundur? Jo, s'është e mundur... Janë klithmat e para, kundërshtimi i parë që shqëron çdo humbje, të çdo natyre qoftë.

Si është e mundur që humbën tragjeditë antike?

Kur brenda në një shtëpi ka humbur një kuti margaritarësh, kur jemi qind për qind të bindur se humbja ka ndodhur brenda mureve të shtëpisë, mendimi i parë që na vjen është shpresa se humbja nuk është përfundimtare: sido që të jetë, kutia e diamanteve do të gjendet, përderisa nuk ka dalë përjashta mureve. Do të kthehet shtëpia përmbyss, do të qërmtohet çdo centimetër katror i saj, do të bëhet çmos.

Mendimi i parë për tragjeditë antike do të ishte pak a shumë i kësaj natyre: është bërë ç'është

Eskili, ky humbës i madh

bërë, humbja ka ndodhur brenda planetit tonë, Tokës. Ajo është tepër e vogël për këtë humbje. Sido që të ndodhë, do të qëmtohet çdo kënd i saj, do të përmbysen arkivat, manastiret, bibliotekat. Në fund të fundit, jemi të bindur se tragjeditë humbën këtu në Tokë, dhe jo diku në galaktikë.

E, megjithatë, shpresa ishte e kotë. U hulumtuan për qindra vite me radhë të gjitha këndet e planetit ku ato mund të ishin strukur, por tragjeditë s'u gjetën që s'u gjetën dot. Me sa duket, planeti i vogël ishte i aftë për humbje të mëdha.

Ne s'na mbetet gjë tjetër veg t'i kujtojmë ato me një dhimbje që bashkon shumë breza njerëzorë, të kombeve e të gjuhëve të ndryshme, nëpër qindra e qindra vjet. Pas klithmës së dyshimit për humbjen vjen pyetja tjetër: po si ndodhi?

Si ndodhi që humbën tragjeditë antike? Këtë nuk e di saktësisht askush.

Sic u përmend pak më parë, guri i varrit (që, sipas J.P. Vernantit, duhej të ishte fantazma e Eskilit), kishte dhënë sinjalin e parë se do të kishte humbje. Humbja duhej të ndihej, të notonte në erë qysh në gjalljen e tragjedianit, atëherë kur asnjë nga tragjeditë ende s'kishte firuar.

E ka ndier vallë Eskili atë trysni të shurdhër, të verbër, atë vrimë të zezë që kërkonte të thithë dramat e tij? Pa dyshim që po. Çdo krijues i madh e ndien kur vepra e tij krijohet nën kërcënimin e humbjes. Humnera që është dy hapa larg tij ndikon ditë e natë mbi të, ndjell, zymton, paralajmëron.

Eskili, ky humbës i madh

Tragjeditë ishin të shkruara në disa lloje papirusesh. Me përjashtim të atyre që do të shfaqeshin, teksti i të cilave u qe ndarë aktorëve, të tjera të ishin zakonisht në një kopje. Mjaftonte që dikujt t'i shkrepente në kokë, një armiku të tij, një rivali, një të çmenduri, një të dehuri, që t'i zhdukte ato benda pak çasteve.

Por nuk ishte ky rreziku kryesor, në fund të fundit, një rreziku të tillë mund t'i dilej përpara, duke depozituar një kopje të dytë në një vend më të sigurt. Ishte një tjetër kërcënim më serioz se ky. Disa vite më parë një dramë e Frinikut me subjekt bashkëkohor «Marrja e Miletit», qe ndaluar nga autoritetet, ngaqë shfaqja i kishte mërzitur athinasit, duke u kujtuar tmerret e luftës me persët, e cila porsa kishte mbaruar. Po të kujtojmë dhe ikjen e zemëruar të Solonit nga teatri dhe dialogun e tij me Thespisin, na bëhet e qartë se qysh në fillimet e tij teatri ka pasur probleme me censurën.

Çështja bëhej edhe më e ndërlikuar kur censurës zyrtare i shtoheshin edhe kërkesat e spektatorëve. Që shija publike bënte një presion jo të vogël mbi tragjedinë, këtë e vërteton fakti që një pjesë e trilogjive madhështore përfundonin me një dramë të katërt satirike. Kjo shtojcë e panevojshme, pararendëse e «happy end-it» dhe e klishevë të mëvonshme komerciale, nuk ishte veçse një konformizëm, një taksë që tragjedianët gjenialë qenë të detyruar t'i paguanin shijes së kohës.

Koha, natyrisht, e donte tragjedinë, përderisa e pollë atë, por ndërkaj ajo kishte rezervat e saj,

Eskili, ky humbës i madh

që i shfaqi në format më të ndryshme. Krahas «lobit» protragjik, një korrent antitragedian duhej të ishte i pranishëm në shijen dhe mendësinë e grekëve. Zhvillimi i komedisë ishte ndoshta një kërkuesë e lobit të kundërt. Kurse nervozizmi i Platonit ndaj ithtarëve të teatrit tregon rezervën e tij ndaj artit të skenës në përgjithësi.

Kur sjellim ndër mend ikjen e zemëruar të Solonit nga teatri, s'ka se si të mos kujtojmë një ikje tjetër, atë të Eskilit nga Athina. Kjo ikje ridëshmon për ftohtësinë ndaj tij. Por, kur themi ftohtësi ndaj Eskilit, duam të themi ftohtësi ndaj tragjedisë, që ai e krijoi.

Në kohën tonë duket absurde që censurimi i një libri të lidhet me ndalimin e librit në përgjithësi, por në kohën kur tragjeditë numëroheshin me gishta të dorës, një hap e ndante në kokën e censorit ndalimin e njërsës tragjedi nga tragjedia në përgjithësi si gjini.

Pyetja nëse duhej apo nuk duhej ky lloj arti, duhet të jetë bërë jo një herë në kokat e shumë njerëzve në atë kohë. Ajo duhet të ketë depërtuar madje në kokat e vetë tragjedianëve, në atë shqetësim, që shumë shekuj më vonë e shprehu Sergei Esenini, kur me ndërgjegje të shqetësuar shkroi se kënga e tij, në vend që t'i bënte mirë, ndoshta «i prishtë gjumin vendit të tij». Tragjedianët grekë kishin mjaft arsyë për të besuar se veprat e tyre ishin të afta t'i prishnin gjumin jo vetëm Greqisë, por gjithë popujve të rruzullit tokësor. Vecse kjo ishte një prishje gjumi e lumtur.

Ikja e Eskilit nga Athina duhet të ketë qenë,

Eskili, ky humbës i madh

gasti më patetik i tij. Atë pikëllim që provojnë brezat e njëpasnjëshëm njerëzor për humbjen e vepërës së tij, ai duhet ta ketë ndier të dendësuar në ato çaste të para të largimit. I kishte kthyer shpinë Athinës, kryeqytetit të botës, të dritës, të teatrit. Po linte prapa gjithçka, në radhë të parë, dramat e tij. Po i linte, po i humbte përgjithmonë, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Sepse humbja ishte e prekshme, fizike, ashtu siç është humbja e teshave, e bizhuve. Dhe kjo për disa arsy. E para, se marrja me vete e dorëshkrimeve nuk ishte një gjë e thjeshtë, si në kohën tonë. Të shkruara në pllaka ose në lëkurë dorëshkrimet e nëntëdhjetë dràmave të tij duhej të peshorin, së paku, disa kuintalë. E dyta dhe kryesorja, edhe në qoftë se gjente një mundësi për ta ngarkuar në karrocat e më pas në anije gjithë atë pirg pllakash e lëkurësh, përsë do ta bënte këtë? Ç'i duheshin pa teatrin?

Në kohën kur nuk ekzistonte koncepti «botim i veprës», vepra dramatike nuk mund të kishte kurrfarë jete jashtë teatrit. Frymëmarrja e saj, parajsa dhe ferri i saj ishin aty, në shkallët e gurta që gumëzhanin nga spektatorët. Shtoji kësaj edhe faktin që me vdekjen e autorit zakonisht dramat nuk viheshin më në skenë, për të përfytyruar atë ndjesi të humbjes totale që duhet të ketë përjetuar ikanaku shtatëdhjetëvjeçar, ai që aq bukur kishte përshkruar, midis të tjerash, brengën njerëzore.

Ai që kishte dhënë mendime titanike për ngrijen dhe rrëzimin e perëndive, për përplasjen e lligjeve dhe për ankthet e epokave, për përkohshmërinë e jetës dhe fatalitetin e gjërat, s'kishte si të

Eskili, ky humbës i madh

mos e ndiente se vepra e tij, pavarësisht se mertonte pavdekësinë hyjnore, do të zhdukej. Epoka e grekëve ishte aq demokratike, sa të mos e njihte ende masakrën e librave. Por, ndërsa nuk dha kurrfarë verdikti kundër dramave antike, koha dha vetëm një sinjal: ato **drama mund të humbnin**.

Guri i varrit, dyzimi i tragjedianit të vdekur, e ka gdhendur sipër tij këtë sinjal.

Kohë të tjera do të vinin me arsyen e ngjashme, por me mjete të tjera, shumë më të rrepta. Më i rreptë do të ishte dhe verdikti i tyre: tragjeditë duhej të humbnin.

8

E, megjithatë, si duhet të ketë ndodhur kjo?

Pyetja është përsëritur nga shekulli në shekull, siç përsëriteren zakonisht pyetjet kur përgjigjet nuk janë bindëse.

Një qind e ca vjet më parë një stufë e ndezur asgjësoi brenda disa sekondave atë që koha do të duhej ndoshta ta bënte, madje me shumë vështirësi, gjatë qindra vjetëve: pjesën e dytë të «Shpirtrave të vdekur» të Gogolit.

Humbja e tragjedive antike s'ka asgjë të përbashkët me atë tis harrese, me anë të të cilët koha mbulon dalëngadalë, gjersa i varros përfundimisht, shumicën e krijimeve të mendjes njerëzore. Procesi i seleksionimit, qoftë në formën e tij të mirëfilltë shumëshekullore, qoftë në formën e aksidentit, si rasti i stufës së Gogolit, vrundulli i flakës të së cilës zëvendësoi mijëra polemika, studime e simpoziume të ardhshme, nuk ka asnjë lidhje me çështjen eskiliane. Nuk pati asnjëherë seleksionim të tragjedive të Eskilit e të Sofokliut. Pati vetëm shpëtim

Eskili, ky humbës i madh

të rastit të një pjese të vogël të tyre. Pra, jo humbja, por shpëtimi ka qenë rastësi.

Siq u tha më lart, humbja është pjesë e veprës së tij titanike. Ajo s'ka të bëjë me djegjet e dorëshkrimeve (Gogoli), as me dëshirën për asgjësimin e veprës (Kafka), as me mohimin e saj. Seria e parfundme e vetëvrasjeve të shkrimittarëve është konsideruar gjithashtu shpesh si pjesë e veprës së tyre, epilog, manifest, madje koment përfundimtar i saj.

Në tjetër kuptim, humbja e tragjedive antike është pjesë e veprës së tragjedianëve. Ajo ka ndodhur krejtësisht jashtë vullnetit, dijenisë dhe ndërgjegjes së tyre.

Pushkini i shtrirë në déborë nga plumbi i një kretini e ka trazuar ndoshta shpirtin rus më shumë se ç'do ta trazonte vepra e ardhshme që ai do të krijonte pas atij mëngjesi fatal... Tragjeditë e humbura antike janë gjithsesi të pakompensueshme.

Studiuës të ndryshëm janë përpjekur ta shpjegojnë njëfarësoj këtë dukuri të habitshme, por jo në mënyrë bindëse. Disa e nisin kronikën e humbjes me botimin romak të veprave të zgjedhura të tre tragjikëve të mëdhenj në kohën e perandorit Adrian. U botua një përbledhje e veçantë e secilit tragjedian, e bërë, me sa duket, nga i njëjti autor. Përbledhja e Eskilit kishte shtatë tragjedi: «Prometeu i mbërthyer», «Persët», «Të shtatët kundër Tebës», trilogjinë «Orestia» (Agamemnoni, Koefforet, Eumenidet) dhe «Lutëset». Janë pikërisht edhe të vetmet tragjedi që kanë shpëtuar.

C'u bënë të tjerat? Që ato ose shumica e tyre ekzistonin gjer në kohën e Adrianit (shek. II), kjo

Eskili, ky humbës i madh

vërtetohet nga vetë fakti që botimi u shpall si një përbledhje e zgjedhur për një publik pak a shumë të gjerë.

Sipas disa studiuesve, kjo përbledhje dramash të zgjedhura luajti një rol të dyfishtë pér tē mirë e pér tē keq. Nga një anë, ajo shpëtoi nga zhdukja shtatë tragjeditë që kemi në duar sot, por, nga ana tjetër, sipas tyre, ajo ndihmoi ose përshtapjetoi harrësën e veprës tjetër të tragjedianit. Gjithmonë sipas këtyre studiuesve, duke u përqendruar vëmendja te shtatë të zgjedhurat («Të shtatat kundër Eskilit» — mund të perifrazonim një nga titujt e tij), vetveti mbeti në fillim jashtë vëmendjes e pastaj u mbulua nga pluhuri i harresës pjesa kryesore e thesarit gjenial.

Arsyetimi i këtyre studiuesve është, pér tē përdorur një shprehje të butë, paksa i çuditshëm. Sepse është vërtet pak e besueshme që leximi i «Prometeut të mbërthyer», në përbledhjen e famshme romake, në vend që tē rikujtonte se ka edhe një «Promete tē çliruar», madje dhe një «Promete zjarrsjellës», dhe tē nxiste kërkimin e leximin e tyre, sipas këtyre studiuesve paska bërë tē kundërtën: ka ndihmuar në harrimin dhe braktisjen e tyre. Po kështu, «Të shtatët kundër Tebës» nuk do tē ndillte harresën, por përkundrazi, ringjalljen e krejt trilogjisë tebane, prej së cilës ka shpëtuar vetëm drama e mesit.

Është e qartë se, në qoftë se botimi i veprave të zgjedhura shpëtoi një pjesë të thesarit, ai kurssesi s'mund tē jetë bërë shkak pér humbjen e thesarit kryesor. Shkak nuk mund tē ketë qenë as

Eskili, ky humbës i madh

gërryerja e kohës, e cila që nga shekulli V para erës sonë e gjer në shekullin I mbuloi e zhduku përgjithmonë qindra vepra e autorë. Nga gërryerja mund të humbnin autorë e vepra të mesme, ashtu siç ka ndodhur pérherë, por kurrsesi kryevepra, madje të shpallura si të tilla pér shekuj të tërë.

Arsyen e vërtetë, atë që u bë fatale pér humbjen e tragjedisë antike, disa nga studiuesit e përmendin shkarazi. Megjithatë, ajo është kryesorja pér të shpjeguar katastrofën. Dhe katastrofa nisi me fushatën e tërbuar të fesë së krishterë kundër paganizmit. Ajo u hovzua sidomos midis shekujve VI dhe X, që ishin, me sa duket, edhe shekujt që u bënnë varri i tragjedive antike. Atë që s'e bëri dot lobi antitragjedian në lashtësi, e kreu mesjeta evropiane-aziatike.

Fushatën kundër paganizmit, një nga më të fuqishmet të shpallura ndonjëherë nga reaksiioni i zi, feja e ktheu shumë shpejt në një fushatë kundër gjithë vlerave artistike të antikitetit, duke e shpalitur gjithçka që ishte krijuar para Jezu Krishtit si pagane dhe të dëmshme.

Feja kishte arsyet e saj pér të luftuar letërsinë antike. Arsyja e parë ishte se krejt struktura e dogmave të saj binte në kundërshtim të hapur me gjithë atë dritë, emancipim dhe ato ide të lira që rrezatonit letërsia antike greke. Në terrin mesjetar, që feja sa vinte e dendësonte, letërsia antike ishte një fener shqetësues që duhej të shuhej sa më parë. Lidhur me këtë kjo letërsi e fuqishme, ky univers artistik i pjellë nga një plejadë gjenish, i bënte konkurrencë «Biblës» së krishterë që feja e kishte

Eskili, ky humbës i madh

shpallur si librin e botës. Mirëpo, përpara fjalës gjeniale të grekëve të vjetër «Bibla» nuk qe veçse një libër i rëndomtë, ashtu siç ishte i rëndomtë Jezu Krishti vetë përpara heronjve bubullues antikë të tipit të Prometeut.

Kjo ishte arsyjeja që feja u përpoq me të gjitha mjetet ta fshinte nga faqja e dheut thesarit antik. Ajo do të dëshironte dhe me siguri është përpjekur të zhdukë çdo gjurmë, por, përfatim e keq të saj dhe përfatim e mirë të njerëzimit, nga rrebeshi i fushatës mundën të shpëtonin tragjeditë e zgjedhura të botimit adrianian. Të tjerat, të cilat ishin në kopje më të rralla, ajo i ndoqi hap pas hapi, ashtu siç ndiqte heretikët dhe «shtrigat», gjersa i shfarosi njëren pas tjetrës. Dhe në qoftë se diçka kishte arritur të shpëtonte në të famshmen bibliotekë të Aleksandrisë, një tjetër fe dhe një tjetër errësirë, ajo e islamizmit, i dogji, këtë herë në emër të biblës së vet, «Kuranit».

Në qoftë se në shekullin X, pas kërdisë së pamëshirshme, vihet re një ringjallje e interesimit përdramaturgjinë antike, këtu është fjala vetëm për veprat e zgjedhura, sepse të tjerat ishin zhdukur pa kthim.

Dhe kështu nisi përsëri historia e gjatë, monotone e kopjimit nga dora në dorë prej shkruesve anonimë e gabimeve, e zëvendësimeve të fjalëve, e harresave, e lodhjes dhe e ndryshimeve të tekstit, disa herë të pariparueshme. Kështu, pas dy mijë e pesëqind vjetësh të kësaj kronike madhërisht të trishtueshme, nga universi eskilian mbërritën gjerte ne vetëm shtatë dramat e tij.

9

«Po atë vit, arqipeshkvi Robert dë Sorbon, rektor i Universitetit të Parisit, priti një farë Gijom Grusak, i paraqitur si tregtar shëtitës pasqyrash rru-dhafshehëse (që s'të tregojnë rruhat), i cili kumtonte se kishte për t'i dorëzuar një gjë tejet të vlefshme.

I sipërpërmenduri i dorëzoi vërtet të ndritshmit Robert dë Sorbon një dorëshkrim të vyer, që ishte, sipas tij, një tekst i vjetër grek. Gjithmonë sipas të sipërpërmendurit, ky dorëshkrim kishte qenë prej vitesh pronë e familjes së tij, madje kohë më parë, në vitin 1209, i ati i tij Pol Grusak kishte ndërmarrë një udhëtim në Angli për t'ia dorëzuar atë kundrejt një shpërbëimi të arsyeshëm Universitetit të Oksfordit, gjë që nuk kishte qenë e mundur të kryhej për shkak të turbullirave, që, siç dihet, kishin ndodhur pikërisht atë vit atje.

Këto gjëra ia kumtoi i sipërpërmenduri të ndritshmit Robert dë Sorbon, i cili ia mbajti dorëshkri-

Eskili, ky humbës i madh

min, që, sipas sjellësit, duhej të ishte i dramaturgut të vjetër grek, Eskilit. Ndërkaq iu premtua sjellësit shuma e kërkuar prej dyzet ekysh, pasi të vërtetohej autenticiteti i dorëshkrimit.

Për këtë Robert dë Sorbon e dërgoi menjëherë tekstin në Abacinë e Klermonit, ku kishte disa murgjér mjeshtër për punë të tilla. Pas një muaji, si erdhi përgjigjja nga Abacia e Klermonit. U thirr prapë në selinë e rektoratit dhe, pasi iu njoftua se dorëshkrimi ishte kallp, u dënua me dyzet shkopinj dhe me burg në rast përsëritjeje.

Ky ishte rasti i katërt i përpjekjes për mashtrim të këtij lloji, prej të cilave tre lidheshin me dramaturgun Eskil. Kjo ndodhi në vitin e bekuar 1257, dy vjet përpara epidemisë së murtajës, që fari një pjesë të Evropës».

Kjo kronikë nuk është e vërtetë. Dhe është shqetësuese pikërisht për këtë.

Ky është një mashtrim, një krim që duhej të ndodhë. Ai do të ishte normal, i logjikshëm, moral. Dhe është anormale, ilogjike dhe amoroale mosndodhja e tij, madje në atë shkallë që do të meritonte vërtet një anketë ose, më saktë, një antianketë përcaktimin e fajtorëve të këtij moskrimi.

Krimi i falsifikimit të Eskilit nuk figuron në asnje kronikë mesjetare e, aq më pak, në kronikat e mëvonshme. Pyetja në këtë rast është e natyrshme: pse vallë të mos ketë ndodhur ky krim?

Falsifikatorët shkrues nuk i kanë munguar kurë kësaj bote. Mjeshtër të vërtetë të kësaj pune, ata e dinin fort mirë bursën e vlerave, ashtu siç dinin si të mos e humbnin kohën kot. Në këtë pi-

Eskili, ky humbës i madh

këpamje, ata kanë qenë përherë një pasqyrë e saktë e asaj çka çmohej e vlerësohej nëpër kohë të ndryshme.

Lindur me siguri fill pas shpikjes së shkrimit e të pikturimit (fleta e parë e shkruar ka pjellë me siguri idenë e parë të falsifikimit, njëlloj si porta e parë e mbyllur ka nxitur ndjesinë e parë të kusarisë), falsifikimi u bë në njëfarë mënyre historia e mbrapshtë e dokumentacionit.

Falsifikohej kudo dhe gjithçka: autobiografi shkrimtarësh, testamente, arkiva, letra dashurie me qëllim shantazhi, fatura, dëshmi të burgosurish, novelë, mbishkrime varresh, telegramë, piktura, poema, harta hajdutësh etj., etj.

E gjithë kjo nuk është aspak një kronikë e kalluar. Dy vjet më parë shtypi dhe televizioni botëror nxitën fantazinë e përgjithshme me lajmin e gjetjes së ditarëve të Hitlerit. Miliona spektatorë panë në ekran fletoret e lidhura me kujdes. Revista «Shtern» kishte paguar një shpërblim prej dy milionë markash. Pastaj, si zakonisht në rastet e falsifikimit, erdhi zhgënjimi, gjyqet, dënimë.

Asgjë e ngjashme nuk ka ndodhur me tragjeditë e zhdukura të Eskilit. Pa dyshim, që në shekullin XX ishte vonë për një gjë të tillë, por në shekullin X, atëherë kur interesi për letërsinë antike qe rizgjuar, ishte tamam koha. Në Evropë njëri pas tjetrit po hapeshin universitetet, krijoheshin katedrat, mendjet e ndritura kërkonin të depërtiston në terrin e së shkuarës.

Në qoftë se falsifikatorët nuk iu drejtuan Papës Urbani II Të Lumnueshmit më 1095, ngaqë në atë

kohë ai qe tepër i zënë me përgatitjen e kryqëzatës së parë dhe me luftën kundër antipapës Klementi III, asgjë nuk i pengonte t'i drejtosheshin polemitit Pier Abelardit të shkollës episkopale të Parisit, aty rrëth vitit 1140. Dhe në qoftë se ky i fundit s'e kishte fort mendjen për një gjë të tillë për arsyen të shqetësimeve që i kishte shkaktuar një pasion dashurie, i cili ishte bërë shkak për tredhjen e tij, falsifikatorët mund të kapërcenin detin e të paraqiteshin në Universitetin e Kembrixhit, i cili, ndonëse më i ri se ai i Oksfordit, rivalizonte me të duke ia tërhequr studentët. Ata mund të trokisnin te portat e universiteteve të Italisë dhe, në qoftë se do t'i gjykonin jo fort hijerëndë dijetarët e tyre, mund të shtegtonin gjer në universitetin e Vjenës më 1365 ose në Këln më 1388. Për një shpërbirim të mirë ata mund të udhëtonin gjer në Suedinë e ftohtë, për t'iu paraqitur arkipeskpit Jakob Ulfsson, që më 1477 porsa e kishte themeluar Universitetin e Upsalës.

Mirëpo ata nuk trokitën në asnje nga këto qendra të dijes. Më 1600 kishte ende kohë për një gjë të tillë dhe më 1700, në prag të klasizmit evropian, aq më tepër. Por as atëherë ata nuk u dukën.

Përgjigjja për këtë është e thjeshtë: askush nuk paguante mirë për tekstet antike.

Me siguri shumë herë falsifikatorët e kanë shqyrtau me hollësi këtë punë, kanë peshuar përfitimet dhe rrezikimet prej saj, kanë bërë zhbirimet e nevojshme me mënyrat që i kanë ditur vetëm ata dhe, së fundi, kanë ardhur në përfundimin se për poetët s'paguan kush.

Eskili, ky humbës i madh

Dhe kanë vrapuar prapë të sajognë letërköm-bimin e paqenë erotik të murgeshave të Manastirit X, veprën postume të një akademiku, kujtimet e një lordi, apo të një prostitute, që rrezikonin shpër-thimin e një skandali.

Për të gjitha këto paguhej mirë. Paguhej për akademikun e mërzitshëm, për prostitutën Margo. Për Eskilin kurrsesi.

E gjithë kjo është e mjaftë për të kuptuar se sa pa pasion dhe pa seriozitet është bërë kërkimi i dramave të humbura. Dhe ne s'na mbetet veç të falënderojmë fatin që shpëtuan shtatë prej tyre. Madje, nganjëherë duhet edhe të çuditemi për to, ashtu si çuditesh kur takon njeriun e shpëtuar përmrekulli nga një masakër.

10

Nuk është fort e qartë se nga ç'kriter është nisur shpëtuesi i këtyre dramave, ai që hartoï përbledhjen e zgjedhur. Përbledhja fillon me «Prometeun e mbërthyer», ndoshta e konsideruar prej hartuesve si vepër e ndërtuar thjesht, pra, lehtësisht e kuptueshme për të hyrë në botën eskiliane. Megjithatë, fakti që pas «Persëve», «Të shtatëve kundër Tebës» e sidomos pas trilogjisë komplekse «Orestia», përbledhja mbyllte me një dramë tjetër të thjeshtë për t'u kuptuar, si «Lutëset», e vë në dyshim kriterin e mësipërm. Më e besueshme do të ishte që hartuesi e vuri në krye «Prometeun e mbërthyer», si vepër tipike eskiliane, një dramë kushtuar rebeluesit që u dënuia prej Zeusit «për krimin e njeridashjes». Në qoftë se arsyjeja ka qenë kjo, ajo shpjegon njëkohësisht edhe shkakun përse hartuesi nuk e përfshiu të plotë në përbledhjen e tij trilogjinë prometejane. Por kësaj do t'i rikthehem i më poshtë.

Eskili, ky humbës i madh

Nga të shtatë dramat «Lutëset» është më e thjeshta si ndërtim, gjë që tregon se duhet të ketë qenë ndër veprat e hershme të tragjedianit. Me kalimin e viteve brumi tragjik sa vinte ndërlikohej në duart e mjeshtrit të madh, i cili gjatë procesit të ngjizjes së veprës së tij kërkonte, gjente e shpikte struktura të reja, që ashtu, të freskëta e novatore siç ishin, shndërroheshin aty për aty në ligje të mëdha të krijimit dramatik botëror.

Megjithatë, edhe në vepra të thjeshta në ndërtim, si «Lutëset», Eskili shtronnte probleme madhore, me të cilat qe ndeshur gjatë mijëvjeçarëve raca njërezore. Refuzimi i pesëdhjetë vajzave të Danait përmartuar me kushérinjtë e tyre të afert, është një dëshmi e atij procesi të gjatë qindrashekullor kundër martesave brenda fisit, endogamisë, proces që duhet të ketë qenë një histori e pafundme, vazhdim i historisë akoma më të pafundme të shkëputjes së njerëzimit prej poligamisë. Legjenda e mëvonshme e përhapur te të gjithë popujt e Ballkanit, e ngritisë së vëllait nga varri për të sjellë motrën e martuar larg, është një jehonë e këtij shqetësimi, që për epoka të tëra duhet të ketë trazuar e vënë në ankth mendjen e njeriut, që nga popujt që jetonin pranë akullnajave e gjer në viset e nxehta: «Vidh systur thinni gaztu slikan mog» (Me motrën tënde bëre ti një djale), thotë në formë akuze një nga personazhet e një Edde të vjetër norvegjeze.

Polemika nënë-bir, me të cilën nis balada ballkanase, një ndër më të bukurat e letërsisë orale botërore, triumfi i përkohshëm i mendimit të vëllait për ta martuar motrën larg (pra, triumfi i përkoh-

Eskili, ky humbës i madh.

shëm i idesë kundër flligështisë në gjak), pendimi i mëvonshëm i nënës, mallkimi i saj dhe ngritja e vëllait nga varri për të korrigjuar atë që ishte bërë, dëshmon në një mënyrë të shkëlqyer se nëpër ç'zigue, dilema e trauma ka kaluar njerëzimi për të mbërritur tek ajo që na duket sot e vetmja zgjidhje normale, qoftë nga ana shoqërore, qoftë nga ajo gjenetike; martesa jashtë fisit.

Balada e përbashkët e popujve ballkanas, me gjithëse e krijuar më vonë, pra, megjithëse kujtim më i largët i dramës së shkëputjes nga endogamia, është shumë më tronditëse se «Lutëset» e Eskilit. Kjo tregon se njerëzit që jetonin në trojet e ndryshme të gadishullit të madh e ruajtën dhuntinë që të krijonin struktura artistike të mahnitshme edhe në kohët e mëvonshme, por, si ato lulet e egra që nuk i shfrytëzon kush, ato mbeten jashtë letërsisë së kultivuar. Dhe arsyaja për këtë ishte sa kapitale, aq dhe e thjeshtë: këta popuj s'patën shkrimitarë. Pa shkrimitarë mbeti edhe vetë populli grek, i cili, pasi kishte njohur dritën e artit e të letrave, u zhyt dalëngadalë në mjegullën e padiges, në fatin e përbashkët të të gjithë ballkanasve për të murmuritur bashkë me ta legjendat e baladat makabre madhështore që, ndonëse po aq të fuqishme sa ato antiket, nuk i shërbyen letërsisë së kultivuar.

Dhe e gjithë kjo ndodhi për shkak të asaj lëvizjeje të papritur ogurzezë e absurde të rrotës së historisë, e cila bëri që popujt e gadishullit të artit të humbnin njëri pas tjetrit atë, pa të cilën s'mund të kishte as art, as letra dhe as mendim: lirinë e tyre.

Eskili, ky humbës i madh

Robëri ka njojur shumë rruzulli tokësor, por robëri si ajo nën të cilën ranë ballkanasit ishte vështirë të përfytyrohej. Kjo ishte një rrokullimë si ajo e titanëve në skëterrë. Një natë që vazhdoi qindra vjet, e brenda së cilës gjenerata të tëra njerëzish lindnin e vdisnin të verbëta. Si për një drejt-peshim ogurzi të gjérave, por me kahe të kundërtat me logjikën e zhvillimit, gjithë ajo dritë antike u mbulua nga terri i pushtuesve që nuk kishin she-mbull për nga errësira, injoranca dhe prapambetja. Trauma psikike e ballkanasve duhej të ishte kolasale. Popujt, që e përfytyronin jetën e tyre si tri-dimensionale: me zonën e vdekjes, me jetën reale dhe me zonën hyjnore, u gjymtuan papritur, duke u privuar prej gjithçkaje të lartë e shpirtërore. Kjo ishte njëloj si të humbnin qiellin.

Nata aziatike e përgjonte prej kohësh qytetërimin grek dhe atë ballkanas. Ajo iu sul dy herë gashullit: në kohën e Eskilit, në ftyrën e «persëve flokëgjatë» dhe, dymijë vjet më vonë, në ftyrën e turqve osmanlinj. Herën e parë sulmi aziatik dështoi, të dytën mbaroi me triumf. Bota greke dhe ajo ballkanase ishin si shtëpitë që ende nuk e njihnin gjëmën. Kishin njojur robëri të vogla, të përkohshme, kishin njojur fatkeqësi kalimtare, por s'e dinin ende ç'do të thoshte zi e vërtetë.

Zinë e kishin përpara. Eskili ishte ndoshta nga të parët që e pikasi atë te «Persët».

11

«Po kjo nuk është veçse një lojë, arhond.

— Një lojë, por shumë shpejt do ta shohim se ç'ndikim do të ketë te qytetarët».

Këto janë pak a shumë replikat që, sipas Plutarkut, u këmbyen midis Thespisit, krijuesit legjendar të tragjedisë dhe Solonit, kur ky i fundit u largua i zemëruar nga teatri.

Gjithmonë sipas Plutarkut, ishte një dramë me subjekt të lashtë ajo që shkaktoi acarimin e burrit të shtetit.

Vite më vonë ndodhën skandale me dramën me subjekt bashkëkohor «Marrja e Miletit», të cilën Herodoti e përshkruan kështu: «Spektatorët u mbytën në lotë, poeti (dramaturgu) u dënuau me një gjobë prej 1000 drahmi, ngaqë u kujtoi fatkeqësinë e përbashkët dhe u shpall ndalimi i shfaqjes së dramës në të ardhmen.»

Kemi dy fakte që duken se janë në kundërshtim me njëri-tjetrin: në rastin e parë, një dra-

Eskili, ky humbës i madh

më me subjekt antik zgjon zemërimin e shtetit, në të dytin, këtë zemërim, madje më të rreptë, e shkakton një dramë me subjekt bashkëkohor. Vetveti del pyetja: ç'parapëlqehej prej shtetit grek: trajtimi i subjekteve të lashta, historiko-mitike apo i atyre bashkëkohore?

Vetë fakti që historia jep dy shembuj kundërthënës dëshmon se zgjedhja nuk ka qenë e lehtë dhe pa zigzage. Me sa duket, midis zyrtarëve grekë pér një kohë të gjatë do të ketë pasur mendime të ndryshme pér këtë. Secila palë do të ketë sjellë arsyet e saj, gjithmonë në emër të interesave të shtetit e asnjëherë të artit, balanca e fitores do të jetë lëkundur herë nga njëra anë e herë nga tjetra, pas çdo skandali, pala kundërshtare do të ketë marrë revansh e kështu me radhë, gjersa më në fund ihtarët e temës mitike kanë fituar kundër asaj bashkëkohore. Me sa duket, prej dy të këqijave është zgjedhur «e keqja më e vogël».

Përdorimi i shprehjeve «midis dy të këqijave», «e keqja më e vogël» etj., mund të na duket pakëz i papritur pér një gjë që bota antike e quante sublime — teatrin. Por s'duhet të harrojmë se jemi gjithmonë në botën e gjykimit zyrtar të dramës. Mëdje jemi brenda lobit prodragedian, të atij lobi, pra, që, pavarësisht nga kundërthëniet e brendshme, është gjithmonë pér shpëtimin e teatrit në luftë me lobin tjetër, atë të tmerrshmin, të zymtin. që kërkonte humbjen e tij.

S'duhet të harrojmë gjithashtu se, pavarësisht nga organizimi madhështor i konkurseve dramatike, asnjëherë shteti grek nuk e kishte harruar rre-

Eskili, ky humbës i madh

zikun që mund t'i vinte nga teatri. Madje, sa më të madhërishme e luksoze bëheshin ceremonitë, sa më tepër ishin gjeniale dramat që luheshin në ske-në, aq më vigjilues bëhej edhe syri i shtetit. Ai sy nuk harronte kurrë se pas vargjeve me bukuri be-fasuese, pas kumbimit magjepsës të zërit të aktorë-ve, pas veshjeve e maskave mahnitëse mund të ishte gjithmonë «e keqja». Ishte e natyrshme që prej asaj «të keqeje», në mos arrinte ta zhdukte krejt, ai do të zgjidhje «më të voglën».

Që e keqja më e vogël u quajt më në fund tema mitiko-historike, e vërteton fare mirë fakti që pjesa dërrmuese, pér të mos thënë pothuajse krejt tragjeditë antike, u ngjizën me të. «Persët» bë-ri përjashtim. Ajo është e vetmja tragjedi me sub-jekt bashkëkohor dhe, pavarësisht se ne nuk e dimë se sa drama të tjera të tillë mund të ketë pasur an-sambli eskilian, prapëseprapë merret me mend se ato (në qoftë se kanë ekzistuar) duhet të kenë qenë shumë të pakta.

Duke lexuar me kujdes «Persët», s'është e vë-shtirë të ndihet përpjekja e Eskilit që drama të ishte e pranueshme pér autoritetet. Kompromisi duket që larg. Duke qenë bashkëkohore, drama i ka të gjitha përmasat mitike-legjendare: hapësira ku ndodh veprimi, kryeqyteti perandorak i persëve, është gati në botën tjetër; po ashtu personazhet, hijet e tyre janë si të mbikësojetshme. Në dramë nuk ndihet aspak Greqia, ajo Greqi që përpara kastrofës që po i kërcënohej duhej të kishte vluar si askurrë nga pasionet, heroizmi, parandjenjat, ank-thet, ekstaza, fatalizmi etj., etj., materie kjo e mre-

Eskili, ky humbës i madh

kullueshme për një krijues si Eskili. Mirëpo ai ishte i detyruar të braktiste truallin ku ndodhi ngjarja, në të cilën kishte qenë dhe vetë personazh, për ta çuar veprimin e tragjedisë në një largësi mitike, prej nga ngjarja pasionante, plot bujë e gjak, gjy-kohet shurdhërisht, ashtu siç mund të jetë një gjykim hijesh.

Nuk është ndonjë teprim të hamendësohet se Eskili do të ketë bërë me siguri mjaft përpjekje që drama të lejohej nga autoritetet.

«Ç’të keqe ka një dramë e tillë?

«Si nuk ka të keqe? Pak telashe na hapi drama e Frinikut, që u detyruam ta ndalonim? Ishte i njëjtë subjekt, apo jo?

«Megjithatë, kjo është tjetër gjë... dhe gjërat duhen gjykuar në mënyrë të pavarur. I duhet Greqisë kjo dramë.»

«Më vjen keq të ta kujtoj, por për Greqinë ka kush mendon».»

Ndoshta fjalët e fundit nuk janë shqiptuar në këtë dialog, që nuk e jep as Plutarku, as Herodoti, por nëntekstin e tyre Eskili duhet ta ketë kapur në sytë e ftohtë të zyrtarit.

Tragjediani krenar duhej të ishte fyter, ashtu siç dinte të fyhej ai (një fyterje a nuk u bë shkak të braktiste Athinën vite më vonë?), pra, tragjediani duhej të ishte fyter, të thoshte: në djall të veni të gjithë, bashkë me teatrin, kam faj unë që merrem me ju, etj., etj. Dhe të dilte duke përplasur derën.

Por ai nuk e bëri atë. Dhe nuk qe as etja përfamë, as frika, as honorari që do të humbte, që e

Eskili, ky humbës i madh

frenoi. Ishte tjetër gjë, dhe pikërisht ajo psikologji sovranë, për të cilën folëm pak më parë.

Si çdo shkrimtar i madh Eskili ishte i ndërgjegjshëm se, në krahasim me atë zyrtar të mesëm apo të lartë që përfaqësonte shtetin, ai ishte një princ, dhe jo vetëm i artit, por i gjithë kombit të vet. Si i tillë, ai qëndronte më lart se çdo burrë shteti dhe se fati i Greqisë i rëndonte atij mbi supe më shumë se ç'i rëndonte ndoshta krejt mekanizmit të shtetit grek.

Ndaj e gëlltiti kështu fyerjen dhe, pasi i bëri retushet e fundit pjesës (shkurtimi i ndonjë dialogu të bezdisëshëm për autoritetet, zëvendësimi i disa maskave etj.), e nxori shfaqjen përpara publikut, për hir të Greqisë, të të gjithë Gadishullit Ballkanik, të të gjithë botës. Sepse «Persët» ishte jo vetëm vepra më patriotike e Eskilit, një monument për luftën e popullit grek kundër pushtuesit pers, por ajo ishte njëkohësisht një monument botëror, me vlerë universale për luftën e gjithë popujve të vegjël kundër shteteve agresore gjigante e supershtetëve, ashtu siç qe perandoria e patundme persiane në krahasim me Greqinë e vogël.

Ashtu siç ndodh shpesh me autorët antikë, që e kanë të vërvetishme aftësinë e universalizmit të dukurive, koncepti i «së drejtës» eskiliane në këtë tragjedi fiton përmasa shtetërore, madje të marrëdhënieve e ndeshjeve ndërkombëtare. Nga rreshti i parë i dramës dhe gjer tek i fundit është e qartë përtë gjithë se me cilën anë është e drejta dhe me cilën jo.

Një ide tjetër e fuqishme, gjithashu e rritur

KN

Eskili, ky humbës i madh

në përmasa nga aktet njerëzore tek aktet midis shteteve dhe popujve, është ideja se e keqja, krimi, rrjedhimisht, sulmi i një shteti kundër një tjetri do të marrin një ditë ndëshkimin fatal, ashtu siç e morën persët. Nga kjo pikëpamje, «Persët» është vepra pararendëse e gjithë atyre dramave, poemave, romaneve, këngëve e marsheve të mbarë njerëzimit që himnizuan me të drejtë sulmin dhe fitoren e më të voglit, që kishte të drejtën, kundër më të madhit, që s'e kishte atë.

Bashkë me këtë motiv Eskili në tragjedinë e tij nuk harron, por përkundrazi e nënvizon me forcë se, përveç të tjerash, Greqia po sulmohej nga një shtet diktatorial tiranik, i prapambetur nga çdo pikëpamje, i cili, duke e pushtuar Greqinë, do të fikte përgjithmonë atë drithë dhe demokraci që kishte lindur kultura dhe qytetërimi grek. Tragjiku i madh duket sikur parashikoi këtu dramën e përbashkët që do t'u ndodhët dy mijë vjet më vonë popujve të Ballkanit, kur muzgu osman do të ndehej mbi ta. Por duhet thënë se në luftën kundër asaj nate që zgjati me shekuj, tragedia «Persët», ky kandil i largët, por i pashuar, bashkë me gjithë duhet e tjera artistike të ballkanasve ka luajtur pa dyshim rolin e vet.

Këto ide madhore të Eskilit nuk ishin përsiatje të lindura e të shtjelluara në vetminë e dhomës së shkrimittarit. Ato ishin pjellë e kohës, vinin drejt e nga zallahia, nga pasionet shkumbëzuese të saj. Në kohën kur shfaqej «Persët», perandoria persiane ishte vërtet e mundur në dy beteja, por ajo ende ndodhej në këmbë dhe frika e një revanshi të saj

Eskili, ky humbës i madh

varej si re kërcënuese mbi Greqinë. Me dramën e tij Eskili nga një anë ua kujtonte grekëve këtë, nga ana tjetër u ngjalltë besim për fitore në një ndeshje të ardhshme me perandorinë e pluhurosur, por ende të frikshme.

I kishte shkuar vallë ndër mend (në ato shpërthime verbuese kur mendja e shkrimtarit sulet atje ku nuk guxon të afrohet logjika), i kishte shkuar, pra, vallë ndër mend se tragjedia e tij do të luhej ndonjë ditë në skenën e kryeqytetit persian dhe në gjuhën persiane?

Në kohën tonë, dëshira për t'u përkthyer në gjuhë të tjera është gjëja më e zakonshme për një shkrimtar, madje edhe për më mediokrin. Por në atë kohë, ta mendoje pjesën tënde në skenën persiane ose skithe, ishte njëlloj sikur dramaturgi i shek. XX ta mendonte pjesën e tij të luhej në skenën e një trupi qiellor diku në Galaktikë.

Megjithatë, në përgjigje të pyetjes së mësipërme, të thuash «po» është po aq vështirë si të thuash «jo.» Sepse, mund të thotë dikush, në qoftë se Eskilit nuk i ka shkuar ndër mend një gjë e tillë, si shpjegohet atëherë ajo mungesë e admirueshme shovinizmi?

Në të vërtetë, duke e parë dramën me sytë e persëve, vetveti Eskili ka dhënë jo vetëm ankthet e parandjenjat e liga të një perandorie në prag të katastrofës, por edhe tragjedinë e një populli, mbi shpinën e të cilit bie gjithë barra e një fushate të çmendur pushtuese.

Por këtu, më tepër se për një pandehmë, qoftë dhe surrealistë të autorit për shfaqjen ose mosshfaq-

jen e dramës së tij në Persi (mendoj se ende sot, në kushtet e konfliktit Irak-Iran, ajo është po aq e pădëshirueshme në skenën persiane, sa ç'do të ishte absurdë në skenën irakiane, në qoftë se Iraku mendjelehtësisht do të kishte vanitetin ta përfytyronte veten në rolin e Greqisë antike), pra, më tepër se për një hamendësi për njohjen përtej kufijve, këtu ka qenë fjala për intuitën e gjeniut, që, duke kapërcyer çdo mendësi të kohës (Greqia, sipas kësaj mëndësie, ishte qendra e botës dhe përtej kufijve të saj niste muzgu dhe barbaria, kështu që përkthimi i një drame në një gjuhë tjeter ishte një gjë që s'mund t'i shkonte ndër mend veçse një të çmenduri etj., etj.), pra, duke kapërcyer të gjitha këto, ai e ndjeu se shkruante, megjithatë, për gjithë popujt e botës, qofshin ata ende në stadin e barbarisë e në terr e trishtim.

Kur flitet për «Persët», krahas ideve e motiveve që ruajnë vlerën e tyre universale gjer në ditët tona, përmenden nganjëherë si një gjë e kapërcyer klima e fatalitetit dhe e bestytnive të kohës. Kështu, p.sh., sipas Eskilit dhe, me sa duket, sipas bashkëkohësve të tij, ishte e pranueshme nga hyjnité që popujt dhe perandoritë aziatike të shembnin e të rrroposnin njëri-tjetrin në tokën kontinentale. Rrëmuja shkatërrimitare në tokën aziatike ishte e lejueshme për ta, kurse në det jo. Deti dhe dalja në det, aq më tepër kapërcimi i tij, ishin të pafalshme, ndaj fatalisht të dënueshme. Perandoria **tokësore** e persëve humbi, sepse shkeli këtë ndalim të hyjnive: doli në det dhe u përbys pikërisht atje. Ndër detajet e përshkrimit të betejës së Salaminës, për të

Eskili, ky humbës i madh

nënvízuar idenë se «Barbarëve nuk u shkon deti», Eskili shkruan se sa qesharakë ngjanin ata me rrobat e marinarëve që fryheshin e pluskonin sipër dallgëve plot kufoma të Egjeut.

Është pa dyshim një bestytni, por ndryshe nga bestytnitë e mirëfillta popullore, kjo është një bestytni zyrtare ose, më saktë, një lloj platforme politike veshur me rrobën e bestytnisë. Kujt i shkon deti dhe kujt i shkon shkretëtira, kush është lindur për malet e kush për lumenjtë, me sa duket, këtu ka filluar ai pazar tragjik që u njoh në shekullin XX me formulimin «ndarje e sferave të influencës» dhe që në mënyrë misterioze kaloi nga kanceleritë asire e egjiptiane tek ato greke, nga grekët te romakët, nga romakët te Bizanti, për të mbërritur gjer në Londrën, Parisin, Uashingtonin e Moskën e ditëve tona.

Për «Persët» kishin nevojë persët, po aq e ndoshta më tepër sesa vetë grekët. Tragjedia ishte e tyrja, dhe në festimet e 2500-vjetorit të monarkisë, në atë «dasmë që shkrepëtinte nga zia», po të përdornim një varg të Fan Nolit, kur spikeret e TV të të gjithë botës, duke komentuar paradën madhëشتore të trupave perandorake në mënyrën më mendjelehtë përmendin Eskilin, askush nuk u kujtua të thoshte se Eskili kishte paralajmëruar tjetër gjë, se komenti i tij për atë ushtri-fantazmë kishte qenë më i saktë se i të gjitha stacioneve televizive evropiane dhe, së fundi, se një shfaqje e «Persëve» do të ishte shumë më e dobishme për Iranin se gjithë ajo ceremoni barbare.

Drama e persëve ka mesazhe të tjera po aq të

Eskili, ky kumbës i madh

rëndësishme për grekët e për gjithë ballkanasit. Një prej tyre është thirrja për unitet në luftën kundër barbarisë. Duket se problemi i unitetit ka qenë një sëmundje kronike e Greqisë së lashtë. Le të kujtojmë se vargjet e para të Iliadës fillojnë me një grindje përcarëse. Mirëkuptimi midis qyteteve-shtete, veçanërisht midis Athinës e Argosit, e përgjithësisht mirëkuptimi midis grekëve do të ishte një shqetësim i përhershëm i tragedianit. Ai ndihet te «Persët», tek «Orestia», por sidomos ai ndihet fuqishëm te pëishkrimi i dramës që ndodhi përpara portave të Tebës.

«Tebaida» duhej të ishte një nga eposet e shumta që gjëllonin në atë kohë në kozmosin artistik grek dhe prej të cilave krijoeshin herë pas here vepra gjeniale. E gjithë ajo përshkënditje shpirtërore e artistike që ndodhët në atë kohë në Greqi, ngjasonte vërtet me një zonë të dendur të kozmosit. Cëpëra poemash arkaike të thërrmuara nga koha vërtiteshin rreth e rrotull, motive të vjetra shpërthenin befas me drithë verbuese si yj të rini, të tjera motive plakeshin e ftoheshin, ndërkohë që të tjera përplaseshin ose bashkoheshin vrullshëm me njëri-tjetrin... dhe gjithçka është në një trazim dhe rropamë të pafund, dhe vrimat e zeza ishin aty, përbri, duke pritur rastin për të thithur e shkretuar gjithcka.

Nuk ishte e lehtë aë të orientoheshë në këtë galaktikë të larmishme, sic që mitologjia dhe poezia arkaike orale greke, në këtë zonë të dendur, ku fërkoheshin, goditeshin, dëmtoheshin, bvmeheshin ose gllabëroheshin prej njëri-tjetrit motërzimet e

shumta të kënduara ndryshe nga rapsodë të ndryshëm. E aq më pak ishte e mundur të disiplinoje atë hazdisje e atë tërbim artistik për t'ia nënshtruar logjikës dhe vijueshmërisë që kërkonte drama. Duheshin mendje e vullneta gjenish, ashtu siç ishin në të vërtetë ato të tragjikëve grekë. Pa ndërhyrjen e tyre, kjo mitologji e këto epe në procesin e larmimit, të tkurrjes e të bymimit të vazhdueshëm, do të përfundonin dalëngadalë në një masë të copëzuar të përbërë prej motërzimesh të pafundme. Këtë gjë e pësoi gjer në njëfarë shkalle ansambli i eposit shqiptar, i cili, duke mos pasur fatin të shkruhej në kohën e duhur, mbërriti gjer në shekullin XX i dëmtuar rëndë e disa herë në mënyrë të pariparueshme.

Vetë mekanizmi i anënimatit që prodhonte poemat arkaike, ai korpus i pafud rapsodësh, çdonjëri prej të cilëve përpiquej t'i shtonte ose t'i hiqte diçka poemës që këndonte, kushtëzoi dendësinë e motërzimeve të shumta, të cilat bashkë me larminë kishin brenda tyre farën e shkatërrimit. Larmia e poezisë orale ishte edhe pasuri por edhe varféri, edhe jetë, edhe vdekje. Ndërhyrja tiranike e Homeirit dhe e tragjikëve e shpëtoi poezinë orale nga anarkia dehëse. Pa atë ndërhyrje ajo do të vdiste e mbytur pikërisht nga larmia.

Larmia kaloi, megjithatë, në letërsinë e kultivuar. Edhe pse shumica e tragjedive antike kanë humbur, në pakicën e mbetur ka përkime të shumta midis Eskilit, Sofokliut e Euripidit. Për Orestin, birin e Agamemnonit, ka tri drama dhe, siç thotë anglezi H. C. Baldry, kjo është njëlloj sikur të ki-

Eskili, ky humbës i madh

Me këtë lidhet ideja madhore e Eskilit se hyjnité, ato për të cilat betohen bashkëkohësit e tij, duke përfshirë edhe Zeusin vetë, kanë kaluar gjithashtu nëpër një rrugë të gjatë riedukimi gjersa janë qytetëruar e zbutur.

Po, a qenë zbutur vërtet sunduesit e botës në kohën e Eskilit e qoftë më pas? Dhe, a ndihmuani sadopak në zbutjen e tyre tragjeditë greke, duke përfshirë edhe ato të Eskilit, ku disa personazhe, kryesisht hyjnore, janë paraqitur sipas parimit aristotelian, jo si janë, por siç duhej të ishin?

Përvoja e njerëzimit ka treguar se asnje ndihmë nuk dhanë këto tragjadi në gjoja zbutjen dhe qytetërimin e sunduesve. Përkundrazi, me kalimin e shekujve bota njoihu sundimtarë përherë e më të egër, në oborret e pallatet e të cilëve ndodhën krimë e luftëra për pushtet shumë më të llahtarshme se ato të Atridëve apo të Edipit mbret.

Po atëherë, a mund të themi se gjithë ky art gjenial, gjithë mesazhet dhe paralajmërimet e tij kanë shkuar dëm? Kurrsesi s'mund ta thotë kurrush këtë.

Në qoftë se Eskili u kujton të gjithëve se hyjnité e sunduesit vërtet kanë qenë të pagdhendur e brutalë dikur, por tanjani janë qytetëruar, kjo është një shpallje, një normë, një fytyrë që ai u propozon sundimtarëve të botës. Do ta pranojnë apo s'do ta pranojnë ata këtë fytyrë të re, këtë maskë, është punë e tyre, por vetë propozimi është ndërkaq një akt që vepron. Në qoftë se hyjnité nuk e duan fyttyrën që u propozohet, por vazhdojnë të egërsohen edhe më, atëherë aq më keq për ta. Thirrja që u

Eskili, ky humbës i madh

është bërë: «Qytetërohuni!», s'ka shkuar aspak dëm. Ajo ua kujton të gjithëve se ata nuk janë aspak ata që duhej të ishin, prandaj kjo thirrje kthehet në burim revolte të përjetshme kundër tyre.

Asnjë zbutje s'pësuan tiranët pas Eskilit, prandaj njerëzimi e modifikoi dalëngadalë figurën e Prometeut. Por kjo s'duhet të na bëjë të harrojmë aspak se ishte tragjiku i madh, që e hodhi i pari sfidën dhe krijoi atë, pa të cilin bota do të ishte më e flashkët dhe më e zbehtë, prometeizmin.

13

Në sfond të skenës pallati i Atridës. Ky është shënim i që hap «Orestian», veprën monumentale, të vetmen që ka mbërritur e plotë gjer te ne nga rroposja eskiliane. Shënim mund të jetë i autorit apo i ndonjë vënësi në skenë të mëvonshëm, kjo s'ka rëndësi. Përpara nesh është pallati me tri porta, në çdonjérën prej të cilave do të zhvillohen ngjarje nga më tragjiket që mund të përfytyrojë mendja njerëzore. Nëpër njérën portë do të hyjë duke shkelur mbi qilimin e purpurt mbreti Agamemnon, për të mos dalë më kurrë që andej, në të njëjtën ose në tjetrën do të dalë mbretëresha Klitemnestra me sëpatën e përgjakur, duke u përpjekur të përligjë krimin që porsa ka kryer. Nëpër njérën nga ato porta do të hyjë më pas biri i tyre, Oresti, për të dalë dhe ai, këtë herë me shpatën mëmëvrasëse në njérën dorë dhe në tjetrën me pël-hurën-rrjetë me njolla gjaku të thara, me ndihmën e së cilës nëna e tij ka prerë të atin. Dhe, ashtu si

Eskili, ky humbës i madh

edhe të tjerët, edhe ai do të përligjë përpara botës vrasjen e tij, por ndërkaq do të mbërrijnë erinitë për t'ia errësuar gjykimin e për ta kthyer të foluren e tij në një dëlir.

KM

Por të gjithë këta s'janë veçse «bij e nipër krimesh të vjetra», që prej vitesh kanë gëluar brenda këtij pallati. Muret e tij kanë parë e dëgjuar gjëra të llahtarshme, prej të cilave ne shikojmë vetëm aktet e fundit. Vrasje midis vëllezërish për pushtet, goсти makabre, ku mysafirit i serviren si gjellë gjymtyrët e fëmijëve të vet, net delirante të ndërgjegjeve të vrara, mallkime, ankthe dhe parandjenja krimesh të ardhme. Të gjithà këto i mësojmë dalëngadalë nga kori, përpara të cilit shpalosen rruazat e fundit të këtij zinxhiri të rëndë. Siç dihet, motivin e kësaj gjëme Eskili e ka nxjerrë nga epët e vjetra orale, ku flitet për mallkimin që rëndonte mbi pallatin e Pelopidëve (ose Atridëve), ku gjakmarrja fisnore e gërshtuar me luftën për pushtet vazhdonte të pillte vrasje pas vrasjesh. Ideja e Eskilit se krimi lind krimin është e nënvizuar në këtë vepër më qartë se kudo. Po trilogjia është e mbushur me motive të tjera të mëdha për luftën dhe për paqen, për fatkeqësinë që pëson jo vetëm viktima e mundur, por edhe agresori fitimtar, për shpagimin e çdo abuzimi, për flijimin në emër të ambicies, për raportet individ-shtet, ndërgjegje-nën-ndërgjegje, detyre-pasion etj. Ide antitiranike e përshkojnë trilogjinë nga kreu në fund. Herë-herë lajmi i një vrasjeje në pallat lidhet me shqetësimin se mos po shpallet një tirani e re. Kështu, p.sh., në çastin kur merret vesh vrasja e Agamemnonit,

Orejta

Eskili, ky humbës i madh

për nga ritmika e të folurit dhe e trazimit të brendshëm, kori antik i ngjét një grumbulli gazetarësh të sotëm në portat e një ndërtese presidenciale, ku porsa ka ndodhur një grusht shteti.

Një nga motivet kryesore të veprës eshtë problemi i parësisë së gjakut atëror ose mëmësor. E thjeshtë në pamjen e parë, kjo ka qenë një nga çështjet themelore, mbi të cilat janë ngritur të gjitha kodet juridike të vjetra e të reja, çështje që ka shkaktuar drama të panumërtë anonime mbi rrullin tokësor.

Në «Orestia» pyetja shtrohet saktë dhe prerë: *në rrjedh fisi: nga nëna apo nga babai? Hyjnité e vjetra, erinité, janë pér nënën, të rinjtë Apoloni e Atena, pér atin.* Me të drejtë thotë Engelsi se kjo eshtë një jehonë e largët e luftës mijëvjeçare midis matriarkatit që po humbte dhe patriarkatit që po fitonte. Por motivi ishte, megjithatë, tepër i vjetër pér ta interesuar Eskilin, në qoftë se nuk do t'i shërbente si bërthamë pér ta pašruuar me ide më të reja universale, si ato që përmendëm më lart, e gjer te motive fare të freskëta të jetës së vrullshme bashkëkohore, si çështja e Aeropagut, gjyqit të athinasve, pér fuqizimin ose shfuqizimin e të cilit ata ishin në atë kohë në grindje, pér aleancën Athinë-Argos etj.

Problemi i «së drejtës», që e përshkon si lajm-motiv tërë krijimtarinë e Eskilit, këtu trajtohet gjerësisht e konkretisht prej tij, si një ndeshje e madhe midis së drejtës së vjetër, asaj të erinive e të vetëgjyësisë gjakmarrëse që po humbet. dhe një «të drejte» të re, asaj të mekanizmit shtetëror.

Eskili, ky humbës i madh

Por, si çdo vepër e madhe artistike, «Orestia» del nga çdo skemë e të gjykuarit brenda një kornize apo disa kornizave, sado të rëndësishme qofshin ato. Dramë e krimit dhe e gjakmarrjes, e anktheve dhe e luftës për pushtet, e ndeshjes dhe e rrëzimit të ligjeve, e ëndrrave të turbullta dhe e parandjenave, ajo ka të tilla përmasa që me një vrundull të saj anësor është e aftë të përfshijë, p.sh., tërë historinë e luftës së Trojës, madje në shtrirje kohore dhe hapësinore më të gjerë se ç'e gjejmë tek «Iliada» dhe tek «Odisea».

Veprimi i trilogjisë nis ditën e marrjes së Trojës, por shkallë-shkallë ne mësojmë gjithçka për këtë luftë, e cila nga të gjitha luftërat që janë zhvilluar gjer më sot në planetin tokësor, duke përfshirë këtu edhe dy luftërat botërore të shek. XX, është ajo që mban vendin e parë përsa i përket pjelljes së kryeveprave letrare. Kështu, mësojmë për atë natë fatale, kur nisi, sipas grekëve të vjetër, fatkeqësia e Trojës. Ndaj të gdhirë të asaj nate, Helena:

*Vendit të vet duke i lënë pas
Rropamë heshtash, shqytash e anijesh,
Që mbushen plot me armë, duke i sjellë
Në vend të pajës vdekjen Ilionit,
Me hap të lehtë ajo kapërceu pragun
Duke guxuar atë që nuk guxohet.*

Pas kësaj, në vargje të kursyera e me një bukuritë rrallë, njihemi me zinë që ra në pallatin prej nga iku mbretëresha, me mërzinë e të shoqit të brakti--

Eskili, ky humbës i madh

sur, Menelaut, me dhënien e kushtimit dhe mbledhjen e ushtrisë greke në Aulidë, ku Agamemnoni, kryekomandanti, do të flijojë vajzën e vet, me fillimin e fushatës, me zinë që ra anembanë Greqisë, ku ditë për ditë mbërrinin nga Troja lajme vdekjesh e arkëza me hi dhe, së fundi, me natën e rënies së Trojës, të masakrës së tmerrshme, ku grekët e «tejkaluan të drejtën e vet» dhe në shekuj do të mbanin në ndërgjegje peshën e saj.

Shkurt, një enciklopedi e tërë e luftës së parë botërore që njeh historia e njerëzimit, luftë ku undeshën dhjetëra shtete e popuj dhe që si asnje tjeter u ngul në kujtesën e botës. Vetëm në disa faqe, në disa ndërhyrje të shkurtra, rikujtime e paranteza, tragjiku i madh, në dramën që flet për tjeter gjë ka futur pothuajse të plotë fushatën kundër Trojës. Në secilën prej këtyre ndriçimeve të shkurtra si prej vetëtime, shpalosen pamje që zgjognë mendime të mëdha. Le të kujtojmë vetëm njérën prej tyre, flijimin e Ifigjenisë në Aulidë, portin ku që mbledhur flota greke duke pritur nisjen. Erërat e pengonin të nisej, morali i ushtrisë po binte, falltari Kalkant këshillon flijimin e vajzës, të cilin Agamemnoni, pas një lëkundjeje, e pranon.

Këtë dëshmi jep Eskili dhe tërë letërsia antike greke, por lexuesi i sotëm përpinqet të deshifrojë prapa mjegullës mitike një të vërtetë më të saktë. Ç'erëra e pengonin flotën greke, ç'qe në të vërtetë Kalkanti dhe, mbi të gjitha, për ç'arsye Agamemnoni e bëri flijimin?

Për disa nga pyetjet studiuesit janë përgjigjur, për disa jo. Kalkanti është, p.sh., një nga figurat

Eskili, ky humbës i madh

më misterioze në tërë veprat antike ku ai shfaqet. Dihet se kryefalltari i grekëve nuk ishte veçse një renegat trojan, i dërguar enkas prej Priamit për të çorientuar fushatën që po niste, por që, me sa duket, u bë vërtet me grekët ose, së paku, luajti një rol të dyfishtë gjatë gjithë luftës. Për të mirë apo për të keq ishte këshilla e tij? Për të tronditur e përçarë edhe më tepër grekët, që me shumë vësh-tirësi kishin arritur të mblidheshin më në fund në Aulidë (roli klasik i një intoksikatori), apo për ndonjë tjetër arsyë? Që flota greke nuk u nis për një kohë të gjatë kundër Trojës, kjo duhet të jetë një e vërtetë historike. Po nuk ishin erërat e hyjnive të pakënaqura, që i pengonin, por të tjera, dhe pikërisht disuniteti midis grekëve, përllogaritja e forcave, struktura e aleancave të të dy kampeve etj. Sipas të dhënave të disa autorëve antikë, në qoftë se lufta e Trojës vazhdoi dhjetë vjet, afërsisht po aq zgjati koha e mbledhjes së ushtrisë shumështetëshe greke. Këshilla e Kalkantit mund të ishte konform udhëzimeve të padronit të vet, Priamit, por edhe e kundërt me udhëzimet, në qoftë se ai qe bërë vërtet renegat. Por më e besueshme prej të dyjave është që asnjë këshillë të Kalkantit s'ka pasur dhe flijimi i Ifigjenisë është bërë me një llogari të ftohtë, nga ato që quhen «raison d'état»: Agamemnoni e flijoi vajzën e vet jo vetëm për arsyе karrierizmi, siç e akuzon me të drejtë e shoqja, por, në radhë të parë, për të pasur të drejtën që të kërkojë prej të gjithëve flijim dhe gjak në luftën që do të kthehej së shpejti në një kásaphanë. Sundimtarët jo rrallëherë e kanë bërë një gjë të tillë.

Eskili, ky humbës i madh

Pandehma dhe pyetja e fundit nëse ka pasur apo s'ka pasur në të vërtetë flijim të Ifigjenisë, pandehmë që e nxit vetë mitologjia greke, me mōterzimin sipas të cilët në çastin e fundit, në vend të vajzës, Artemisi vuri nën shpatën e xhelatit një sorkadhe, nuk e rrëzon, por e përforcon shpjegimin e mësipërm. Që të organizohej një spektakël i tillë, një flijim i rremë, kjo nënvizon pikërisht llogarinë e ftohtë të veprimit dhe pikësynimin praktik të tij.

Në një mënyrë të habitshme moderne tingëllon për lexuesin e sotëm përshkrimi i asaj që është quajtur mërzi e luftës e ushtarëve grekë në fushë-tirën dimërore përpara Trojës, brengë që ka platasur mbarë Greqinë, ku në çdo familje:

*Mbajnë mend fytyrat
E ushtarëve q'u nisën,
Por në vend të tyre
Vjen një arkëz me hi.*

Dhe më poshtë: rropama e pëshpërimës po-pullore kundër luftës, ku që nga larg «në vend të burrit, gruas i çojnë arkën e lehtë me zi të rëndë». Por ka edhe më keq:

*Të tjerëve u mbetën trupat
Ah, larg, nën mur të Trojës,
Ku toka e armikut
Urrejtshëm thellë i fsheh.*

Një klimë e tillë e një psikoze të përbashkët për një luftë që zhvillohet larg të kujton çuditë-

risht atë përjetim e atë brengë ndërkomëtare që krijuan në gjysmën e dytë të shekullit tonë lufta e Koresë, më pas ajo e Vietnamit e, së fundi, fushata e Afganistanit. Ne e kemi njojur ngjarjen e Trojës nëpërmjet Homerit, por falë Eskilit kemi ndier se më shumë se çdo kohë tjetër Troja i shkon te shekullit XX. Te «Persët» Eskili e ka parë Greqinë e tij nga larg, nga kampi i armikut, tek «Orestia» që nga Greqia ai e ka parë kështu Trojën, njëlloj sikur të ishte qytetar i saj.

Dhimbshëm, si të ishte shkruar nga pena e një trojani, dhe krejt i afërt për ne, si të flitej për rënien e Moskës ose të Parisit, tingëllon përshkrimi i natës fatale të rënies së Trojës, masakra barbare e grekëve, britmat e të mundurve e fitimtarëve, «që ashtu si fatet, klithmat të ndryshme i kanë», dhe me afrimin e mëngjesit, kur:

*Të tjerët, fitimtarë, të kapitur
Pas luftës dhe vërtitjeve të natës,
T'uritur grumbullohen për të gjetur
Andej-këndej të hanë pak mëngjes.*

Pas kësaj do të vijë kthimi i grekëve në atdhe, i grekëve që «shkuan përtëj së drejtës së tyre për hakmarrje» dhe që tanë do të jepin shpagim për plojën e bërë me netët e mundimshme të vrasjes së ndërgjegjes dhe me sëpatat e përgjakura, me të cilat, tashmë fitimtarë, do t'i sulen njëri-tjetrit. Ne do të jemi dëshmitarë të asaj ç'do do të ndodhë në njërin prej pallateve të udhëheqësve të tyre, dhe pikërisht të kryekomandantit të fushatës, Aga-

Eskili, ky humbës i madh

memnonit, pallatit me tri porta, çdonjëra prej të cilave do të shohë gjëma: njérën më të kobshme se tjetrën.

E tillë është «Orestia», një kurorë plot me gurë të çmuar, vetëm njëri prej të cilëve, ai i motivit të Trojës, ka vlerën e një miniiliade dhe aftësinë që me pérndritjen e tij të japë tërë zjarret dhe trajedinë e Trojës. Të tjerë gurë të çmuar e përbëjnë kurorën me ngjyrime nga më të habitshmet, por gjithmonë midis tyre spikat ai rubin i kuq i myllët që dërgon gjer te ne, nga largësia dymijëepesëqindvjeçare, reflekset e tij ngjethëse. Është motivi i gjakmarrjes dhe i gjyqësisë së gjakut, veçanërisht i njojur për njeriun shqiptar.

14

«**Neni 52** Udhën e katundit a udhën e madhe s'ka burrë qi mund t'ia ndalë kujt. Aty ku kalon nieri kalon edhe bagëtija, kalon i gjallë e kalohet me të dekunin. M'u ba rrenim n'udhë të madhe, zhyt e mbyt, aty do të kalojë shtegtari e bagëtija, nusja me krushq e përcjellsat me të dekunin.

Neni 57 Me mbytë grueja burrin e m'u çue i kunati me vra të kunatën, pse ia vrau të vllan, kjo s'asht e përligjme në Kanun. Gjaku i grues s'bahet baras me gjak të burrit, pra, tepricën e gjakut të burrit do t'a përligjin prindja e grues.

Neni 61 Grueja farë tagrit s'ka as mbi të bijt as në shpi. Me vra i biri t'amën bjen në gjak me prindt e s'amës.

Neni 243 Eshtent e vorrit e guri i kufinit faqe kanunit, jan baraz. Me luejt kufinin asht nji si me luejt me eshtnat e të dekunve.

Neni 598 Ndera e marrun nuk shpërblehet me oja, por a me të derdhun të gjakut, a me të falun fisnikisht.

Eskili, ky humbës i madh

Neni 599 I korrituni ka derën cilë pér kah ndera: peng s'shtron, pleq s'merr, gjyq s'lypë, gjobë s'merr. Burri i fort merr gjobën vetë.

Neni 600 Ai, të cilit iu muier ndera xehet i dekun ndaj Kanuja.

Neni 602 Shpija e Shqiptarit asht e Zotit e e mikut.

Neni 620 Po të hini miku në shpi, gjak me të pasë do t'i thuesh «mirë se erdhe!»

Neni 645 Atij qi iu pre miku çdo send do t'i jepet me dorë të majtë e pér nën gju mje qi ta paguej mikun.

Neni 649 Me gojë të Kanunit, baba, vllau e deri kushrinija e dalun faret falet, porse miku i premë nuk falet.

Neni 695 Vargu i brezave të gjakut e të gjinis, shkon në të pasosun pér shqiptart e maleve.

Neni 697 Katërqind zjarrmesh me u da Shqiptari, aj as merr as jep, d.m.th. nuk ban krushqi.

Neni 698 Brezat rrjedhin a prej gjakut a prej gjinis.

Neni 699 Brezat e gjaku t rrjedhin prej anët të babës, brezat e gjinisë prej anët të nanës.

Neni 700 Rrjedhja e brezave prej anët të babës thirret: «Lisi i gjakut».

Neni 701 Rrjedhja e brezave prej anët të nanës thirret «Lisi i tamblit».

Neni 887 Çmimi i jetës sënierit asht nji, si pér të mirin si edhe pér të keqin. Seicili mbahet i mirë e i thotë vedit «Jam burrë! e i thonë: «A je burrë?»

Neni 901 Kur të vrasin shoqi shoqin dy vetët,

qi u fjalosën e biejn tē dy dekun, jesin krye pér krye, ose gjak pér gjak.

Neni 903 Po tē mbet njani i vram e tjetri i shituem, atbotë i shituemi do t'ia kthejë tepricën e qmimit tē gjakut tē vramit.

Neni 917 Gjaku s'hupë kurr.

Neni 1005 Po ndodhi se duel mendsh një katund marrë me gjith Pleq e Vogjli, atbotë ngrehen krenet e Flamurit me Pleq e Stérpleq vllaznish e fisesh e me gjith Vogli edhe e biejn në mend katundin e dalun dore.

Neni 1200 Lajmtari. Lajmtari nuk ban faj, nuk xehet.

Neni 1234 Si tē desi kush do tē dërgohen lajmтарët pér me thirrë në mort.

Neni 1238 Kanun asht me ba gjamë mbi tē dekunin tri heresh tuj përsritun fjalët «I mjeri im!» nandë heresh.

Neni 1251 Miqt qi grishten ftyrë në dekë tē mikut nuk do t'i lajn faqet e përgjakuna as në shpi, as në katund tē tē dekunit e as pér udhë, por si tē mbrijn në shpi tē vet.

Neni 1252 Zija pér tē dekun tē shpis, pér burrinim, jo pér gra, do tē mbahet nji vjete».

Të ç'kushtetute janë këto nene tē çuditshme? Fryt i fantazisë? Copëza kujtimesh tē ardhura në-pér faqe librash apo gojë pas goje që larg?

S'është as e para e as e dyta. Këto s'janë veç 27 nga 1263 nenet e Kodit zakonor shqiptar, tē botuara në vitin 1926 nga famullitari Shtjefën Gjeco-vi në veprën e tij monumentale «Kanuni i Lekë Dukagjinit».

Kur ato u mblohdhën e u kodifikuan prej Gjeçovit, ishin ende në veprim, madje si për të mbyllur një rreth fatal, më 14 tetor të vitit 1929, në orën tre pasdite, vetë Shtjefën Gjeçovi u vra në një mënyrë e në rrethana të ngjashme me ato që përmenden në Kodin e lashtë.

Ky kod ka qenë kushtetuta e vërtetë e shqiptarëve gjatë shumë e shumë shekujve gjer në Luftën e Dytë Botërore. I transmetuar gojarisht brez pas brezi, i përpiktë, i pamëshirshëm, total, ai ngërthen gjithë jetën e vdekjen njerëzore, duke përcaktuar rigorozisht gjithçka, që nga rregullat e servirjes se kafesë, mosrespektimi i të cilave mund të shkaktonte armiqësi mortore, gjer në djegien për ndëshkim të një krahine të tërë.

Një enciklopedi e vërtetë e madhështisë dhe e marrëzisë, ai është sa i logjikshëm, aq edhe i palogjikshëm, sa tragjik, aq edhe grotesk.

Por ka në të një zallahi, që për njeriun e kulturuar ngjan e njojur, një vetim maskash që turbull të kujton diçka. Zile bagëtish e të lehura qensh të stanit, mullinj, farka, kuvene burrash, gjueti, ceremoni dasmash etj., ndërpriten nga ndërhyrja brutale e vdekjes dhe e dhunës: vrasje, tmerre, rrëmbime grash, fyerje në tryezën e gostisë, dhunim i mikpritjes, gjakmarrje brez pas brezi, përligjje e gjakut, mospërligjje, gjykimi prej jurisë së pleqve, ceremonitë mortore, varret... etj., etj.

Një popullsi e tërë e obseduar prej gjetjes të së drejtës, një përpjekje për të mos kapërcyer mësën e gjérave, mbi të gjitha, një fatalitet që rri si-për gjithçkaje si një diell i ftohtë e prej të cilit nuk shpëton dot.

Eskili, ky humbës i madh

Po kjo është klima e tragjedive të vjetra, do të thotë dikush. Është pikërisht ashtu. Dhe mund të thuhet se është vështirë të gjendet një tjetër jetë që të ndodhet kaq pranë teatrit, sa ajo e përshkruar në kodin zakonor të shqiptarëve.

Hijet dhe maskat ngjajnë, dhe kjo nuk është e rastit. Ç'prej mijëra vjetësh shqiptarët kanë qenë në kufi me grekët. Të vjetrit dhe të rinjtë.

15

Prej kohësh është pranuar si një fakt i padis-kutueshëm se letërsia e vjetër greke ka ditur të përfitojë nga gjithë vratat anësore artistike që gjë-llinin rreth trojeve të Greqisë, që nga mitet asiro-babilonase, egjiptiane, poemat e stërlashta, si «Gil-gameshi», e natyrisht, më shumë akoma, nga burimet që rridhnin ngjitur me kufijtë natyrorë të Greqisë, fqinjët e saj ballkanas. Këto burime bujarisht, ditë e natë, dërgonin drejt metropolit artistik grek copëra thesaresh shpirtërore, që i shtoheshin thesarit kolosal të grekëve. Mite të tëra ose pjesë mitesh, copëra poemash, orale, përfytyrime artistike nga më të habitshmet, emra hyjnish qiellore e skët-terore synonin dalëngadalë drejt universit grek, duke shtuar, modifikuar apo motëruar yllësitë e tij.

Megjithatë, ndonëse është pranuar pothuajse njëzëri një fazë e tillë, duhet thënë se në morinë e pafundme të studimeve për letërsinë antike greke janë ende të pamjaftueshme afot studime e kërkime

Eskili, ky humbës i madh

që e lidhin këtë letërsi, rrënjet dhe mesazhet e saj me historinë, mendësinë dhe nënshtratin e përbashkët të popujve të Gadishullit Ballkanik, fqinjëve më të afërt e më të moçëm të grekëve të vjetër.

Disa faktorë kanë ndihmuar për këtë konceptim disi të shkëputur nga trualli i vet të thesarit më të shkëlqyer shpirtëror të kontinentit tonë të vjetër.

Ndër faktorët kryesorë ka qenë pa dyshim fakti që letërsia antike greke i kalon trashëgimisë evropiane nëpërmjet urës latino-romake. Ishin romakët ata që, pasi u entuziazmuani prej saj, pasi e lanë veten të pushtoheshin prej saj (gjë që pa dyshim ka qenë një meritë e tyre), e botuan, e ribotuan, e përkthyen dhe e komentuan atë gjërësisht. Pra, e tillë, e shoqëruar, në radhë të parë, me komentin romak, ajo nisi udhën drejt njoftes botërore.

Pikërisht këtu ka ndodhur dhe atentati i parë ndaj kësaj letërsie. Pavarësisht prej luajalitetit romak ndaj artit grek, s'duhet harruar për asnjë çast se romakët kanë qenë pushtues madje ndër më të egrit dhe sistematikët që ka njojur historia. Si të tillë, ata s'mund t'i kuptionin kurrsesi ato puse të thella prej nga ngjiten urdhurat e sinjalet e një populli, ato që vendosin dhe programojnë artin e tij. Aq më pak mund të kuptionin romakët ndikimet e ndërsjella të popujve ballkanas te njëri-tjetri e sidomos këmbimet e thesareve shpirtërore. Me përbuzjen dhe krenarinë e pushtuesit, pasi e kishin nënshtruar me hekur e gjak gadishullin, ata as që mund të pranonin se edhe popujt e tjerë kishin nga ato merita që ata u detyruan t'ua njojin grekëve.

Aq më tepër që këtu është fjala kryesisht për ilirët kokëfortë, të cilët më shumë se kushdo tjetër i kishin sjellë telashe Romës «së pathyeshme».

Veç kësaj, s'duhet harruar se romakët e shpalën veten pasardhës të drejtpërdrejtë të kulturës greke, dhe përsëri krenaria dhe arroganca e push-tuesit as që mund t'ua qaste mendimin për ta ndarë këtë monopol me dikë tjetër.

Për fat të keq, komentet, hulumtimet dhe tezat latine për letërsinë antike greke morën një farë zyrtarizimi në botën evropiane. Ato mbetën të tilla edhe pas shembjes së Romës dhe shumë prej tyre vazhdojnë të jetojnë ende sot, pavarësisht nga ndonjë formulim i sofistikuar.

Zhvillimi, nga njëra anë, i vendeve evropiane dhe mbetja prapa, nga ana tjetër, i vendeve ballkanike, që ranë nën sundime të errëta të njëpasnjëshme, e zmadhoi edhe më tepër mospërfilljen e metropoleve ndaj truallit që kishte pjellë dikur kryevepra të mahnitshme. Përbuzja romake u zë-vendësua me përbuzjen e përbashkët të shteteve të mëdha perëndimore, të cilat, me gjithë thirrjet e herëpashershme të Bajronit apo Shellit, Gëtes apo Holderlinit, shumë shpejt e harruan se kujt ia detyronin rrënjet e tyre kulturore.

Mospërfillëse ndaj fatit të popujve ballkanas, ishte e kuptueshme që këto vende do ta shikonin letërsinë dhe artin grek të shkëputur nga rrëthanat historike e shoqërore, nga identiteti i vetë popullit grek (pati shkencëtarë që u përpoqën të vërtettonin se grekët e sotëm s'kanë të bëjnë fare me grekët e vjetër). Për këta letërsia antike greke ishte

një thesar universal dhe, sipas koncepteve të tyre, thesaret universale janë pa atdhe. Edhe në qoftë se shpeshberë nuk kanë pasur guximin ta shprehin kaq haptas një mendim të tillë, gjithë struktura e ideve të tyre, përfthimi i letërsisë jashtë kohës, i historisë, i dramave konkrete, të sjell detyrimisht te *ky mendim*.

Prapambetja tragjike e popujve ballkanas do të sillte vjetveti edhe një pjesëmarrje jo të ndjeshmë të shkencëtarëve e filozofëve të tyre të paktë në debatin universal për antikitetin. Të zotët e shtëpisë mbetën kështu të mënjanuar për një kohë tepër të gjatë. Por në shekullin e nëntëmbëdhjetë, pas fitimit të pavarësisë së Greqisë e, më vonë, gjatë kohës së furishme të popujve të tjerë të gadishullit e të çlirimt të krejt Ballkanit prej zgjedhës osmane, fjala e vendësve do të dëgjohej përherë e më tepër dhe dalëngadalë ajo do të ndikonte edhe te shkencëtarët e huaj, tek ata më të thellët e më seriozët, që do ta kuptionin se pa atë fjalë shumë gjëra që do të thuheshin për letërsinë dhe artin antik do të ishin të mangëta. Këta, të ndërgjegjshëm se kur është fjala për nënshtratin e përbashkët kulturor ballkanik, shqiptarët, si një ndër popujt më autoktonë të gadishullit, kanë të drejtën e një fjalë që meriton të dëgjohet, kanë shkruar e folur shumë herë për fijet e shumta që lidhin artin grek të fjalës me historinë e përbashkët të popujve ballkanas, me artin e tyre, e sidomos me pasurinë orale të poezisë e të prozës së moçme shqiptare. Krahas tyre, shkencëtarë e studiues të shquar të vendeve të tjera jo vetëm e kanë pranuar si të padyshimtë

Eskili, ky humbës i madh

këtë, por kanë dhënë një ndihmesë të ndjeshme për kërkime e zhbirime të mëtejshme. Dicka pa dyshim éshtë bërë, por ajo éshtë ende pak dhe e rastësishme. Kështu, p.sh., në një libër të tyre të vitit 1986 J. P. Vernant e P. Vidal Naquet riprodhojnë të përkthyer në frengjisht nën titullin «Një Edip rumun» një baladë të vjetër rumune, mbledhur e botuar më 1967 në Bukuresht nga vetë rumunët. Analogja që mitologët francezë gjejnë midis mitit grek të Edipit dhe baladës rumune éshtë fare e dukshme dhe të vjen vërtet keq që hulumtime krahasuese të tilla janë ende tepër të rralla. Në të vërtetë, me dhjetëra janë këngët e baladat e vjetra në të gjithë popujt e Gadishullit Ballkanik, ku gjenden diku më qartë e diku më zbehtë jehona të mitit të Edipit, si dhe të miteve të tjera antike. Ato gjenden sidomos me shumicë në këngët e mërgimit ushtarak e në ato të mërgimit ekonomik.

Mërgimi ushtarak dhe ekonomik ishin dy nga dramat më të rënda për njeriun ballkanas. Shërbimi ushtarak, që në shumë vende ishte një gjë pak a shumë e zakonshme, për ballkanasit merrte përmasa skëtterore. Vetë fakti që në kushtet e një perandorie kolosale, siç është perandoria turke, ku shërbimi kryhej në zona tepër të largëta si në shkretëtirën e Jemenit apo të Arabisë Saudite, mjaftonte për t'i dhënë ngjyrën e tragjedisë. Një pjesë e rekrutëve nuk kthehej më, të tjerë vinin të ndryshuar nga afati i gjatë i shërbimit apo nga dielli i shkretëtirës. Në balada nga më të pikëllueshmet éshtë dhënë moskthimi ose kthimi (që pak ndryshonte nga moskthimi), i këtyre rekrutëve.

Eskili, ky humbës i madh

Mërgimi ekonomik, që nisi fill pas çlirimit të Ballkanit nga zgjedha turke (si për të mos i lënë popujt e gadishullit pa fatkeqësi), kishte po ato përmasa hapësinore si i pari, veçse këtu shkretëtirat arabike zëvendësoheshin nga SHBA, Australia etj. Ashtu si në rastin e parë, edhe këtu një pjesë e të ikurve nuk ktheheshin më ose, kur ktheheshin, nuk njiheshin më.

Për të kënduar këto dy brenga kolosale popujt ballkanas gërmuan, me sa duket, në kujtesën e tyre të përbashkët artistike dhe që nga puset e saj rinxorën në dritë modelet e vjetra, atë mekanizëm artistik që kishte krijuar dikur «këngët e mungesës e të kthimit» (the songs of absent and return). Hijet e Odiseut, Agamemnonit, Edipit ishin të gjitha aty, prapa pajimeve ushtarake të rekrutëve ose valixhes së emigrantit që priste me ankth zbarkimin në tokën e SHBA. Asjeta e kazermës në shkretëtirë, as dritat e Manhattanit e të Bruklinit, nuk shlyen dot prej ndërgjegjes së tyre trazimet e moçme artistike. Ndaj, kur erdhi çasti për të kënduar dramat e reja «të mungesës e të kthimit», ata i refuzuan imazhet që u ofronte shkretëtira arabike ose realiteti amerikan, dhe iu kthyen kallëpeve të vjetra, atyre kallëpeve, në të cilat ishte gatuar dikur brumi i poemave arkaike e i teatrit tragjik. Kështu që, duke mos u mjaftuar me baladat ku këndohej mërzia e ushtarit, jeta e kazermës, shtrëngesa ekonomike e familjes që e pret, vdekja që kërcënon ushtarin gjatë shërbimit etj., etj., muza nopollore kërkoi dimensione edhe më universale përkëtë dramë. Motivin e martesës jashtë fisit, mun-

Eskili, ky humbës i madh

dësinë e inçestit midis vëllait e motrës, atë motiv që Eskili e kishte trajtuar te «Lutëset» e tij dhe që në mesjetën e hershme gjithë popujt e Ballkanit e kishin kënduar në baladën e Vëllait të Vdekur, muza popullore ia përshtati brengës moderne të shërbimit ushtarëk. Në balada të shumta këndohet mundësia e inçestit midis vëllait ushtar, të cilin, ngaqë kthehet pas një kohe të gjatë, nuk e njeh askush, dhe motrës së tij, me të cilën duan gabimisht ta martojnë. Kurse nën petkat e emigrantit ekonomik që kthehet më në fund nga SHBA ose Australia, shfaqet befas Edipi. Por drama e Edipit zhvillohet me kahe të kundërta. Nuk është i biri, por i ati që emigron për një kohe të gjatë dhe, si rrjedhojë, nuk është i biri që vret të atin, por i ati që në kthim vret të birin e vet, duke e kujtar përdashnor të nënës, domethënë të gruas së tij. Në rastin e inçestit vëlla-motër, në baladat popullore ballkanase vepron mekanizmi i asaj që mund të quhet «ndërprerja e ëndërrës» së keqe në çastin e fundit» (përherë gjendet një shkas, një kujtim, një shenjë që e shmang inçestin). Kurse te «Kthimi i emigrantit birvrasës» vepron drama e keqkuptimit. Është kjo arsyje që disa studiues i kanë quajtur fundet e tyre «optimiste», duke vënë në këtë epitet një nënëtekst të lehtë nënvleftësues. Mendoj se fundet, «optimiste» ose jo, nuk ndryshojnë asgjë në vlerën e këtyre këngëve dhe se qëndrimi i muzës populllore në këtë rast ngjan fare mirë me fjalët e Sopokliut:

Esleili, ky humbës i madh

*Kurse kurorës me nënën mos iu tremb,
Sepse shumë njerëz ëndërr kanë parë
Me t'ëmën duke fjetur.*

Natyrisht, që në krahasimin e miteve, të poemave e tragjedive antike me jehonat e tyre të mëvonshme në poezinë orale ballkanase ka ende shumë për të zbuluar. Veçanërisht ka shumë për të zhbiruar në poezinë orale të shqiptarëve, e cila, duke qenë nga më të vjetrat në gadishull, është shumë më e ngarkuar me kujtime të vjetra mitologjike.

Lidhur me këtë duhet thënë se kjo afërsi poetike nuk është e rastit. Shqiptarët, si fqinjët e përhershëm të grekëve në të gjitha kohët, duke pasur një gjuhë që ndryshonte rrënjesisht e në gjithçka nga greqishtja, kishin, përkundrazi, mjafthngjashmëri në sferat e tjera. Kohët e fundit J. Laccariere, duke shkruar për fytyrën e Greqisë së pavarur, thotë: «Kjo fytyrë nuk është gjithmonë e ndjeshme aty për aty, sepse, siç e kemi parë, kjo Greqi e pavarur, e sapodalë rishtaz, e megjithatë autentike greke, është ende e maskuar nën lajlet turke, shqiptare, e më pas bavareze. Ky është pa dyshim një nga tiparet më të veçanta të këtij shteti të ri; të lindet e të rritet nën maska të ndryshme, të huajtura nga pushtuesit ose «protektorët» e saj.

Pa kundërshtuar atë që thotë J. Laccariere lidhur me maskat e huaja mbi fytyrat e Greqisë, mund të bëjmë, megjithatë, pyetjen: në qoftë se maska turke ka qenë ajo e pushtetit dhe maska

Eskili, ky humbës i madh

gjermane ajo e «protektorit», ç'mund të themi për maskën shqiptare? Dihet se Shqipëria as ka qenë e as mund të ishte qoftë pushtuese, qoftë protektore e Greqisë. Atëherë, ç'e nxori maskën e saj mbi fytyrën e vendit tjetër?

Përgjigja është e thjeshtë: pa qenë as pushtues e as protektorë të grekëve, shqiptarët kanë qenë thjeshtë fqinjët e tyre, fqinjë të përhershëm e të pandryshueshëm qysh nga kohërat mitologjike e gjer në ditët tona. Kjo aftësi është, pra, pjellë e fqinjësisë dhe në çfarëdo formulimi që të shprehët (maska, nënshtrat, mbishtrat etj.), ajo mund të dëshmohet njëloj si duke u nisur nga koha jonë për të zbritur në thellësi të shekujve, si duke u ngjitur që andej drejt kohës sonë.

Për t'u nisur nga thellësitë, nuk është fjala vetëm pér të qëmtuar emra nimfash e hyjnish, pér hijet e Circesë, të Erinive, të Ciklopit, të Orestit etj., që shfaqen herë pas here në eposin e lashtë shqiptar, as pér shpjegime emrash e dukurish që mund të zbërthehen vetëm prej gjuhës shqipe, pra, s'është fjala vetëm pér gjetje të tillë, e as vetëm pér jehonën që kanë lënë në veprën e tragedianit fatet e përbashkëta historike të vendeve ballkanase, por pér struktura edhe më të thella e arkaike, që ridëshmojnë fuqishëm ekzistencën e një nën-shtradi: kultit iliro-shqiptaro-grek.

Trilogjia «Orestia», vepra më e plotë dhe më e bukur në tragedinë antike, është ndoshta dëshmia më bindëse pér këtë.

Gjaqet; si pjellë e rendit gjinor, janë një dukuri e njohur në mjaft popuj e në mjaft pikë të glo-

bit tokësor, madje shpesh të largëta nga njëra-tjetra. Por, në ndryshim nga shumë popuj të tjerë, gjakmarrja te një pjesë e ballkanasve, kryesisht te shqiptarët, ka qenë pjesë e atij mekanizmi kush-tetues që rregullonte tërë jetën e tyre juridike, morale, filozofike. Në kodin zakonor themelor të shqiptarëve gjyqësitë e gjakut zënë një vend të ndjeshëm. Interpretuesit e kodit ishin juristët e vetëm që pranonte grindja, duke flakur përherë si mish të huaj çdo të drejtë tjetër të mëvonshme, goftë të drejtë romake, bizantine, apo turke.

Nga ana tjetër, duke nënvisuar se vrasjet përmotivë hakmarrjeje, si dhe gjyqet për to kanë shërbuer si motiv për një mori veprash lefrare, duhet thënë se «Orestia» është e vetmja vepër-antike dhe e rrallë në krejt letërsinë botërore, ku motivi i gjakut dhe i gjyqësisë mbi të shtjellohet në atë kolizion si në kodin zakonor të shqiptarëve. Ai jo vetëm është i lidhur me rruaza të atilla, që janë themelore në kodin shqiptar, si dhunimi i mikpritjes, ndëshkimi për këtë, caku gjer ku mund të shkojë e drejta për ndëshkim, dhe dënim i tejkalimit të kësaj të drejte (në kodin shqiptar gjyqtarët kanunorë arrinin gjer atje sa të numëronin edhe plagët e viktimës; në rast plagosjeje, për të përcaktuar kështu më saktë të drejtën e kompensimit), po shkon edhe më tej: siç e pamë edhe më lart, një nga motivet qendrore të tragjedisë «Orestia» është grindja midis hyjnive, si edhe midis gjyqtarëve athinas lidhur me parësinë e gjakut atëror apo mëmësor. Mund të thuhet, pa asnjë teprim, se kjo polemikë e lashtë, që bëhet në këmbët e

Eskili, ky humbës i madh

shtatores së hyjneshës Atenë, është përsëritur mi-jëra herë në gjyqësitë e gjakut pranë kullave të gurta të malësorëve shqiptarë. Prioriteti i «lisit të gjakut» mbi «lisin e tamblit», këtyre formulave që në Kodin zakonor shqiptar ishin terma të mirëfilltë juridikë (nenet 700-701), përcaktonte shpeshherë, ashtu si tek «Orestia» e Eskilit, nëse kishte qenë e drejtë ose e padrejtë vrasja, nëse duhej të ndërpritej ose të vazhdonte gjakmarrja.

Lidhur me prioritetin e njërsës linjë prejardhjeje ndaj tjetrës, duhet shtuar se edhe kjo është një dukuri e njohur në shumë popuj, madje mund të thuhet pa frikë se në shumicën e tyre është kryer procesi i ndeshjes midis «vijës atërore» e «vijës mëmësore», por kjo ka pasur lidhje kryesisht me trashëgiminë e pronës dhe të fëmijëve. Kurse në kodin e shqiptarëve, ashtu si tek «Orestia», gjithë vëmendja përqendrohet tek e drejta ose jo per gjakderdhje të mëtejshme.

Është me interes të nënvizohet këtu se e gjithë kjo ngjashmëri nuk haset aspak në trojet e afërtë me kufijtë grekë, por në Alpet Veriore shqiptare, të cilat jo vetëm ishin tepër lart qillit të Atikës, por ishin të tillë vende të zymta e të ftohta që greku i vjetër nuk mund t'i përfytyronte veçse si humbëtira për ndëshkime të ngjashme me mbërthimin e Prometeut.

Por afëria nuk ndalet me kaq: procesi mijëvjeçar i ndeshjes midis forcave ruajtëse të kanunit shqiptar dhe forcave shtytëse të tij, pulson si një magmë e nëndheshme në «Orestian» eskiliane, e cila, në fund të fundit, e ngre qartë çështjen se cila

Eskili, ky humbës i madh

«e drejtë» duhet të sundoje në shoqërinë njerëzo-
re: ajo e impulseve të gjakut apo ajo shtetërore.

Grekët e vjetër e humbën herët kodin e tyre
të lashtë, që e kishin të ngjashëm me fqinjët e
tyre shqiptarë. Shqiptarët e ruajtën gjer vonë në
gati gjysmën e vendit, dhe kjo nuk është as shenjë
merite dhe as shenjë prapambetjeje. Dukuria ka
shpjegimin e saj, që lidhet me një sërë faktorësh
historikë, socialë e deri gjeografikë, me natyrën
intensive të pushimit në disa zona të gadishullit
e me njëfarë pavarësie që mundën të ruanin zona
të tjera, kryesisht ato malore. E drejta romake, bi-
zantine e pastaj ajo turke, si valë të njëpasnjëshme,
fshinë gjurmët e fundit të kodit të lashtë ndërball-
kanas, që qytetërimi grek, me zhvillimin e tij, po-
thuajse e kishte mënjanuar ngajeta. Grekët ishin
në atë kohë në pararojën e qytetërimit botëror dhe
ishte e natyrshme që atë hap do ta bënin të parët
ata. Ndoshta shqiptarët do të ecnin në atë rrugë,
por pushtimi romak, i cili në trojet shqiptare kaloi
nëpër përrunj gjaku e urrejtjeje, luajti një rol frenues
për këtë. Shqiptarët parapëlqyen të ruanin
kodin e tyre të prapambetur vërtet në krahasim me
«jus romana», por që, së paku, e kishin të tyrin.
Ky kod, pjellë e rendit gjinor, duhej të ishte i pa-
pranueshëm për romakët, sepse, siç thotë Engelsi,
«sundimi mbi të nënshtruarin nuk pajtohet me ren-
din gjinor». Gjithmonë sipas tij, «ai nuk kishte
mjete të tjera detyrimi përvëç opinionit publik», një
gjë fort e papërshtatshme kjo për romakët, sepse
gjer më sot nuk është parë kurrë një pushtues,
qoftë dhe mediokër, pa le pastaj një pushtues i

tmerrshëm si ai romak, që të respektojë opinionin publik të të mundurit. Kështu që shqiptarëve do t'u jetë dashur të bëjnë një luftë të dëshpëruar për të ruajtur ligjet e tyre kanunore.

Një mijë vjet më vonë, kur Greqia dikur e ndritshme qe zhyturi në muzgun bizantin, kurse principatat dhe kontetë shqiptare, më të përparuara tashmë se ajo, me klimë dhe ligje evropiane, në prag të Rilindjes, në ecjen e vrullshme drejt Perëndimit po e flaknin me siguri të drejtën e moçme, një natë tjetër e zezë, më e errëta e të gjithave, plakosi grekë e shqiptarë bashkë, gjithë gadishullin e bukur e të magjishëm të arteve, nata osmane. Ishte e natyrshme që përpara ligjit të zymtë turk të shariatit, shqiptarët t'i rikthehen kanunit të tyre mijëvjeçar ashtu siç qe, shkëmb i pagdhendur mi-rë, i përgjakshëm vërtet, por dinjitoz në tragjizmin e tij.

Por, le të kthehem tek «Orestia». Ngjashmëritë me kodin e shqiptarëve nisin që në fillimin e konfliktit greko-trojan, konflikt pa të cilin ne e kemi të vështirë ta përfytyrojmë si do të ishte letërsia e vjetër greke. Kur flitet për këtë konflikt, është vështirë të mënjanosh nga mendja fillimin e tij, rrëmbimin e Helenës. Në mijëra tekste shkollore apo akademike, do të gjejmë pak a shumë formulimin: pavarësisht se lufta e Trojës u bë për shkallë të tjera, kryesisht ekonomike, pretekst për fillimin e saj ishte rrëmbimi i Helenës së bukur prej princit trojan, Paridit. E marrë në mënyrë të përgjithshme, thënia duket e drejtë, por e parë më kujdeshëm, ajo ka brenda një mangësi të madhe.

Pas pyetjes: vërtet Helena është shkaku i luftës? — të sqaruar tashmë prej kohësh dhe të quajtur unanimisht si një pretekst, duhet të vinte pyetja tjetër: a mund të shërbente, qoftë edhe si pretekst, rrëmbimi i Helenës? Nga leximi i «Orestias» del fare qartë se jo.

Jo çdo rrëmbim gruaje mund të shërbente si pretekst lufte dhe të zgjonte zemërimin e njerëzve dhe të hyjnive në mbarë Greqinë. Rrëmbimi, ikjet, arratisjet e grave me dashnorët kanë qenë të panumërtë në jetë dhe në letërsi, kurse rrëmbimi i Helenës ka diçka të veçuar, të aftë që të trazojë njerëzit në tokë dhe hyjnité në Olimp.

Po kjo e veçantë është pikërisht fakti që Helena është mbretëreshë, mund të thotë dikush. Në pamje të parë mund të duket kështu, por vetëm në pamje të parë. Të qenët mbretëreshë nuk e bën aspak rrëmbimin e Helenës të jashtëzakonshëm, dhe kjo për disa arsyen. E para, se koncepti «mbretëreshë» për grekët e vjetër është shumë larg nga ai që kemi. Më shumë se mbretëresha, ato kanë qenë gra prijësash. E dyta, s'duhet harruar se Helena nuk është mbretëreshë e Greqisë (të tillë s'ka patur kurrë në atë kohë), por e Spartës, pra, një nga dhjetëra «mbretëreshat» greke. E treta, rrëmbimi i saj sa ç'mund të zgjonte një vrundull luftarak te «mbretërit» e tjerë (fyerja e autoritetit etj., etj.), po aq mund të zgjonte të kundërtën te gratë e tyre, të cilat do të bënin çmos për të sabotuar një fushatë që do të bëhej për hir të rivales së tyre të bukur.

Eskili, ky humbës i madh

Dihet se grekëve iu deshën dhjetë vjet për t'u bërë gati për fushatën (përçarje, mosmarrëveshje, ndoshta sabotimi i grave të prijesave etj.) dhe ndoshta një pjesë të kohës e humbën për të gjetur arsyen e fushatës. Ka mundësi që, pasi u përpotoqën më kot të shfrytëzonin aventurën e Helenës si pretekst, ata e ndjenë të nevojshme ta shoqëronin atë me diçka më indinjuese.

Eskili shkruan:

*Kështu erdh Paridi
Mik i një nate te Atridët,
Por zakonin e mikut
Shkeli e zonjën rrëmbeu.*

Më poshtë:

*Se e ktheu mëria hyjnore
Këtë dasmë në zi për Trojën.
Mbrojtës i mikpritjes, Zeusi
E ndëshkoi shkeljen e besës*

*Dhe tryezën e dhunuar,
Edhe dasmën zhurmëmadhe;
Ku vëllezërit e dhunuesit
Si krushq ogurzez këndonin.*

Kjo diçka e veçantë, kjo që rrëmbimin e ktheu në një gjëmë të vërtetë, nuk është vetë akti i rrëmbimit, por «shkelja e zakonit të mikut», «tryeza e dhunuar»; dhe këtë ripohon më së miri theksimi:

Eskili, ky humbës i madh

*Mbrojtës i mikpritjes, Zeusi
E ndëshkoi shkeljen e besës.*

Mirëpo formulime të tilla, si «shkelja e besës», «prerja e mikut në besë», «dhunimi i tryezës» (druveza e dhunueme) prej mikut janë gurë themelorë të kanunit shqiptar, të tilla që shkaktonin jo vetëm gjak e plojë midis familjesh e fisesh, por disa herë midis krahinave të tëra.

Rituali i mikpritjes, ashtu si edhe gjaqet, është gjithashtu i njojur në shumë popuj, por te ballkanasit, e sidomos te shqiptarët ai është sofistikuar e kodifikuar gjer në pedantizëm. Veç kësaj, si në asnjë rajon tjetër të botës, ky ritual, e sidomos negacioni i tij, dhunimi i mikpritjes, është kënduar në balada nga më të bukurat e tronditëset. Ende sot, në zona të largëta malore, syri i udhëtarit mund të ndeshë kulla të braktisura, që në sytë e shqiptarit janë njëlloj si banesa të skëterrës, ngaqë dikur në to është kryer një dhunim i mikpritjes.

Nenet e tmerrshme 1189 e 1190 të Kodit e përcaktonin qartë se ç'bëhej me shtëpinë ku ndodhë «premja e mikut». Ajo shtëpi gjithashtu duhej «me u pre». «Neni 1189. E premja e Shpis asht kur t'i zhgulin gurët e katër skepeve të shpis për rrazë themelit. Kjo bahet pasi të digjet shpija. Neni 1190. E premja e shpis në Kanun shenjon se gjindja e asaj shpije janë të nxjerrun prej vendit me lang e pang e përgjithmonë.»

Por i gjithë ky adhurim e kujdes për mikun kthehej në të kundërtën, në qoftë se miku abuzonte me të («Neni 639. Sikur je në detyrë më lypë mi-

kun e prem ashtu je në detyrë me dhanë arsyenë preftë kënd miku në bukë tande»). Për malësorin shqiptar, si Makbethi, si Paridi janë njëlloj të dënueshën, sepse ndërsa i pari ka vënë dorë mbi bujtësin e vet, i dyti ka abuzuar mbi mikpritjen.

Që dhunimi i mikpritjes te shqiptarët ka qenë burim real konfliktesh nga më tragjiket gjer afër mesit të shek. XX, kjo dëshmohet lehtë, qoftë edhe nga një shfletim i gazetave të viteve '20 e '30-të. Malësorët shqiptarë, për të cilët kërkesa e një shtegtarë të rastësishëm për të kaluar natën kishte vlerën e një «strehimi politik», hynin shpesh në konflikt të armatosur me këdo që e kërcënonte ose e ndiqte të panjohurin, qofshin këta edhe forcat e rendit. Që në konflikte të tilla hynin klane, fshatra e madje krahina të tëra, kjo gjithashtu është e dëshmuar me dhjetëra herë. Por një vërtetim akoma më bindës për prirjen e shqiptarëve që shkeljet e kodit zakonor t'i shndërronin në konflikt të zgjeruar, është ekzistanca gjer në shekullin XX e «rrugëve në besë». Duke mos u mjaftuar me imunitetin e shtëpisë, në disa krahina të Shqipërisë rrugë të tëra shpalleshin «në besë», domethënë të garantuara absolutisht për këdo që udhëtonte nëpër to. Garantimi bëhej nga X-klan ose X-fshat a krahinë dhe shtegtarët që zotuanë po atë status që gjëzonte miku brenda mureve të shtëpisë.

Ende nuk është studiuar mirë funksionimi i kësaj bese të veçantë të shtrirë në një territor kaq të gjerë e publik, siç është rruga. Nuk dihet mirë, p.sh., se kundrejt çfarë përfitimi një klan, një fshata e krahinë ishte gati të flijonte gjithçka për siguri-

Eskili, ky humbës i madh

min e këtij «eksterritorialiteti». Ashtu siç nuk janë hulumtuar siç duhet disa faktorë të tjerë që lidhen me të, p.sh., si e fitonte rruga këtë cilësi, e kishte të përkohshme apo të përjetshme, a quhej, në rast dhunimi të besës, një rrugë e turpëruar, në analogji me shtëpitë e turpëruara, dhe a ndëshkohej përkëtë? (Shtëpia besëprerëse digjej, po rruga ç'pëson-te? I hapeshin gropat përtu bërë e pakalueshme, e ndërpritnët me hendeqe, apo thjesht e braktisnin?)

Por, pavarësisht nga këto, ajo çka ishte më e qartë në këtë dukuri, ishte prirja e kodit zakonor përtë të zëvendësuar administratën shtetërore. Dalja e besës nga muret e shtëpisë në vendet publike dëshmon përtirjen drejt amplifikimit të konfliktit, drejt zgjerimit të dimensioneve të tij. Në këtë rast një hap e ndan aktin zakonor nga lufta midis dy fshatrave, krahinave, madje edhe midis dy popujve, në qoftë se «rruga në besë» do të gjendej në kufi. (Një pjesë e konflikteve midis shqiptarëve e slavëve, të kënduara në epolet e të dy palëve, kanë zanafillë klasike zakonore). Kështu që, po t'i thuhej malësorit shqiptar se kohë më parë u zhvillua një luftë midis grekëve e trojanëve përt shkak të një gruaje, ai do të ngrinte supet disi i habitur. Por, po t'i shpjegohej se këtu nuk ishte fjala thjesht përrëmbimin e një gruaje, por përt shkeljen e mikpritjes, kjo luftë, sado e përgjakshme, atij do t'i dukej gjëja më normale në botë.

Në këtë rast funksionimi i mendimit të malësorit shqiptar është i ngjashëm, në mos i njëjtë, me mendësinë e lashtë të të gjithë ballkanasve.

Eskili, ky humbës i madh

Nisur nga kjo del se Eskili ishte më i saktë se Homeri kur thekson dhunimin e mikpritjes si shkak kryesor për acarimin greko-trojan. Por, ndërsa gjatë pjesës përgatitore të fushatës ka dominuar ky pretekst për zemërimin, ka mundësi që në kohën e rrëthimit aventura dashurore e Helenës të ketë dalë prapë në plan të parë. Dhe kjo është e kuptueshme: për masën e madhe të ushtarëve rrëthues figura e një gruaje të bukur, mëkatare, është më tunduese se çdo koncept morali. Ajo thith më lehtë mendimet e tyre, ëndrrat erotike (kanë kaq vite larg grave), dyshimet për tradhtinë e tyre të mundshme (Helena, midis gjithë të mirave, i iku burrit, po ato?), zemërimi i herëpashershëm (ne ngrijmë këtu në acar, kur ajo bën qejf me dashnorin në shtratin e ngrohtë) etj., etj. Nuk janë as gratë e prijësave të tjerë që të frenojnë dominimin e Helenës, kështu që pikërisht aty nën muret e Trojës u bë dhe deformimi i parë i çështjes dhe Helena fitoi të drejtët e shpallet, e shumta, shkaktare e luftës, e pakëta, pretekst i saj.

Nuk po zgjatemi në përkime të tjera eskiliane me botën e sotme ballkanase, si vajtimet korale, aq të ngjashme me të sotmet në një pjesë të madhe të gadishullit, goditja me dorë e tokës, nën të cilën është varrosur Agamemnoni (në kodin shqiptar përcaktohet qartë se, fill pas varrimit, toka duhet të preket kështu, për ta marrë me të mirë që të pranojë të vdekurin etj.), por po ndalemi të një hollësi:

16

Pjesa e dytë e trilogjisë «Koeforet» mbaron me daljen nga pallati të Orestit, i cili, ashtu si Klitemnestra, në fund të pjesës së parë kërkon të përligjë përpara korit vrasjen që porsa ka bërë. Pasi shpjegon se ai e vrau nënën për arsy se ajo i ka vrarë babanë, për të ngjallur indinjaten e gjindjes, ai tregon pëlhirën-rrjetë, të cilën Klitemnestra ia hodhi përsipër viktimës përpara se ta godiste, në çastin që ai po ngrivej nga vaska e banjës. Kjo pëlhirë i ka ende sipër saj njollat e thara të gjakut të Agamemnonit.

Asnjë nga studiuesit nuk ka bërë pyetjen: përsë, në kundërshtim me dëshirën e vetvetishme të çdo vrasësi për të zhdukur gjurmët e krimit, Klitemnestra, në vend që ta zhdukte pëlhirën e kurthit, e ruan atë, madje ende të përgjakur? Dikush mund të thotë se krimi i Klitemnestrës është i shpalitur, kështu që mbulimi i gjurmëve s'përbën ndonjë problem. Që krimi është i shpallur, është e vë-

tetë, por mënyra e vrasjes e sidomos mjeti i mash-trimit, pëlhora, pavarësish se Klitemnestra në çastin delirant fill pas krimit e tregon rrëshqitazi, është tepër kompromentues pér t'u ruajtur. Fakti që me anë të saj Oresti nxit zemëratën popullore kundër mbretëreshës e vërteton këtë. Fakti tjetër që Oresti e gjen atë pëlhorë menjëherë tregon se ajo ka mbetur pa u zhdukur jo ngaqë është fshe-hur apo harruar diku në ndonjë qoshe të pallatit. Gjetja e menjëherershme e saj tregon se, përkundrazi, pëlhora me njollat e gjakut ishte vendosur në një vend të dukshëm në pallat.

Atëherë, përsë është ruajtur? Tragjikët e më-dhenj grekë e sidomos Eskili janë tepër skrupulozë kur është fjala pér logjikën e ngjarjes që përbën thelbin e dramës. Nga ana tjetër, pér të janë Cili, të huaja e të panevojshme efektet e jashtme. (Le të kujtojmë çastin e flijimit të Ifigjenisë, saktësinë e Eskilit kur është fjala pér të treguar kujdesin e flijuesve, të cilët nuk harrojnë t'i zënë gojën vaj-zës me një rrip, në mënyrë që ajo të mos lëshojë asnjë mallkim. Nga ana tjetër, kujdesi i Eskilit që të mos bëjë efekt me raportet baba-vajzë në një çast aq tragjik është i dukshëm).

Ruajta e pëlhorës-rrjetë prej Klitemnestrës nuk është as rastësi, as për arsyen efekti, por lidhet me gjithë dinamikën e krimtit. Por shpjegimi i saj mund të bëhet vetëm me ndihmën e kodit zakonor shqiptar. Dhe, ja, sesi: kur në një familje vritej dikush, këmishën e përgjakur e vendosnin në një vend të dukshëm të kullës malësore, në mënyrë që në bazë të ndryshimit të ngjyrës së njollave të gja-

Eskili, ky humbës i madh

kut mbi pëlhirë të hetonin sinjalet, që sipas tyre i vrari dërgonte që nga nëntoka: padurim për marrjen e gjakut, pezmatim apo pikëllim. Këto këmishë të përgjakura, që, sipas J. Lacarriere i ruajnë gjithashtu kretasit, luanin kështu një rol real në proçesin e mëtejshëm të gjakmarrjes.

Klitemnestra, pavarësisht se e ka bërë vetë krimin, është e vëmendshme për njollat e gjakut mbi pëlhirë, sepse ato janë i vetmi informacion i saj lidhur me përpjekjet e viktimës për të dërguar sinjale mbi tokë. Klitemnestra ka frikë nga gjakmarrja e të shoqit, ajo ka frikë sidomos se e di që Oresti është i gjallë, kështu që me çdo mënyrë është e interesuar të dijë nëse ka ndonjë komunikim midis babait të vdekur dhe birit të gjallë. Pasi e ka vrarë të shoqin, ajo ka marrë të gjitha masat për prerjen e komunikimit, duke e masakruar trupin e viktimës në atë mënyrë që, sipas grekëve të vjetër, e bënte të paafte per dërgimin e kumteve të tij mbi tokë. Megjithatë, ndonëse i ka marre të gjitha masat, Klitemnestra është syçelët. Ashtu si përgjuesi — që survejon fshehtazi postën, me anë të së cilës komunikon viktima, — ajo heton vazhdimisht ngjyrën e njollave të gjakut.

Të gjithë këtë pandehmë e vërteton skena ku Oresti me Elektrën mbi varrin e Agamemnonit i luten atij t'i ndihmojë në aksionin e tyre. Sipas grekëve, një gjakmarrje s'mund të kryhej më sukses pa miratimin dhe ndihmën e të vdekurit që nga nëntoka.

Në të vërtetë, pikërisht në çastin kur Oresti i vërtitet pallatit, Klitemnestra është e shqetësuar.

Eskili, ky humbës i madh

Eskili thotë se shkas për këtë është bërë një ëndërr, por dihet që ai është mbështetur në motërzime të ndryshme të eposit të Atridëve dhe ka mundësi që në një tjetër motërzim shkas për turbullimin e ndërgjegjes së mbretëreshës të jetë pikërisht një hetim i vëmendshëm i pëlhirës, ashtu siç kanë bërë në shekuj malësorët shqiptarë në kullat e tyre të ftohta veriore.

Të kthehem i te masakrimi i Agamemnonit prej së shoqes.

Në prologun e pjesës së dytë të «Orestias», kur Elektra nxit të vëllanë për hakmarrje, kori e përmend këtë copëtim të kufomës si një krim të dytë Klitemnestrës.

*Në do ta dish krejt të vërtetën,
Ajo tët'atë e masakroi
Ashtu të grirë e shtiu në dhe
Që ti me turp të mbeteshe përjetë.*

Sipas korit, masakrimi i trupit ishte një dhunim i rëndë, jo aq për anën e tij makabre, por në radhë të parë sepse, duke e bërë të paaftë të vdekurin të komunikojë me të gjallët (siç u tha më lart, grekët besonin se kufoma me duar e këmbë të prera, si ajo e Agamemnonit, nuk dërgon dot sinjale), praktikisht nuk e nxit më gjakmarrjen, e zbeh zellin për të, çka do ta bëjë Orestin ta harrøjë detyrën e të mbulohet me turp. Pra, mbulimi me turp i Orestit del këtu në plan të parë si një katastrofë e mundshme në jetën e tij. Me fjalë të tjera, ndërprerja e kumtit (me anë të masakrimit)

Apologji

Eskili, ky humbës i madh

midis të vdekurit e të gjallëve është në të vërtetë një ndërprerje në një kod zakonor, një pengesë që mekanizmi të mos funksionojë më tej.

Është pikërisht ky sfond që i jep turpit të Orestit një përmasë të re. Turpi i Orestit lidhet me rrezikimin e kodit. Si i tillë ky turp kanunor duhej të mbahet gjalli e të fryhej me të gjitha mënyrat. Se si bëhej kjo, Eskili nuk na e tregon. Por ajo që nuk tregon ai, dëshmohet gjerësisht në jetën e një pjesë të ballkanasve, e, në radhë të parë, të shqiptarëve gjatë shumë shekujve.

Në kronika e balada të panumërtë janë rrëfyer mëdyshjet e torturat shpirtërore të mijëra dje-mve shqiptarë, që janë lëkundur midis kryerjes së gjakmarrjes dhe shmangies prej saj. Është vështirë të përfytyrohet një hero tjeter antik që të jetë projektuar e përsëritur kaq në mënyrë masive midis njerëzve që nuk ia kishin dëgjuar kurrë emrin as atij e as Eskilit. Nga kjo pikëpamje, një pjesë e Shqipërisë, sidomos zona veriore e saj, po aq sa «vendi i shqiponjave», mund të quhej «vendi i Orestëve».

Trysnia për marrjen e gjakut në bjeshkët shqiptare ishte e tmerrshme dhe e gjithkundshme. Dukej sikur gjithëjeta qe rregulluar në atë mënyrë që me gjithfarë sinjalesh, zilesh e barometrash t'i kujtonte gjakmarrësit se duhej të ngutej. Një syçeltësi e madhe ndiqte kudo çdo shfaqje dyshimi ose frenimi që mund të dëmtonte kodin. Në këtë kahe mund të shpjegohet qartë edhe qëndrimi i shqiptarëve dhe i kodit të tyre zakonor ndaj gjymtimit të kufomave.

Jo vetëm masakrimi i kufomës së viktimitës ishte rreptësisht i ndaluar, por dënohej rreptë prekja më e vogël e saj. Dhe jo vetëm kaq. Shqiptarët, siç i çonin shpesh gjërat në teprim, e kishin bërë të detyrueshme për vrasësin kthimin mbarë të ku-fomës, në rast se i vrari kishte rënë përbys, madje ishte parashikuar kjo edhe në rastet kur vrasësin e zinte gjaku (Neni 846. Dorerasi po mujti vetë me e sjellë marë të vramin, mirë, përndryshe mbë këdo që të ndeshet do t'i thotë që të shkojë me e sjellë marë e armën me ia pshtetë te kryet. Neni 847. Dorerasi nuk guxon me marrë armën e të vramit, po bani kët faqe të zezë, aj bjen në dy gjaje).

Shqiptarët i përbuznin malazezët për zakonin e prerjes së kokave, që sllavët e kishin sjellë, me sa duket, nga stepat e largëta. Aq shumë kishin neveri për çdo prerje, saqë kodi i tyre zakonor e përjashtonte thikën nga përdorimi, dhe në baladat e në jetën shqiptare prania e armëve të ftohta është tepër e zbehtë. Kacafytja, gjithashtu, quhej pa dinjitet dhe e papranueshme.

Kaq e dukshme është kjo, saqë ngjan se kodi shqiptar mund të funksionojë vetëm me armët e zjarrit ose, së paku, me armë largësore (heshta, mazdraku), dhe, me sa duket, do ta ketë ndier veten keq, kur këto armë të moçme nisen të zëvendësohen nga shpatat dhe thikat, gjersa u shfaq arma e parapëlqyer, si e krijuar enkas për të, pushka.

Kjo syçeltësi kundër prerjes e masakrimit nuk mund të shpjegohet veç si syçeltësi për mbrojtjen e kodit. Logjika ishte e thjeshtë: përderisa masakrimi ndërpriste komunikimin e të vdekurit me fisin

e vet dhe përderisa ndërprerja e këtij komunikimi rrezikonte vazhdimësinë e kodit, merrej me mend që do të merreshin të gjitha masat që asgjë e tillë të mos ndodhë.

Kodi shqiptar, ndonëse pranon kumtin nga nëntoka, nuk shpjegon përsë është aq vendosmërisht kundër masakrimit. Përgjigjen për këtë e jep Eskili, në po atë mënyrë siç jep përgjigje kodi shqiptar se përsë prapa turpit të Orestit ishte mendësia e një rendi të tërë që rrezikohej.

Tek «Orestia» gjejmë formulime të tjera kanunore te shqiptarëve, qoftë të drejtpërdrejta, qoftë hijet e tyre, pa të cilat është vështirë të kuptoher një nyjë e tillë e rëndësishme e tragjedisë siç është, p.sh., trokitja këmbëngulëse, natën, e Orestit te shtëpia e Klitemnestrës-Egist, pas thirrjes të së cilës:

*Tri herë po thërras, hapeni derën,
Në qoftë se kjo shtëpi miqtë i pranon.*

ne ndiejmë jehonën e britmës shekullore shqiptare: «A pret miq, o i zoti i shtëpisë?»

Por formulimi i lashtë shqiptar nuk na ndihmon vetëm për dhënien e atmosferës, ai kthehet në një element thelbësor, në një kyç për të shpje-guar guximin e Orestit, i cili me arrogancë, gati me kërcënim troket në një portë që për të është njëlloj si një portë e panjohur, ashtu siç është ai vetë në rolin e udhëtarit të panjohur.

Ky guxim e, aq më tepër, kjo arrogancë e nxitur nga vonesa e hapjes së portës, do të tingëllonte krejtësisht e pakuptimtë dhe ilogjike sidomos.

mos në rrethanat e dramës, kur ne e dëmë ndërkaq që për këtë trokitje e këtë hyrje në shtëpinë e ar-miqve të vet Oresti me shokun e tij, Piladin, janë përgatitur gjatë. Vështirë që një lajthitje e tillë mund t'i shpëtonte qoftë edhe një dramaturgu fillestar e jo pastaj «atit të tragedisë».

Por këtu nuk kemi as lajthitje, as mungesë lo-gjike të personazhit apo të autorit. Dhe nuk i kemi këto pikërisht falë mendësisë së moçme ballkanike për mikpritjen, mendësi që më gjatë se kudo jetoi dhe mori formën e kodit të përpiktë në kanunin shqiptar. Sipas tij, hapja e portës së çdo shtëpie në çdo orë të ditës dhe të natës, pas trokitjes së kujtdo-qoftë, njeriu të njojur apo të panjohur, mjafton që ai të thërriste «a pret miq, o i zoti i shtëpisë», jo vetëm që shpalley e detyrueshme, por e kundërtë e saj quhej rreptësisht e dënueshme, njëlloj si një krim.

(**Neni 605.** Miku nuk mund të hije në shpi pa ba-za n'oborr. **Neni 604.** Si të baj za miku, i zoti i shpis i përgjigjet e i del përpara. **Neni 605.** Falet me mik, armën ia merr, e i prin në shpi).

Mbi të gjitha këto, nenë i famshëm 620. «Po të hini miku në shpi, gjak me të pasë do t'i thuesh: mirse erdhe!»

Pikërisht këtë ligj kanunor shfrytëzoi Oresti për të hyrë në shtëpinë e Atridëve!

Përkime dhe afërsi të tjera të kësaj natyre mund të gjenden edhe më shumë pas një hulumtimi të kujdeshëm qoftë të botës së vjetër greke, ashtu siç e kemi në libra, statuja e vazo, qoftë të botës ballkanase, në plotërinë e saj. Sidoqoftë, edhe ata

Eskili, ky humbës i madh

që për arsyet të ndryshme nuk janë partizanë të këtyre hulumtimeve, besoj se janë të një mendimi me një pjesë të madhe studiuesish e kërkuesish që mendojnë se «një zbritje në terren» për të kuptuar më mirë universin artistik grek, do të ishte e dobishme. Një zbritje nga piedestali i statujave, nga vijat fine të mermerit, që japid tiparet, rru-dhat, flokët dhe palat e tunikave, në tokën e gadishullit, të populluar nga njerëz që në shumë gjëra nuk ngjajnë, por në shumë të tjera ende ngjajnë me njerëzit e antikititetit.

Në vitet '30 homeristët amerikanë A. Lord dhe S. Parry patën idenë origjinale që të bënин një shtegtim në Shqipërinë Veriore dhe në Jugun e Jugosllavisë, në rajonin që ishte laboratori i fundit në globin tokësor, ku ende prodhoheshin epe të natyrës homerieke. Shumë pyetje lidhur me çështjen homerieke ata i zgjidhën ose mendonin t'i zgjidhnin gjatë këtij shtegtimi, në kontakte të drejtpërdrejta me rapsodët e kohës, duke i anketuar ata me durim për të zbuluar gjithë sekretet e kësaj mjeshtërie të zhdukur tashmë në botë.

Njohja e poezisë së mëvonshme orale të ballkanasve, e këtij kantieri tashmë të braktisur, por ku ende mund të gjenden margaritarë të një buku-rie të rrallë, është e domosdoshme për të njojur më mirë letërsinë antike. Vlera dhe rrezellimi i këtyre margaritarëve hedh dritë në thellësi të kohës dhe shumë pyetje që kërkohen në tryezat e studiuesve mund të gjejnë përgjigje në to.

Dhe jo vetëm njohja e artit oral, por vetë njo-hja më mirë e njerëzve të sotëm ballkanikë do të

ndihmonte për këtë. Ata ngjajnë vërtet pak me statujat e lashtësisë, po vallë statujat vetë kanë qenë të ngjashme me njerëzit e kohës që i lindi?

Nga leximi i kujdeshëm i letërsisë antike çdo njeriu normal i bëhet e qartë se grekët e vjetër nuk ishin vetëm të ndritshëm, të mençur e të mermertë, siç i shfaqen përfytyrimi shkollaresk e klasi-kegjant. Ata ishin sa të mençur, aq dhe të aftë për veprime të marrëzishme, sa të logjikshëm, aq edhe groteskë, sa stoikë, aq dhe të ngutur e të padurueshëm. Individualistë e pasionantë, sedërtarë, idhnakë e kokëfortë, kokëshkretë, sentimentalë, grarrëmbyes, të besës për punë të mbara, por edhe për prapësira, ata ngjajnë çuditërisht me njeriun ballkanas, sidomos ashtu siç ai mbërriti në shekullin XIX, kur ende gadishulli ruante një farë uniteti kulturor brenda kufijve të perandorisë osmane.

Imazhi aspak idilik i njeriut të antikitetit dëshmohet kudo. Mjafton të kujtojmë episodin kuptimplotë kur Euripidi, gjatë shfaqjes së një drame të tij, u detyrua të dalë në skenë për të qetësuar publikun e zemëruar, duke i shpjeguar se ajo të cilën ata po nguteshin t'ia kërkonin personazhit, do të ndodhëtë pak çaste më vonë, mjafton, pra, të kujtojmë vetëm këtë episod të thjeshtë të dëshmuar nga historia për të pasur një ide për spektatorin athinas në periudhën më të ndritshme të teatrit antik.

Përpëra këtij spektatori dramaturgut i duhej të kishte nerva të forta. Të tilla pa dyshim i kishin nervat tragjikët e mëdhenj.

17

Ka pasur një periudhë kur grekët e sotëm më tepër e kanë vuajtur se e kanë shijuar prejardhjen e tyre të lavdishme. Ata u ngjanin fëmijëve që u kujtojnë orë e çast e me qortim babanë e pa-shëm, të mençur e të madhërishëm. Zeshkanë më shumë se të çelët në fytyrë, të shkurtër më tepër se të gjatë, shumica analfabetë e të rreckosur, në shekullin XIX ata shkaktonin nervozizëm tek admiruesit e antikitetit.

Gjer atëherë kishin qenë nën jorganin osman, nën terr, por tani që dolën në dritë, zhgënjimi që shkaktonin ishte aq i madh, saqë nganjëherë sho-qërohej me një gjykim cinik: më mirë të kishin mbetur aty ku ishin, së paku, nuk do ta prishnin përfytyrimin tonë.

Nervozizëm duhet të kenë pasur, por në një kahe tjetër, edhe vetë grekët (së paku, atë që merrnin vesh ç'mendonin evropianët për ta), madje aq sa të ndienin dëshirën të suleshin për të thyer shtatoret e bezdissħme.

Fqinjët e tyre, shqiptarët, ndonëse më të çelët në fytyrë e më të gjatë nga shtati (sidomos në male), kanë ndjellë një nervozizëm të ngjashëm lidhur me stërgjyshët e tyre ilirë, me të vetmin ndryshim se, ndërsa grekët e ndollën nervozizmin te të tjerët, shqiptarët e bluan brenda vvetvëtes. Ne qenkemi shqiptarët e lavdishëm? — duket se ulërinin ata duke parë njëri-tjetrin fill pas fitimit të Pavarësisë. Ku janë heronjtë e baladave e të legjendave, trimat e mençur e vajzat leshverdha si rrallëkush?

Megjithatë, sado të dukeshin të pangjashëm me stërgjyshët, edhe grekët, dhe shqiptarët ishin nipat e tyre të vetëm. Me tejndjenjën e pagabueshme që kanë popujt, tani që u gdhinë në një botë që ngjante e huaj dhe e ftohtë, ata e kuptuan se duhej të afroheshin edhe më, ashtu siç afrohen jetimët. Se, në njëfarë mënyre, ishin vërtet popuj jetimë, pa fis të madh si sllavët e latinët, njëlloj siç i kishin të vetmuara e pa familje edhe gjuhët e tyre: greqishten dhe shqipen.

S'ishte e rastit që Bajroni i deshi njëlloj e shkroi me admirim për të dy popujt, ashtu siç nuk qe e rastit që shqiptarët ishin të vetmit ballkanas që ndihmuani gjerësisht grekët për fitimin e Pavarësisë. Mijëra luftëtarë, oficerë, gjeneralë e priftërinj të tyre luftuan për lirinë e Greqisë, njëlloj siç do të luftonin për Shqipërinë. Ishin aq shumë, saqë në flotën greke urdhrat për njëfarë kohe jepeshin në shqip, kurse në një nga mbledhjet e para të parlamentit u diskutua nëse do të përdorej edhe shqipja si gjuhë e dytë.

Eskili, ky humbës i madh

As gjuhët krejtësish të ndryshme, as rivaliteti, grindjet kufitare, madje as figura e Ali Pashë Tepelenës, guvernatorit të famshëm shqiptar që sundonte Shqipërinë Jugore e Greqinë Veriore, i urryer prej grekëve, por i padashur, ndonëse i mëshiruar prej shqiptarëve, nuk e penguan afrimin.

Në trazimin e madh të çlirimt prej zgjedhës turke ngjashmëritë me stërgjyshët e lashtë nisën të spikatnin edhe më fort. Puset e të dy kombeve nisën të nxirrnin më shumë se kurrë kujtime të vjetra. Dhe atëherë nisi të vërehej qartë se në tërbimin e ri ballkanas, në gjestet heroike, në formulat, mençurinë, kuvendet e burrave, si dhe në ethet e lavdisë e të marrëzisë, kishte skicime të dikurshme.

Kujtimet kishin qenë përherë aty, nën themellet e jetës. Ato kishin qenë në tokën greke e, përcudi, po aq të thella, në mos më tepër, në tokën e fqinjëve veriorë, ku, ashtu siç ndodh shpesh në kohë fatkeqësish, dukej sikur qe zhvendosur për t'u ruajtur në alpet e papushtueshme shqiptare një pjesë e thesarit të mocëm ballkanas.

Atje, në bjeshkët e ftohta; rapsodët këndonin ende si në kohën e Homerit. Gra të vjetra, që të kujtonin erinitë, me kostume me motive mikenase, përgjonin se mos të rinjtë i shmangeshin gjakmarrjes. Në kuvendet e burrave ndodhnin ngjarje të ngjashme me ato që kumtonin Herodoti dhe Plutarku. Garat dhe ndeshjet mortore ishin aq të ngjashme, saqë malësorit shqiptar, po të kishte mundësi të shikonte vrapiimin e Akilit e të Hektorit rrrotull murit të Trojës, do t'i duhej njëfarë kohe për të shkafitur nëse kjo ishte garë apo dyluftim për vde-

kje. E, kështu me radhë, dëbimet nga flamuri (krahina), konkurset e bukurisë pér burrat, «gjama» e famshme e burrave, që s'bëhej kurrë në sy të grave, mendësia spartane e gjer te «përtacia herike» (Heroischen Faulkeit), siç e ka quajtur gjermani G. Gesemann.

Dukej sikur pas braktisjes së Olimpit prej hyjnive të lashta, grekë e shqiptarë qenë shulur pér ta grabitur, siç grabitet një pallat. Por, meqenëse pajisjet e kostumet e hyjnive nuk i shkonin shtatit të tyre, ata i copëtonin ato shkel e shko, pér të mbajtur prej tyre një copëz ose një shenjë. Nganjëherë shkonin edhe më larg. Shqiptarët u përpinqën, p.sh., të krijonin një hyjni të re, gjysmënjeri, gjysmësovran: «mikun». Ishët një hyjni, shijen e të cilët mund ta provonte përkohësisht kushdo, mjaf-tonte që të nisej pér udhë, të trokiste në portén e dikujt e të pranohej si mik. Pér një qime të flokut të tij bëhej hataja, pér një fyerje, një fjalë të pakujdeshme, mund të vazhdonte gjaku dhe lufta midis dy krahinave dhjetë vjet, njëzet e nganjëherë njëqind vjet rresht. Cili sovran nuk do ta ëndërronte një gjë të tillë?

Nganjëherë zhvendosjet ishin edhe më të mëdha, siç qe rasti i Fatumit të famshëm. Pasi qëndroi pezull shekuj të tërë mbi jetën e grekëve të vjetër, dukej sikur një erë e fortë e shtyu atë drejt Veriut pér ta pllakosur mbi bjeshkët e shqiptarëve.

Një skenë e jetës së përditshme, p.sh., ardhja e parë pér vizitë e njerëzve të familjes së vajzës së porsamartuar në shtëpinë e burrit, dhe vizita e pronës së këtij të fundit, e kullës së banimit, e vathës

së bagëtisë, e arës ose mullirit me ujë gjithkund. mund të ishte e zakonshme, por te shqiptarët, së shumti, ndrynte një të papritur. Dhe e papritura ishte, së shumti, fatale. Sepse, duke treguar kullën trikatëshe, vathën, arën, oborrin, mullirin, dhomën e miqve, armët në mure, oxhakun, shkurt, duke treguar mirëqenien e ngritur me aq vështirësi, dikush përmend diçka që as shihet, as preket, një gjak të vjetër të pamarrë, mbetur nga brezi i mëparshëm.

Biseda meket një grimë, me gjithë orvatjen për ta mbajtur gjallë. Së fundi, një nga të ardhurit, si rastësishët pyet se ç'zanafillë ka ai gjak. Përgjigjja «për shkak të një gruaje» shkakton një shend kurreshtar tek të rinjtë, por i zymton dhe më fort ftyrat e pleqve. Pas mendësisë së moçme gjaqet e nisura për gra ose vrasje qensh vazhdonin tepër gjatë.

Të ardhurit përpinqen ta mbajnë veten, por ndërkaq e dinë se mbi kullën e gurtë trikatëshe, tek oxhaku i bukur, te vatha, te kroi, kudo përreth varet hija e vdekjes. Ajo do t'i ndjekë brez pas brezi fëmijët meshkuj që do të lindë vajza e tyre, dhe kundër këtij fataliteti s'mund të ndërmarrë asgjë askush.

Ose të përfytyrojmë një muzg të zakonshëm në bjeshkë. Gjithë bota ka qenë mbushur me konrierë, kasnecë, lajmës që çonin kërcënime, postierë, të dërguar të veçantë të presidentit etj., etj., por lajmëtari që ecte nëpër muze në bjeshkën shqiptare ishte tjetër gjë. Në nenin 1200 të kodit thuhej: «Lajmëtari nuk ban faj. Nuk xehet». Nga trembë-

dhjetë nenet e tjera për lajmëtarin shumica kishin të bënин me mbrojtjen e tij nga tërbimi i atyre që merrnin lajmin. S'ishte e vështirë të kuptohej që lajmet që çonin e binin lajmëtarët përgjithësisht kishin lidhje me diçka tragjike.

Në shtëpinë X, midis jetës së qetë befas, nga një kushëri i largët, vjen një lajm se fisi ka një gjak të pamarrë. Është një gjak i humbur, i lënë ndoshta kështu, ngaqë rrëthanat kanë qenë të mje-gullta, por që tani, pas kaq vitesh rastësisht është sqaruar: përcartja e dikujt në prag të vdekjes, shfletimi me kujdes i «Librit të gjaqeve» në Orosh, një shenjë tjetër e papritur.

Nyja tragjike krijohet në çast në shtëpinë X. Gjithçka tjetërsohet për t'i përshtatur gjëndjes së re. Gjëja e parë është dërgimi i lajmësit te shtëpia armike Y, për t'i kumtuar se ajo i ka borkh një gjak. (Një gjak në bjeshkët shqiptare do të thotë dhjetëra, ndoshta qindra vdekje, gjatë shumë e shumë viteve).

Pra, lajmësi niset për të çuar zinë në shtëpinë tjetër. Ai është lajmësi i vjetër mitologjik, nielloi si paraardhësi i tij i mocëm që coi në Tebë zbulimin e krimtit të Edipit, njelлоj si lajmësit e tjerë që hynë ose dolën nga shtëpia e Atridëve. I mbrojtur nga trembëdhjetë nenet e Kodit, ai s'do të ndalat nga asgjë, sepse asgjë s'mund ta fshijë gjakun (Neni 917 «Gjaku s'hupë kurr»).

Më pas, kur ta tregojnë ngjarjen, e cila, sa më tepër të kalojnë vitet, aq më shumë do t'i humbasë hollësitë, ndoshta do të thonë: dikujt në shtëpinë X iu shti në ëndërr gjaku i harruar, ose Zoti i dërgoi

Eskili, ky humbës i madh

një ëndërr sqaruese, ose vetë hija e të vrarit që shfaqur një natë pa hënë. Dhe pasardhësve kjo do t'u dukej e natyrshme, sepse gjithçka që ata kanë dëgjuar gjer tanj për jetën e fisit ka qenë e tillë: gjysmëreale, gjysmëmitologjike, si e vendosur përherë në dy zona.

Si të donin të lehtësoheshin disi, diçka nga fataliteti i jetës së tyre shqiptarët e shkarkuan te fqnjët e tyre, malazezët, por ajo ishte tepër pak në krahasim me pjesën që mbajtën për vete, prej së cilës vuajtën tamam si heronjtë antikë prej pla-
gëve të pashërueshme qindra vjet.

Ndoshta emri «Bjeshkët e Namuna» aty edhe i ka rrënjet dhe ato po aq mirë mund të quheshin «Bjeshkët e Fatumit». Vështirë se gjékund në botë mund të gjendej një sfond tjetër që t'i shkonte aq fort bustit të Eskilit.

18

Episodi i mrekullueshëm, unikal për nga guximi dhe grotesku i Aristofanit, në komedinë «Bret kosat», ku tregohet se si turma e të vdekurve në skëterrë merr pjesë në një polemikë lidhur me aratin e dy tragjikëve të mëdhenj, Eskilit dhe Euripidit, dhe ku gjyqtarët, për të ndarë sherrin që ka plasur midis dy klaneve, detyrohen të peshojnë në peshore vargjet, figurat e metaforat e dy rivalëve, është analiza e parë e artit eskilian. Kuptimplotë, në radhë të parë, vetë si akt (megjithëse edhe nga saktësia s'është larg së vërtetës), e bërë jo shumë kohë pas vdekjes së tragjedianëve, ajo është profetike për rivalin fitimtar, Eskilin, po aq sa nuk është për të mundurin, Euripidin.

Ndoshta pa dashur, i têrhequr nga gjetja e vet e rrallë, Aristofani ka zbuluar një tipar themelor të Eskilit: strukturat e tij madhështore janë të përbëra nga nënstruktura, e këto të fundit nga detaje me vlerë të veçantë. Vetë fakti i peshimit të copë-

zave, vargjeve, figurave e metaforave, e jep çuditërisht saktë idenë se gjithë ngrehina është e ngritur me gurë që mund të peshohen si thesar. Kështu që, edhe po ta përfytyrojmë dramën e Eskilit si një mekanizëm, zembreku i të cilit, ai që vë në lëvizje, tendos dhe vibron gjithçka, tashmë është prishur, pjesët e këtij mekanizmi edhe kështu të zbërthyera ruajnë vlerat e tyre të pavarura, njëlloj si gurët e çmuar të një ore që s'punon më. Shkurt, gjithë materia me të cilën tragjediani ka thurrur stofin e veprës, është e klasit të parë, edhe kështu e pavendosur ende në avlëmendin e dramës, ku ajo fiton pa dyshim vlerë të dyfishtë.

Pjellë e martesës së lumtur midis poeziës dhe dramës, kjo veçanti është gjithashtu një nga sekretet e artit shekspirian, i cili mbetet i bukur edhe në rastet kur mekanizmi dramatik nuk punon në mënyrë të përkryer.

Në polemikën e famshme skëterrore të përfytyruar nga truri i Aristofanit, Eskili akuzohet nga kundërshtarët e tij për madhështi të ftohtë, të frikshme, kobndjellëse. Duke iu përgjigjur akuzës, gjithmonë sipas Aristofanit, Eskili thotë:

*Mynxyrat, vetë fataliteti i pashmangshëm
Na urdhëron që përmendime e punë të mëdha
Fjalë të madhërishme të kërkojmë.*

Në të vërtetë, duke qenë monumentale, vepra e tij është e mbushur ndërkajq me pjesë të brishta e ylberore, si e rrallëkujt. Është vështirë të gjenet një tjetër dramaturg me një spektër kaq të

Eskili, ky humbës i madh

gjerë tonesh e ngjyrimesh, duke nisur nga më hijerëndat e të zezat te më të ëmblat e të kthjellëtat. Regjistri i tij ndryshon në mënyrë të habitshme aty për aty, brenda një vepre, brenda një skene. Midis reve të zeza, ku grinden hyjnité, midis gostive makabre e sëpatave të krimit, gjen pasazhe të mrekullueshme në qetësinë e tyre për lumturinë njerëzore, për afrimin e pleqërisë, për trishtimin e burrit që i ka ikur gruaja etj., etj.

*I trishtë është fati i njerëzve. Lumturia
E tyre nuk i ngjan veçse një skice
Të vizatuar lehtë. Plakos gjëma
Dhe si sfungjer me një të fshirë e zhduk.*

Dhe në një tjetër vend:

*Dhe vërtet, ç'është plaku
Kur floknaja si gjeth
I lisit të moçëm i thahet krejt?
Me tri këmbë endet andej-këndej
Nj'ëndërr dite tamam...*

Nj'ëndërr dite tamam... Figurë e jashtëzakonshme për vezullimin prizmatik të saj. Një ëndërr dite përfytyrohet, në radhë të parë, si një ëndërr disi e ftohtë, e copëzuar, jetëshkurtër, siç mund të jenë pamjet që mund të prodhojë një gjumë ose, më saktë, një dremitje e ditës... A s'është kështu i dobët e i përkohshëm e me gjak të ftohtë vetë plaku? E, megjithatë, ky mund të jetë vetëm njëri nga

Eskili, ky humbës i madh

interpretimet e asaj që ka dashur të thotë poeti.

Dhe, ja, në një skenë tjetër, Menelau, jashtë çdo klisheje, pas ikjes së Helenës:

*Në qoshe i çnderuar burri i lënë,
Pa nxjerë nga goja sharje kundër saj,
Do ketë mall për të. Këndeje e tutje
Që përtej detit ku ajo ka ikur,
Si një fantazmë do kthehet të sundojë
Nëpër pallat të tij.*

*Dhe statujat e hirshme
Me përbuzje i sheh
Sytë e tyre tashmë
Janë të ftohtë dhe bosh.*

Por pranë këtyre vargjeve të qelqta, me ngjyra akuareli mund të pllakosin befas parandjenjat e errëta, komploti dhe klithma e korit sipër trupit të masakruar të mbretit të vrarë:

*Shpirti yt e di ç'heq
N'atë trup gjithë gjak:*

Krijimi i figurave e i metaforave prej Eskilit bëhet në mënyrë më të papritur e të larmishme. Për të dhënë torturën shpirtërore të Orestit, në qoftë se ai nuk ia merr gjakun babait (torturë që duhet të jetë provuar mijëra herë në ndërgjegjet e malësorëve ballkanas), tragjediani punon me përmasa kozmike, duke e përfytyruar kohën e vrasjes së ndergjegjes në një shtrirje krejtësisht të pa-shpresë:

Eskili, ky humbës i madh

*Në goftë se nuk e bëj, do kem torturë
Të tillë, q'asnje shigjetë përmes saj
Duke vrapuar fundin dot s'ia gjen.*

Ndërkaq me po atë lehtësi ai krijon figura i nisur nga bota reale që e rrëthon, nga bagëtitë, drurët, pluhuri i rrugës, frerët e kuajve, veglat e peshkatarëve etj., etj.

Ky spektër i gjerë tonesh e ngjyrash lidhet natyrshëm, madje është burimi i një veçantie themelore të artit të tij, i mungesës së skemës. Eskili është i pafutshëm e i paklasifikueshëm brenda çfarëdolloj skene apo klisheje. Jo vetëm personazhet, por raportet që krijojen midis tyre, nyjat që lidhen e zgjidhen, klima që sjellin me vete, janë shpesh të papritura, të dridhshme si fazat e një stuhie. Mjafton të kujtojmë për këtë episodin e fundit të «Agamemnonit», kur Klitemnestra, pasi ka vjellë vrer e urrejtje kundër burrit të vrarë e, pasi ka përmendur ndër krimet e tij edhe flijimin e vajzës, Ifigjenisë, ndërsa jep urdhër për varrimin e tij pa asnje nderim, thotë papritur:

*Ne që e vramë, ne do ta varrosim,
Pa qarje familjarësh, natyrisht,
Por veç Ifigjenia, vajza e tij
E dhembshur do t'i dalë atij përpara,
Ashtu siç e do rasti, për ta pritur
Babanë mu në breg të lumit të lotve
Duart në qafë ajo do t'ia hedhë
Dhe do ta puthë me një mall të madh.*

Eskili, ky humbës i madh

Lexuesi mbetet me të drejtë i befasuar përpara këtyre fjalëve. Përse gruaja, që ende dridhet nga mllefi kundër të vrarit, ajo që siç thotë kori, «pikat e gjakut mbi ballë i quan si stoli», e mposht një çast tèrbimin dhe pohon diçka, që duket se është larg çdo pasioni të çastit, diçka të dhimbshme, thellësisht të pikëllueshme për Agamemnonin e vemuar, që veç një njeri do t'i dalë përpara e ta përqafojë, vajza që ai ka flijuar? Dhe pyetjet mund të vazhdojnë: përse do ta bëjë vajza këtë, në bazë të ç'logjike, të ç'motivi? Përse do t'i dalë përpara dhe përse do ta përqafojë madje «me mall të madh»?

Pyetjet mund të vazhdojnë pa fund, megjithatë, të gjithë ne, edhe duke i bërë këto pyetje, edhe pse mund të na duket se kemi të drejtë t'i bëjmë, thellë-thellë e ndiejmë se tragjediani ashtu rrëshqitazi, ashtu stuhishëm, ashtu turbull dhe misteriozisht ka thënë të vërtetën për takimin at e bijë, të dy gjithë plagë që njëra i ka marrë në fillim, tjetri në mbarim të fushatës së Trojës.

Është kjo mungesë e skemës që, përveç të tjershë, e bëri Eskilin dhe jo vetëm atë, po përgjithësisht letërsinë antike greke të çlrohej nga komplekset e shovinizmit, militarizmit e konformizmit, duke i dhënë kështu një mësim të madh letërsisë botërore, mësim që për fat të keq në shumë raste u harrua. E njëjta penë e Eskilit, ajo që himnizon unitetin dhe armët greke në luftën e tyre të drejtë kundër pushtuesit persian, kur erdhi fjala për një luftë tjetër, fushatën antitrojane, u bë e shurdhër ndaj çdo vrundulli shovinist dhe e përshkroi atë

ndeshje si një fatkeqësi po aq të madhe për grekët agresorë, si dhe për trojanët e mundur. Këtë e kishte bërë përpëra tij Homeri dhe këtë e bënë pas tij shkrimitarët e tjerë të Greqisë së lashtë, duke formuluar kështu aktin e parë internacionalist në letërsinë botërore.

Edhe në teknikën e të shkruarit letërsia antike është po aq befasuese sa në gjithçka tjetër. Kur futemi në botën e saj, e kuptojmë se sa naive dhe vulgare janë teza të tillë, si p.sh., ajo se ç'ndikim kanë luajtur në teknikën e të shkruarit shpikjet e reja tekniqe, sidomos ato që lidhen me mjetet e shpejta të komunikimit ose të lëvizjes: radios, telefonit, TV, aeroplanët, fluturimet kozmike etj. Kjo është nië temë e parapëlqyer për mendimin kritik mediokër, të cilit i pëlqen të ngulë këmbë se shpikje të tillë, si TV anijet kozmike etj., kanë ndikuar e do të ndikojnë aq shumë në teknikat letrare, saqë mund të ndryshojnë vetë natyrën e letërsisë.

Se sa mendjelehtë është një tezë e tillë, mjaf-ton të lexojmë vetëm fillimin e këngës së dytë të Iliadës për të kuptuar se ai i verbri i madh s'kishte pasur nevojë për kurrfarë valësh televizive e anijesh kozmike për të strukturuar një nga imazhet e tij, imazh që për mendimin naiv do të mund të krijohej vetëm nga një poet i kohës sonë, madje nga ata ultramodernët.

Ja skena: Është natë. Flenë ushtarët grekë që kanë rrethuar Trojën. Flenë komandantët, të plagosurit, priftërinjtë parathënës. Flenë lart në qiell hyjnité kryesore dhe gjysmëhyjnité. Vetëm Zeusi nuk

Eskili, ky humbës i madh

fle. Ai është i zemëruar me Agamemnonin për arsyet që një faji të tij. Ai do ta ndëshkojë kryekomandanatin grek. Për këtë thërret Ëndrrën Mashtruese. Shko tek Agamemnoni, i thotë asaj, dhe bëj që nesër ai, kundër logjikës së gjérave, të sulmojë trojanët. Niset Ëndrra Mashtruese që të kryejë urdhrin e të zot. Fluturon nëpër natë gjersa mbërrin në kampin grek. Midis mijëra kokash të fjetura ajo e kërkon dhe e gjen më në fund kokën e Agamemnonit. Ia derdh në trurin e tij të fjetur ëndrrën mashtruese. Në mëngjes Agamemnoni zgjohet gjithë gëzim. Ai mbledh këshillin e luftës për ta njoftuar se ka parë një ëndërr nxitëse për sulm. Sulmi pas pak fillon.

Nuk është më shumë se gjysmë faqe, por në ato njëzet rreshta janë të gjitha teknikat e të shkruarit që mund të sugjeroin të gjitha shpikjet teknike të tre mijëvjeçarëve pas Homerit: zhvendosje e mahnitshme e personazheve, kalimi i kamerës nga njëra ndërgjegje në tjetrën, skena në tokë, në qiell, në kampin e pafund të ushtarëve, në trurin e fjetur.

Po të përfytyronim një qenie jashtëtokësore, një qenie së cilës ne, pasi t'i jepnim një informacion të shkurtër për tokën tonë, do t'i paraqisnim dy dramat, njëren antike e tjetrën bashkëkohore, por pa i treguar se cila është antikja e cila bashkëkohorja, ka shumë mundësi që, pasi t'i lexonte të dyja, kur të vinte puna që të përgjigjej (në bazë të atij informacioni që i kishim dhënë ne, lidhur sidomos me përparimin teknik të epokës B(bashkëkohore), në krahasim me epokën A(antike), kur të vinte pra,

çasti i përgjigjes, kishte mundësi që të tregonte me
gisht dramën antike si pjellë të kohës moderne dhe,
e kundërta, bashkëkohoren, si pjellë të kohës së
vjetër.

L'Zemra qajmë
L'Zemra qeshin
L'zamè lindur të ndarë
por baxikò do te vodesim

Aħusni, tħejexu

My endless love!



19

Ka një moment kur grekët e vjetër hyjnë vrulltazi në jetën e njeriut. Disave kjo u ndodh në fëmijëri, të tjerëve në vitet studenteske e të tjerëve akoma në pjekuri ose në pleqërinë e thellë. Si gjithë pasionet e mëdha, ata kanë aftësi turbulluese për çdo moshë.

Dihet se Volterit e sidomos Gëtes e Shilerit ata i krijonin një ndjenjë kthjelltësie, gjë që nuk ndodhte me Leon Tolstoin po t'u besojmë shënimëve të gruas së tij. «Nëse vazhdon ta mbash mendjen te grekët e tu, nuk ke për t'u shëruar, i shkruante ajo. Ata ta sjellin këtë ankth e këtë mospërfillje ndai jetës së sotme. Jo më kot e quajnë greqishten gjuhë të vdekur».

Tolstoi vetë nuk e ka pohuar asnjëherë se grekët e vjetër i sillnin turbullirë dhe ankth, por kontesha Tolstoi ishte e bindur se të komunikoje me ta ishte njëlloj si të komunikoje me fantazmat.

Nuk dimë asgjë se ç'shkaktuan grekët në shpir-

tin e trazuar të Shekspirit. Dimë vetëm se, kur shkroi tragjeditë e tij më të zymta, «Makbethin» e «Hamletin», ai kishte po atë moshë që kishte Tolstoi kur «u sëmur» prej tyre. Ndërkaq dimë se Tolstoi, ndërsa adhuronte grekët, nuk e donte Shekspirin. Por e gjithë kjo i ngjan më tepër grindjeve në familje, që nuk janë fort të kuptueshme për një sy të jashtëm.

Ashtu si në jetën e njeriut, ka pasur periudha në jetën e kombeve e të epokave të tëra, kur grekët e vjetër kanë behur papritur. Seneka ishte ndër urat e para (ç'është e vërteta një urë tepër e ngushtë, për të mos thënë mediokre), nëpërmjet së cilës personazhet gjëmimtare të antikitetit kaluan plot drithë verbuese, lemeri e bujë për të vërvshuar drejt rrafshultës evropiane e pastaj drejt gjithë botës.

Kjo aradhe e paparë i sillte njerëzimit dimensione të reja të mendimit e të përfytyrimit. Ajo i sillte ferrin, ndërgjegjen e vrarë, prometeizmin, fatalitetin, dyzimin, hijet.

Është folur shumë përkëtë rrezatim të grékëve në letërsinë botërore, duke nisur te latinët, Dantëja, Shekspiri, Gëteja e gjer te Hauptmani, O. Neili, T. Elioti, Sartri etj. Është hamendësuar me të drejtë se a do të kishte Ferr të Dantes, dhe në qoftë se do të kishte, si do të ishte strukturuar ai, pa modelin e dikurshëm grek. Si do të ishte Hamleti pa Orestin, vallet e magjisticave pa himnet makabre të erinive, njollat e gjakut mbi duart e Ledit Makbeth pa ato të Klitemnestrës, ndërgjegjet e shqetësuara, gjumi i prishur osë plot me ëndrra turbulluese, shandanet e natës nëpër korridoret e pallateve, kështjella, ku

Eskili, ky humbës i madh

krimi është duke u përjetuar ose porsa ka ndodhur etj., etj.

E, me gjithatë, ndonëse është folur shumë, ka ende për të hulumtuar. Është me interes, për she mbull, të shihet se si mbretërit — viktima të Shek-spirit, të vrarë prej usurpuesve të fronit e të grave, janë disi skematikë e të cekët në krahasim me të ndërlikuarin Agamemnon, që ka pësuar të njëjtin fat.

Për të bërë kundërti me vrasësit Shekspiri i ka bërë të mirë mbretërit e vrarë, gjë që tregon se skematizmi është një sëmundje aq tinëzare, sa mund t'i ngjitet sado lehtë edhe një gjeniu. Eskili, krejt mos-përfillës ndaj skemës, me paanësinë më të madhe jep tërë ankthin dhe keqardhjen për viktimin; Agamemnonin, por ndërkaq nuk harron të kujtojë mizoritë e mëparshme të tij. Kështu që në njëfarë mënyre tek Agamemnoni i tij gjejmë të shkrirë edhe mbretërit e mirë Hamlet e Dunkan, edhe vrasësit e tyre Makbeth e Klaud.

Ka ende për të folur për prometeizmin, këtë tension të hatashëm të marrëdhënieve njerëzore, që nuk e lë njerëzimin të bjerë në gjumë. Po ashtu, ka ende për të hulumtuar për rrezatimin e tërthortë eskilian në atë lloj letërsie që ngjan sikur është te-për larg prej tij. Me kronikën e përgjakshme të Atridëve, i pari në letërsinë botërore Eskili çeli traditën e pasqyrimit të krimeve e të dramave që ndryjnë brenda mureve të tyre pallatet apo shtëpitë e «familjeve të mëdha», traditë e cila nga dràma kaloi në prozën botërore, një pjesë e kryeveprave të së cilës e, në radhë të parë, romanet e Balzakut e

Eskili, ky humbës i madh

të Tolstoit, që të dy aq të largët në pamje të parë nga Eskili, vazhdojnë i pari në lagjet luksoze të Parisit, i dyti në dimrin rus, kronikën e Atridëve.

Ndërsa vazhdonte në botë rrezatimi (bashkë me debatet për të) i letërsisë antike, u harruan e mbetën si përherë jashtë vëmendjes malet e Ballkanit, andej prej nga nisën rrugën së pari këto personazhe shpeshherë me fyell, kërrabë bariu e vëshje prej lëkure deleje, për t'u shndërruar në fantazma të mëdha të njerëzimit.

Rrezatimi i tyre nëpërmjet pasqyrës së ftohtë latine u bë disa herë shkas, siç thamë më parë, për deshifrimin e përdhunshëm të tyre dhe për shkëputjen nga trualli dhe bota ballkanase. As Edipi as Oresti e Ulisi nuk mund të lindnin si kode apo shifra kabalistike për të përfaqësuar hije të përjetshme njerëzore. Përpara se të ishin modele universale njerëzish, ata ishin grekë, ballkanas të mocëm që kishin pasur një atdhe, një histori që i polli, që i vuri në lëvizje e i nisi drejt dramës që do të luanin.

Ata shfaqeshin kudo në skenat e Evropës, deklamonin, flisnin, mallkonin me lloj-lloj gjuhësh, në kohën që amfiteatrot e Gadishullit Ballkanik ishin mbuluar nga heshtja dhe bari i egër. Sepse në terrë e trishtim ishin malet e Ballkanit. Letërsia antike, që studiohej e jepte rrezatim kudo, nuk shkrepte asnjë fije drite në këto male. As grekët e shqiptarët, banorët më të vjetër të gadishullit, e as rumunët apo sllavët e Jugut, që erdhën më pas, nuk dinin asgjë për të. Por, ndërsa s'dinin asgjë, kjo s'i pengonte që në humbëtirat ku banonin, ashtu siç thurrnin pëlhirë me avlëmendet e mocme që nga koha

e Penelopës, të thurrnin balada tronditëse sipas të njëjtave modele të lashta e me të njëtin mekanizëm.

Ishte i njëjti brumë që ngjitej që nga thellësitë për të modeluar pamjet e reja të jetës. Por si ai, si evoluimi i tij i ngadaltë, si evoluimi akoma më i ngadaltë i mekanizmit, kanë mbetur, siç u shpjegua më lart, jashtë vemendjes së duhur të studiuesve.

Kur A. Lordi dhe S. Parry erdhën në Shqipëri e në Jugosllavinë Jugore në vitet '30, punishtja e vjetër homrike po jepte prodhimet e fundit. Është e natyrshme që ato do të ishin të zbehta e disi të çuditshme, si pjella të fundit të stërpinqërisë. (A. Lordi përmend në kujtimet e tij baladën ballkanase, në të cilën personazh është ai vetë bashkë me S. Parry). Por kjo jo vetëm s'ndryshon asgjë në thelbin e çështjes, por e bën edhe më me interes studimin e laboratorit.

Siç u tha më lart, grekët e vjetër kanë vërvshuar shpeshherë në jetën e njerëzve e të artit. Por inkursionet e tyre nuk kanë mbaruar. Prej tyre bota do të ketë prapë të papritura.

Njëzetepesë shekuj pas tragjedisë eskiliane dhe gati pesë shekuj pas përtëritjes së tij prej Shekspirit, a mund të themi se njerëzimi i ka myllur llogaritë me këtë art? Me fjalë të tjera: a i ka kaluar koha shekspirizmit apo eskilizmit? Natyrisht, për një lloj të gjikuari, për ata që mezi presin të shpallin jashtë kohe poezinë, romanin, letërsinë në përgjithësi, vetëkuptohet që tragjizmi eskiliano-shekspiran është jashtë çdo diskutimi, diçka e tej-

Eskili, ky humbës i madh

kaluar. Por ky nuk është veçse një gjykim fare i lehtë. Jo për të bërë paradoks, por mund të thuhet pa frikë se tragjikët e mëdhenj janë më afër se kurrë pranë njerëzve të sotëm në këtë mbarim të mijëvjeçarit të dytë të kohës moderne. Pallatet e Atridëve janë shtuar në botë si asnjëherë tjetër. Kremlini apo Vatikani, Pallati i Borxhias apo Pallati i Verës, dhjetëra pallate apo shtëpi të tjera, muret e të cilave kanë parë e dëgjuar krime prej të cilave globi i tërë mund të dridhej, presin Shekspirët dhe Eskilët e tyre.

Ne dimë që Makbethi e ftoi për darkë mbretin Dunkan dhe e vrau në gjumë. Por mund të ndodhë edhe e kundërtë, që Dunkani, pasi të dyshonte e të kishte mbledhur fshehtazi fakte për qëllimet e Makbethit, ta ftonte i pari për darkë dhe të bënte të njëjtën gjë.

*Kështu erdhi Paridi,
Mik një natë te Atridët...*

Kështu një natë shtatori të vitit 1971 Mao Ce Duni ftoi për darkë në Pallatin e Verës Makbethin e tij të mundshëm, Lin Biaon...

20

Festat teatrale të grekëve bëheshin në mbarim të dimrit. Koha do të dukej e papershtatshme për një teater, shfaqjet e të cilit bëheshin nën qiel të hapur, por, me sa duket, arsyetë tjetra me të rëndësishme e bënин të detyrueshëm një kalendar të tillë. Pranvera dhe vera ishin të mbushura plot me punë, udhëtime e sidomos luftëra. Kështu që mbarimi i dimrit ishte një copë kohë e volitshme për të kujtuar ankthet e mynxyrat e viti që shkoi (këtë herë të luajtura në skenë), në prag të një viti tjetër që s'dihej ende ç'do të sillte.

Teatri në faqen e Akropolit niste të mbushej dalëngadalë me spektatorë. Kishte ditë që gjithë qyteti merrej me teatrin: qenë folur e pëshpëritur mi-jëra fjalë për zgjedhjen e pjesëve, të jurisë, për një tragedian të ri që kishte dalë dhe për të cilin thoshin se ishte shpresë e re e teatrit, e disa të tjerë të kundërtën, për financimin e këtij konkursi, për maskat e reja të piktuvara me të bardhë veze, për

Eskili, ky humbës i madh

aktorin X, që flitej se i qe ngjirur zëri mu në prag të shfaqjes, për spekulimet në shitjen e biletave etj. etj.

I gjithë ky det thashethemesh hynte bashkë me njerëzit në portat e teatrit, shpërndahej në radhët prej druri ose guri dhe atje, në përshtatje me këtë formë të re të vendit, niste prapë gumëzhimën e tij të pandërprerë.

Teatrot e atëhershëm ishin shumë më të më-dhenj se të sotmit. Spektatorët i kalonin shpesh të dhjetëmijë vetët, madje kronikat shënojnë shfaqje me pjesëmarrje 17 deri 20 mijë vetë.

Gjithçka ishte e rrëmuishme, pasionante dhe plot sòlemnitet. Në shkallinat uleshin me radhë zyrtarët e lartë, pasanikët, heterat e dëgjuara, ambasadorët, të cilët më tepër se tek arti i dramës që do të shfaqej, do ta kishin mendjen të kapnin ndonjë nuancë të politikës së jashtme të Athinës, që autori në një mënyrë ose në një tjetër do ta pasqyronte në veprën e vet.

Në ca radhë të caktuara zinin vend të burgosurit, që i sillnin të shoqëruar me roje, gjë që tre-gonte se gjer në ç'shkallë teatri quhej i domosdoshëm për njeriun në Greqinë e Vjetër. Nuk e dimë nëse për krime të rënda kishte dënimë të shoqëruara «me ndalim vajtjeje në teatër», në analogji me burgimet e sotme të shoqëruara me lloj-lloj ndalimësh plotësuese, por vetë fakti që një zakon i tillë kishte hyrë në jetën athinase është kuptimplotë.

Ndërsa spektatorët që kishin njerëz në burg dhe që prisnin këtë rast për t'i parë (më siguri ishin kujdesur që të zinin vendet pranë radhiëve të tyre),

Eskili, ky humbës i madh

u bënин shenja, kërkonin të merrnin vesh ndonjë gjë, apo thjesht u buzëqeshnin ose përloteshin, të tjerë merreshin me gjithfarë bisedash të tjera, bënин hamendje për fituesin, grindeshin para kohe, zemëroheshin, fysheshin, hanin ullinjtë që kishin marrë me vete.

Eskili ynë do të fitojë prapë, këtu do të jemi. Mirë, mirë, po ka dale një i ri, me emrin Sofokli apo Euripid, të themi të drejtën, s'e di mirë, por thonë se ai mund ta rrezikojë Eskilin. Kurse unë dëgjova për një Gnesippos. Çfarë? Profka. Askush s'mund t'i afrohet Eskilit. Çfarë the ti, Sofokliu? Ai që në konkursin e vjetëm luajti rolin e Nausikës, ngaqë e kishte zërin të hollë? Pse, dramaturg ësh-të ai?

Të tjerë diskutonin për gjithfarë gjérash që kishin ose s'kishin lidhje me teatrin. Mjaftonte që dikush të pyeste se sa ishte shuma e përgjithshme që do të shpenzohej atë vit për festat, që biseda të vinte, për shembull, te shpërblimi që do të merrte dramaturgu fitues. Ai ishte një talent dhe dikujt i dukej shumë e dikujt jo. Atij që i dukej shumë i pëlqente të kujtonte se me një talent një familje me katër vetë mund të jetonte 15 vjet, ose që tragediani fill pas mbarimit të ceremonisë mund të shkonte në pazarin e skllevërve për të blerë me honorarin e tij 30 skllevër. Kurse tjetrit, atij që e kundërshton, në mungesë të shembujve të këtij lloji, nuk i mbetej veç të përsërise: po pse, e lehtë të duket ty të shkruash një tragedi?

Të tjerë që mund të përziheshin në bisedë kujtonin fakte të ndryshme si, për shembull, që gjithë

shpenzimet vjetore të policisë ishin 40 talante, ose që buxheti i vitit të parë të luftës së parvjetshme kishte arritur 1000 talante. Mirëpo, jo gjithmonë kuptohej nëse këto shembuj ishin në favor të bashkë-biseduesit të parë apo të dytë, të të dyve bashkë apo të askujt.

Ndërkaq radhët pothuajse qenë mbushur dhe tani ishte vështirë të gjeje vend. Kishin mbërritur e kishin zënë vend në shkallinat e drunjta ambasadorët, delegacionet e huaja që rastësisht i kishin zënë festat në Athinë, arkondët, të burgosurit, madje edhe heterat e famshme, ato që zakonisht vinin të fundit. Diku përbri skenës dukej kalimthi ndonjë nga aktorët, që e mbante ende në dorë maskën tragjike. Diku, në radhët e rezervuara për njerëzit e shquar kishin zënë vend tragjedianët konkurrues, që për një arsy e ose një tjetër nuk luanin dot vetë në tragjedinë e tyre.

Eskili ishte për herë të fundit në teatër në prag të të shtatëdhjetave. Konkurronte me një dramë. Ishte i lodhur nga lufta e gjatë, nga mendimet, nga dilemat. Kishte themeluar një art, një ndërgjegje të dytë të njerëzimit, po si njeriu që nuk është i sigurt përfatim e fëmijëve që i lë në një botë të ashpër e të ftohtë, ai nuk ishte i sigurt për tragjeditë. Çka ishte më e keqe, nuk ishte i sigurt nëse i duheshin apo nuk i duheshin njerëzimit, nëse do të sillnin më shumë turbullirë se dobi.

Shumë gjëra i shikonte tani me sytë e një hijeje. Ja, kjo gumëzhimë e njobur, që në veshët e tij vinte e largët, e jepte më mirë se çdo gjë idenë se ai së shpejti do të mungonte, dhe e gjithë kjo do të

vazhdonte pa të. Qysh tani disa nga konkurrueshit nuk i njihte. Njëri prej tyre, për të cilin flitej më shumë, ishte fare i ri dhe me flokë të bukur. Katër ditë konkurrim kishin qenë me të vërtetë shumë për moshën e tij.

Dhe, ja, më në fund mbarimi i shfaqjes së fundit. Pushimi përpëra votimit të jurisë, qetësimi i zhaurimës përpëra leximit të vendimit, zëri i tingullt, çnjerëzor i përfaqësuesit të jurisë, e cila me shumicën e votave shpalli fituesin e këtij viti...

Nuk ishte emri i tij.

Syfe i erresohen. Por jo vetë aq, por edhe veshët do të donte të mos i kishte. Kishte kohë që në trurin e tij shkumëzonte pakënaqësia. Vendimi i jurisë ishte pika e fundit e derdhur në një gotë të mbushur prej kohësh. Nuk i mbetej veçse të shfrynte me vete: në djall të venin të gjitha. Në djall të vente teatri bashkë me dramaturgjinë. Ai nuk do të shkruante më, nuk e meritonin grekët edhe aq sa kishte bërë. Do t'i digjte dorëshkrimet që kishte në shtëpi, projektet, skicat e tragjedive të ardhme, gjithçka, gjithçka. Në djall çdo gjë, në djall të vente Greqia bashkë me grekët. Vend zemërgushtë, mosmirënjohës, kujtesëshkurtër. Ai qe përpjekur ta bënte të pavdekshme, por ajo s'e meritonte.

Qe përpjekur të modelonte një tjetër fytyrë të saj, natyrisht, më fisnikë se fytyra reale dhe, ashtu si në teatër, t'ia mbulonte me atë maskë fytyrën e vërtetë. Kishte shpresuar se me kalimin e viteve nën atë maskë korrigjuese fytyra e saj do të ndry-

Eskili, ky humbës i madh

shonte dalëngadalë, do t'i adaptuhej maskës, gjersatë bëhej njësh me të.

Por Greqia nuk e kishte dashur këtë korrigjim. Në vend të modelit që i kishte ofruar ai, kishte parapëlqyer fyttyrën e saj të pagdhendur dhe, bashkë me të, kujtesën, ligjet dhe ndërgjegjen e saj të gjymtuar.

Në djall të vinte me të gjitha. Ai nuk donte vec të ikte sa më larg që këndejej. Të mos e shihte më, të mos dëgjonte më rrëmujën e saj bezdisëse. Do të merrte arratinë, të vendosej ndoshta në brigjet e Ilirisë, në Epidamnus, apo edhe më larg, në ishullin e Sicilisë. Dhe as emrin të mos ia dëgjonte më teatrit, Athinës, Greqisë.

Kështu shfrynte ndoshta me vete, po ndërkaq, thellë vetvetes e ndiente se Greqinë e kishte të tërrën mbi shpatulla dhe, sado që të shkumëzonte, sado që të lëvizte supet me tërbim, atë nuk e shkundte dot kurrë. Ishte e thënë që ta mbartnin një-ri-tjetrin nëpër mijëvjeçarë. Ai Greqinë dhe Greqia atë. E ndiente se kjo ishte një lidhje fatale, por kishte në atë fatalitet edhe zi, edhe dritë, edhe bregë, edhe lumturi, edhe humbje, edhe ringjallje...

Tiranë, janar 1985.